

PËRMBAJTJA E REVISTËS:

Numri XXX, viti 2006

Faqe

E Drejta Kushtetuese:

Ndalimi i torturës në shtetin e së drejtës	Dr. Arta VORPSI	4
Mendime juridike mbi të drejtën publike referuar legjislacionit shqiptar	Elsa DODJANI	17
Të drejtat kushtetuese dhe statusi politik i femrave në Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë	Fatmira LUMANI	40

Reforma ligjore:

Sfida e pushtetit gjyqësor nën fokusin e rindarjes territoriale të gjykatave	Julian HAXHIU	50
E Drejta Familjare dhe mbiemri pasmartesor	Genta BUNGO	57

E Drejta Parlamentare:

Të njohim Parlamentin italian	Aida SHLLAKU	70
-------------------------------	--------------	----

Nga punimet e Kuvendit:

Nga punimet e Kuvendit për periudhën 20 shkurt - 10 mars 2006	Alma KONDAKÇIU	80
Informacion mbi legjislacionin e miratuar në Kuvend	Filip LAKO	84

Përmbledhje në anglisht:

Information on laws passed by Assembly	Filip LAKO	106
--	------------	-----

TABLE OF CONTENTS:

30th issue, year 2006

	Page
<hr/> <i>Constitutional Law:</i>	
Prohibition of torture in the rule of law Arta VORPSI	4
Juridical thoughts on public law referred to the Albanian legislation Elsa DOBJANI	17
Constitutional rights and the political status of women in the Former Yugoslavian Republic of Macedonia Fatmira LUMANI	40
<hr/> <i>Legal Reform:</i>	
Judiciary power challenges related to the territorial redivision of the courts Julian HAXHIU	50
Family law and marital surname Genta BUNGO	57
<hr/> <i>Parliamentary law:</i>	
Italian Parliament - an overview Aida SHLLAKU	70
<hr/> <i>From the proceedings of the Assembly:</i>	
From the proceedings of the the Assembly for the period 20 February- 10 March 2006 Alma KONDAKÇIU	80
Informacion mbi legjislacionin e miratuar në Kuvend Filip LAKO	84
<hr/> <i>Summary in English:</i>	
Information on laws passed by Assembly Filip LAKO	106

Rubrikat në vijim synojnë prezantimin e politikave ligjore dhe trajtimeve teorike për organizimin dhe funksionimin e institucioneve kushtetuese. Botuesi vlerëson si një kontribut në zhvillimin dhe përmirësimin e funksionimit të institucioneve kushtetuese, paraqitjen e opinioneve dhe mendimeve të studiuesve të ndryshëm, në mënyrë të paanshme dhe objektive, duke nxitur një debat profesional.

Opinionet e paraqitura janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë qëndrimin e botuesit të kësaj reviste.

Ndalimi i torturës në shtetin e së drejtës

Dr. Arta VORPSI¹

I. NJË PARIM THEMELOR NË KRIZË?

Njerëz të zhveshur, me fytyra të mbuluara ose në rastin më të keq nuk u dallohen ato, të grumbulluar mbi njëri-tjetrin si male mishi, njerëz të frikësuar dhe të kërcënuar nga qentë e burgut – këto janë pamje që janë dhënë në masmedia nga burgjet në Irak dhe që na kanë tronditur. Dhe jo vetëm kaq, të gjithë ndjemë një lloj zemërimi dhe revolte ndaj njerëzve që lejojnë dhe aq më keq marrin pjesë në këtë procesion. Por nuk duhet harruar se kjo që kemi parë, dhe që bëhet publike për shumë arsye, është një ndodhi normale e përditshme në burgjet dhe stacionet e policisë në mjaft vende të botës.

Në kontrast me revoltën që ndizet nga pamjet e burgut të Abu Ghraib në Irak, lind edhe një debat i gjerë me temë kryesore: *A duhet lejuar përdorimi i torturës në rrethana të caktuara, në mënyrë që të shmanget një rrezik i rëndë?* Përgjithësisht ky diskutim shoqëror shkallëzohet në një debat juridik për shkak të kuadrit kushtetues dhe ligjor të çdo vendi, por edhe në kuadër të së drejtës ndërkombëtare. Natyrisht, është e lehtë të gjesh përkrahës të idesë që tortura duhet zbatuar në kushte të veçanta për shmangien e një rreziku të madh. Kështu p.sh., në vitin 2002 në Gjermani nisi një proces gjyqësor kundër një shefi të policisë, pasi ky kishte torturuar një rrëmbyes fëmijësh, me qëllim që t'i tregonte vendin ku e kishte fshehur viktimën. Ky proces u mbyll shpejt, pasi një pjesë e politikanëve dhe përfaqësues të

¹ Autorja është këshilltare ligjore në Gjykatën Kushtetuese. Të gjitha mendimet e shprehura janë reflektime vetjake të autores dhe nuk përfaqësojnë qëndrim zyrtar të institucionit.

organeve të drejtësisë treguan mirëkuptim për veprimin e tij, i cili i shërbeu shpëtimit të fëmijës nga rrëmbyesi. Nga ana tjetër, pati dhe reagime të kundërta që akuzonin drejtuesin e policisë për sjellje çnjerëzore karshi të torturuarit.

Ka edhe sot mjaft përkrahës të idesë se tortura legjitimohet krejtësisht, kur bëhet fjalë për shmangien e akteve terroriste. Madje kjo arrin deri aty sa të sugjerojnë edhe përdorimin e fjalëve të tilla alternative në vend të fjalës “*torturë*” si “*detyrim për të kallëzuar*”. Mjafton të kujtojmë këtu përpjekjet e administratës së SHBA-së, për të justifikuar në disa raste përdorimin e torturës me qëllim shmangien e akteve terroriste. Qëllimi i këtij artikulli është paraqitja e kornizës kushtetuese të brendshme, por edhe ndërkombëtare, lidhur me ndalimin e torturës, si një temë mjaft të brishtë për shoqërinë shqiptare, por edhe atë mbarëbotërore.

II. IDEJA E SHTETIT TË SË DREJTËS

Çdo shtet që e quan veten shtet i së drejtës ka për qëllim garantimin e të drejtave dhe lirive themelore. Ajo që e dallon këtë shtet nga shteti autoritar ose gjysmautoritar nuk është thjesht nevoja për të deklaruar se ka vetëm për qëllim, por edhe detyrim, për të respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Liria nuk është thjesht një produkt i sigurt i politikës, por një kriter që përcakton legjitimitetin e pushtetit shtetëror, i cili i nënshtrohet një kontrolli efektiv të vazhdueshëm. Prandaj të drejtat dhe liritë themelore gëzojnë në shtetin e së drejtës një status normativ të posaçëm, i cili nuk mund të mënjanohet thjesht nga fakti i ekzistencës së një interesi publik, por duhet argumentuar nevoja e kufizimit të tyre mbi bazën e parimit të proporcionalitetit.

Shteti i së drejtës bazohet veçanërisht edhe te dinjiteti i njeriut si kusht për ekzistencën e qenies njerëzore. Kjo është karakteristikë jo vetëm e sistemeve normative laike, por gjendet edhe në gjurmët më të hershme të shkrimeve fetare, si Kurani, Bibla ose të Konfucit. Ajo që e bën të veçantë trajtimin e dinjitetit të njeriut nga pikëpamja teorike është qëndrimi se dinjiteti

i njeriut lidhet pandashmërisht me të drejtat themelore të garantuara, dhe se ky dinjitet nuk preket për sa kohë nuk preken as këto të drejta.

Fakti që të drejtat dhe liritë e njeriut, midis tyre edhe dinjiteti i tij, lidhen drejtpërdrejt me njeriun. Kjo nuk do të thotë se njeriu mund të heqë dorë nga gëzimi i tyre ose t'ia delegojë dikujt tjetër ato, sepse të drejtat dhe liritë themelore janë të patjetërsueshme², pra njeriu nuk mund të heqë dorë prej tyre ose mos t'i refuzojë ato. Orientimi i vazhdueshëm te patjetërsueshmëria e të drejtave themelore përbën elementin kryesor dallues të një shteti të së drejtës.

Pas rreth një shekulli përpjekjesh dhe debateve kushtetuese të parlamentit anglez në luftë kundër absolutizmit të monarkut, John Locke-u sjell trajtimin e tij mbi parimin e patjetërsueshmërisë së të drejtave dhe lirive themelore. Sipas teorisë së tij liberale, disa të drejta – life, liberty, property (jeta, liria, prona) – janë të detyrueshme për shtetin dhe të patjetërsueshme, si baza të kontratës shoqërore. Vlera e tyre rrjedh kryesisht nga baza fetare, pra njeriu e merr jetën nga Krijuesi (Zoti), prandaj ai nuk ka të drejtë të vendosë vetë mbi jetën e tij dhe as të heqë dorë prej saj ose kufizimit të saj. Duke qenë se njeriu nuk ka pushtet mbi jetën e tij, ai nuk mund të nënshkruajë një kontratë ose të bjerë dakord për t'u bërë skllav i dikujt tjetër, aq më pak t'i nënshtrohet pushtetit arbitrar të dikujt tjetër³.

Më fuqishëm se te Locke-u vjen qëndrimi i Kant-it lidhur me detyrimin e shtetit për të zbatuar të drejtat dhe liritë e shtetasve. Kant-i e përkufizon lirinë si *“e vetmja e drejtë origjinale që gëzon njeriu për shkak të qenies së tij njerëzore”*⁴. Nga kjo liri rrjedhin të gjitha të drejtat e tjera që duhet të gëzojë njeriu. Në dallim nga Locke-u, Kant-i nuk e bazon gëzimin e kësaj

² Neni 15/1 i Kushtetutës shqiptare.

³ John Locke, Two treatises of government - marrë nga: www.plato.stanford.edu/entries/locke.

⁴ Immanuel Kant, Die Methaphysik der Sitten, Akademie Ausgabe Bnd.VI, f. 237.

lirie tek arsyet fetare, më shumë e lidh këtë me dinjitetin e njeriut, si kusht për të gëzuar të gjitha të drejtat e tjera dhe për të qenë subjekt i tyre i njohur nga pushteti shtetëror. Sipas Kant-it, ka të drejta dhe liri që njeriu nuk mund mos t'i refuzojë ose të heqë dorë prej tyre edhe sikur ai të dëshirojë. Përgjithësisht filozofët klasikë e kanë trajtuar raportin e lirisë dhe sigurisë si raport midis qëllimit dhe mjetit. Kështu p.sh., Hobbes-i e trajton ushtrimin e dhunës si monopol të shtetit që i shërben zbatimit të kontratës shoqërore, të lidhur midis pushtetmbajtësve dhe shtetasve, kurse Kant-i e sheh nevojën e ushtrimit të dhunës shtetërore atëherë kur duhet medoemos të shmanget një cenim i pushtetit shtetëror ose qetësia publike. Sipas tij *“vetëm për parandalimin e rrezikimit të lirisë mund të ushtrohet dhuna shtetërore dhe mund të quhet e legjitimuar”*⁵.

Kjo përballje e periudhës së klasikëve u bë për të kaluar natyrshëm te tema e këtij artikulli, pra te garantimi i një të drejte të patjetërsueshme siç është dinjiteti i njeriut. Pyetja kryesore që lind është: A është i nevojshëm justifikimi i të drejtave dhe lirive të njeriut apo është i nevojshëm justifikimi i rasteve të kufizimeve të tyre nga ana e pushtetit të shtetit? Natyrisht që përgjigja do të peshojë nga e dyta, sepse kjo situatë duhet të jetë rast përjashtimor dhe në çdo të tillë duhet të justifikohet proporcionalisht pasoja konkrete në dobi të sigurisë publike dhe të mos kalojë asnjëherë caqet e vendosura me ligj.

III. DINJITETI I NJERIUT DHE NDALIMI I TORTURËS

Ndalimi i torturës i shërben mbrojtjes së dinjitetit të njeriut. Këtë funksion e gjejmë edhe te të drejtat e tjera themelore. Normat kushtetuese që parashikojnë të drejtat dhe liritë themelore plotësojnë njëra-tjetrën, duke garantuar në tërësi dinjitetin e njeriut si subjekt i mbrojtjes nga shteti. Respektimi i dinjitetit është parakusht për gëzimin e të gjitha të drejtave të

⁵ Po aty, f. 231.

tjera. Të drejtat dhe liritë janë në thelb të patjetërsueshme. Në Deklaratën Universale për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut të OKB në vitin 1948 thuhet se *“njohja dhe pranimi i dinjitetit të njeriut, i të drejtave të patjetërsueshme dhe të barabarta të të gjithë anëtarëve të familjes, barazia, liria dhe paqja në botë janë baza e kësaj deklarate”*⁶.

Pas rënies së regjimit komunist në Shqipëri dhe anëtarësimit të saj në mjaft traktate dhe forume ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut, si dhe me miratimin e Kushtetutës së vitit 1998, u vendos, midis të tjerave, nën një mbrojtje të veçantë të shtetit edhe dinjiteti i njeriut⁷. Për një pjesë të madhe të të drejtave vepron përmbajtja e nenit 17, sipas së cilës ato mund të kufizohen në raste të përcaktuara qartë me ligj, për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve dhe pa cenuar thelbin e lirive dhe të të drejtave (17/2)⁸. Ndërsa në nenin 25, ku parashikohet ndalimi i torturës, i dënimit, apo i trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës, nuk parashikohen mundësi kufizimi.

Si në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut të OKB-së, ashtu edhe në Konventën Europiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut ka ndalim absolut të torturës⁹. Ndalimin e torturës e gjejmë të shprehur edhe në Konventën Antitorturë të OKB-së të vitit 1984: *“Rrethana të jashtëzakonshme të çdo lloji, qofshin këto: situata lufte, mungesë*

⁶ Pothuaj e njëjta preambul gjendet në të dy paktet më të mëdha ndërkombëtare: të 1966 (për të drejtat civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore) që së bashku me Deklaratën Universale të 1948-ës ndërtuan të ashtuquajturën “Bill of Rights”.

⁷ Duke filluar që nga preambula e Kushtetutës dhe më pas në nenin 3 dhe 15 të saj.

⁸ Në rastin e mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve duhet zbatuar parimi i proporcionalitetit, duke baraspeshuar të drejtat që konkurrojnë me njëra-tjetrën.

⁹ Neni 7 së bashku me nenin 4/2 të Paktit dhe neni 3 i KEDNj-së. Është pjesë edhe e Konventës së Gjenevës për të Drejtën Ndërkombëtare Humanitare.

*stabiliteti politik ose emergjencë e llojit tjetër, nuk duhet të shërbejnë në asnjë rast si justifikim për të ushtruar torturën ndaj njerëzve*¹⁰.

Realiteti ka treguar se zbatimi i torturës jo vetëm që është cenim i dinjitetit (ashtu siç është shkelja e shumicës së të drejtave dhe lirive themelore), por shkakton edhe një mohim të vazhdueshëm dhe të plotë të dinjitetit¹¹. I vetmi rast që mund të krahasohet me të është skllavëria, gjendje në të cilën, ashtu si dhe te tortura, njeriu detyrohet të kryejë shërbime ose veprime kundra dëshirës. Tortura ka për qëllim që të shkelë vullnetin e personit që i nënshtrohet asaj dhe ta përdorë atë si mjet për të marrë informacione, ose për ta përkulur ose demoralizuar, shoqëruar kjo me dhimbje, frikë dhe turp. Pamjet që janë dhënë nga burgu i Abu Ghraib-it tregojnë fytyrat e mbuluara me kapuç të zinj, me qëllim për t'i treguar të burgosurit si objekte pa identitet. Pasojat për viktimat nga përjetimi i torturës janë mjaft të rënda. Respekti për veten dhe besimi te të tjerët thyhen përfundimisht, duke u kthyer shpesh në trauma të përjetshme.

Teza e Kant-it¹², lidhur me kërkesën për të vepruar sikur njerëzimi nuk është mjet por qëllimi i ekzistencës, merr kuptim të kundërt kur ushtrohet tortura: kthimi i njeriut në mjet realizohet plotësisht dhe kërkesa e tij, për t'u trajtuar me dinjitet, mohohet plotësisht. Natyrisht që duke ushtruar dhunë ndaj të të torturuarve, humbasin dinjitetin edhe vetë torturuesit. Dinjiteti i njeriut është baza e strukturës morale dhe juridike e shoqërisë. Pa respektimin e dinjitetit – qoftë të vetë njeriut ose të të tjerëve – nuk mund të ketë marrëdhënie të shëndosha midis njerëzve ose midis shtetit dhe shtetasve. Prandaj, respektimi i dinjitetit nuk është vetëm një normë si gjithë të tjerat,

¹⁰ Neni 2/2 i Konventës Antitorturë e OKB-së.

¹¹ V-3/04 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Përmbledhja e vendimeve të GJK (2004) fq. 26.

¹² Emmanuel Kant, Grundlegung zur Methaphysik der Sitten, f. 429.

më së shumti ajo është baza e normave juridike dhe e moralit dhe kështu baza e shtetit të së drejtës¹³.

Nëse ndodhemi para dy të drejtave themelore, i japim përparësi në respektim asaj që prevalon. Kurse në rastin e torturës, nuk zbatohet një balancë e tillë, sepse nuk ka asnjë parim që i mbivendoset ndalimit të torturës ose dinjitetit të njeriut. Në kuptimin e ngushtë të fjalës “parim bazë,” dinjiteti i njeriut është i pakonkurrueshëm. Ose me fjalët e Kanti-t “*Në perandorinë e qëllimeve çdo gjë ka një çmim ose një dinjitet. Për ato që kanë çmim, në vend të tyre mund të gjendet një barasvlerë; nëse për disa gjëra nuk gjendet barasvlera, atëherë ato kanë dinjitetin*”¹⁴. Çdo cenim i dinjitetit të njeriut prek bazën e moralit dhe të së drejtës. Prandaj tortura nuk mund të jetë në asnjë rast e moralshme ose juridikisht e justifikuar. Ndalimi i torturës duhet kuptuar si ndalim absolut. Për shtetin ky është një kufi i pakalueshëm¹⁵.

IV. A DUHEN LEJUAR PËRJASHTIMET?

Kjo është pyetja që ngjall mjaft debate sot midis juristëve. Si shembull, në favor të lejimit të përjashtimeve nga ndalimi absolut i torturës, jepet një rast ideal tipik: një bombë e vendosur nga një terrorist rrezikon jetën e një numri të madh njerëzish. Policia ndalon një person si të dyshuar kryesor, i cili ka informacione të mjaftueshme për të shmangur tragjedinë. Mundësi tjetër për të shmangur rrezikun nuk ka. Në këtë moment përkrahësit e kësaj ideje e quajnë të nevojshme ushtrimin e torturës ndaj personit të ndaluar për të

¹³ Kanti ka mbështetur idenë se ligji themelor i moralit, që në shumicën e sistemeve juridike trajohet si “rregulli i artë”, nënkupton respektimin e detyrueshëm të çdo njeriu si qëllim kryesor.

¹⁴ Immanuel Kant, Grundlegung zur Methaphysik der Sitten, f. 434.

¹⁵ Ky qëndrim është mbajtur edhe nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vendimin e saj V-3/4, datë 11.2.2004, Përmbledhja e vendimeve të GJK (2004) f.26.

nxjerrë të dhënat e duhura. Ky rast është njohur ndryshe edhe me emrin *ticking bomb scene*". Pra, ajo që shtrohet në këtë rast është legjitimiteti i dhunës së ushtruar nga shteti në raste emergjente. Natyrisht që këto duhet të jenë raste përjashtimore. Mirëpo e gjitha kjo, po të vihet përballë parimeve mbi bazën e të cilave duhet të funksionojë shteti i së drejtës, krijon një kontradiktë serioze. Është e vështirë ta justifikosh torturën në një shtet të së drejtës. Nga njëra anë shteti, duke lejuar torturën, u krijon një hapësirë vlerësimi organeve të sigurisë publike, e cila shpesh është e turbullt dhe e paqartë lidhur me faktin nëse tortura është ose jo legjitime¹⁶. Nga ana tjetër, shteti, duke lejuar ushtrimin e torturës, shkatërron bazën e legjitimitetit të tij demokratik. Me fjalë të tjera: ai minimizon autoritetin e tij demokratik dhe të bazuar mbi parimin e shtetit të së drejtës, autoritet i cili është vështirë të kufizohet nëse kthehet në praktikë të vazhdueshme.

Lind pyetja: *A mund të ushtrojë torturën shteti, për të shpëtuar një ose disa viktime nga tortura e terroristëve?* Përgjigjja duhet të jetë negative. As detyrimi i shtetit për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e njeriut nuk i lejon masat nëpërmjet të cilave cenohet dinjiteti i personave që ushtrojnë dhunë ndaj të tretëve. Shteti i së drejtës nuk duhet të bjerë në grackën e një gare barbare të ushtrimit të dhunës ose terrorit. Është njëlloj sikur shteti të merrte peng të afërmit e pengmarrësve për t'iu përgjigjur me të njëjtën monedhë veprimit të tyre ndaj personave të pafajshëm. Po kështu, shteti nuk duhet të torturojë personat që ushtrojnë torturën ndaj të tretëve. Nëse kjo do të shihet si një dobësi e shtetit karshi terroristëve ose keqbërësve të tjerë, atëherë duhet t'i rikthehemi edhe një herë leksioneve mbi shtetin e së drejtës dhe demokracinë.

¹⁶ Kështu, Gjykata e Lartë e Izraelit në vendimin e saj të 6 shtatorit 1999 ka hedhur poshtë pretendimin se i ashtuquajtur "detyrim fizik i përshtatshëm" nga ana e shtetit për të marrë informacione të nevojshme në luftën kundër terroristëve potencialë ishte plotësisht i justifikuar. Ajo ka mbështetur plotësisht ndalimin absolut të torturës.

Shteti i së drejtës dhe tortura nuk janë asnjëherë bashkudhëtarë. Shteti jo vetëm nuk duhet ta ushtrojë vetë atë, por duhet të japë edhe sanksione për personat e veshur me pushtet (policin) që ia lejojnë vetes të ushtrojnë veprime torturuese dhe çnjerëzore. Përndryshe do të krijohet bindja që shteti, në mënyrë të heshtur, e përkrah torturën, duke qëndruar shpërfillës ndaj personave që e ushtrojnë atë aktivisht. Kushdo që ushtron ose urdhëron ushtrimin e torturës, duhet të mbajë përgjegjësi ligjore. Kjo është sanksionuar në Konventën Antitorturë të OKB-së¹⁷. Vetëm në një proces penal publik mund të sqarohet çështja nëse ekzistonte një situatë e tillë, e cila nuk do të thotë se legjitimon ushtrimin e torturës (pasi kjo nuk është e mundur), por të paktën e bën atë të padënueshme penalisht.

V. NJË E DREJTË E VEÇANTË PËR TERRORISTËT?

Eksperti i së drejtës penale në Universitetin e Bonit, Günther Jakobs shfaqti një teori të re në vitin 1985, të njohur me emrin *Feindstrafrecht* – E drejta penale e armikut. Sipas kësaj teorie, subjekte të kësaj të drejte do të ishin të gjithë ata persona që nuk e pranonin hapur sistemin juridik shtetëror ose kërkonin ta shkatërronin atë dhe, për këtë arsye, të drejtat e tyre si shtetas dhe si persona i humbnin detyrimisht, prandaj dhe shteti kishte të drejtë t'i luftonte ata me të gjitha mjetet. Kështu p.sh., terroristi që synonte shkatërrimin e sistemit shoqëror mbizotërues në një vend ose në shumë vende të botës, anëtarët e organizatave mafioze, të cilët i nënshtrohen vetëm rregullave të klanit ku bëjnë pjesë, sipas tij, nuk janë persona (*Unperson*) dhe për këtë arsye nuk duhen trajtuar si shtetas normalë. Ata duhen trajtuar si “armiç”. Jakobs e quan të arsyeshme zbatimin e të drejtës penale të armikut, duke u mbështetur edhe te teoria kontraktore e Thomas Hobbes-it dhe interpretimin e saj nga Immanuel Kant-i. Çdokush që tërhiqet nga kontrata sociale nëpërmjet veprimeve të tij heq dorë vullnetarisht nga shoqëria dhe

¹⁷ Neni 4 i Konventës.

kthehet te gjendja natyrore ku nuk vepron ligjet. Nëpërmjet këtij veprimi ai humb cilësitë e tij si peron dhe bëhet armik. Ai armik duhet të luftohet nga shoqëria¹⁸.

Kështu, për shembull, në Kolombi e drejta penale e armikut po zbatohet që prej vitit 1990 kundër “terroristëve të drogës”. Të arrestuarit qëndrojnë me vite pa njohur akuzën ose pa ndihmë juridike në dhomat e paraburgimit dhe më pas zhvillohet një proces i fshehtë gjyqësor vetëm mbi bazën e thënieve të dëshmitarëve anonimë. Prosesi i hetimit i është lënë në dorë një grupi të posaçëm ushtarak që formalisht luan rolin e prokurorisë. Afërsisht 7 për qind e veprave penale gjykohen mbi bazën e së drejtës penale të armikut. Klasifikimi i luftëtarëve të Al-Qaida-s dhe talibanët janë cilësuar si “*luftëtarë të paligjshëm*” (unlawful enemy combatant) dhe mbyllja e tyre në kampin e Guantanamo-s nga ushtarët e SHBA-së mund të quhet një formë e së drejtës penale të armikut¹⁹.

Në këtë kuadër Jakobs-i mbështet idenë se duke zbatuar të drejtën penale të armikut, ushtrimi i torturës nuk përbën më problem ligjor. Mjeti dhe mënyra, që përdor shteti për të trajtuar të burgosurit si terroristë potencialë, është për t’u çmuar dhe vlerësuar nga vetë shteti. Sipas kësaj të drejte nuk bëhet më fjalë për ndalim absolut të torturës. Në zonën ku nuk vepron më ligji, zonë e cila mbulohet nga e drejta penale e armikut, tortura nuk është më përjashtim, por një opsion që mund të përdoret në çdo kohë kundër “armikut”.

Pyetja që lind menjëherë është: *Nga e di shteti se cilët janë “armiqtë” e tij? Si mund të shmanget përfshirja e njerëzve të pafajshëm ose e*

¹⁸ Më tepër për përkufizimin e së drejtës penale të armikut ose Feindstrafrecht në: www.wikipedia.org.de

¹⁹ Termi “unlawful enemy combatant” është përdorur nga administrata e SHBA-së për cilësimin e të burgosurve si terroristë në Irak, duke mos pranuar kështu klasifikimin e tyre si robër lufte, të cilët duhet t’i nënshtroheshin rregullave ndërkombëtare për robërit e luftës, çka nuk u pranua nga administrata e SHBA-së, duke shkelur statusin e tyre si robër lufte sipas së drejtës ndërkombëtare publike.

keqbërësve ordinerë, për të mos rënë pre e së drejtës penale të armikut? Nga kush dhe sipas cilave kriterë do të vendoset se kur do të zbatohet kjo e drejtë e posaçme dhe kur e drejta penale e zakonshme? Ajo që u jep më tepër kuptim këtyre pyetjeve është se edhe parimi tjetër i rëndësishëm dhe i rangut kushtetues i prezumimit të pafajësisë nuk ka më vend për t'u zbatuar. Një shtet, i cili i jep përparësi çështjes së sigurisë politike përpara zbatimit të parimeve kushtetuese mbi të cilat duhet të funksionojë një shtet i së drejtës, nuk ka më asgjë të përbashkët me të drejtën. Shteti, i cili merr guximin të trajtojë ose të etiketojë një njeri ose grup njerëzish si “jo njeri” ose “jo person” ka nxjerrë jashtë loje dinjitetin e njeriut, si e drejtë themelore e tij. Imazhi i këtij shteti si shtet i së drejtës është përfundimisht i dëmtuar.

VI. PARIME TË PAPERKSHME TË SHTETIT TË SË DREJTËS

Për një shtet të së drejtës nuk ka asnjë alternativë tjetër përveçse asaj të ndalimit absolut të torturës. Propozime të tilla si vendosja e disa kufijve ose e rasteve përjashtimore dhe njëherazi qenia shtet i së drejtës është kontradiktore. Kur ka çështje, të cilat venë në diskutim dinjitetin e njeriut, atëherë kërkohet qartësi dhe konsekuencë. Shteti nuk duhet të arrijë deri aty sa të sajojë shprehje sofiste në vend të fjalës “torturë” të parashikojë “detyrim për të kallëzuar”, në mënyrë që t'i lejojë vetes veprime ekstreme. Ndalimi dhe mos ushtrimi i torturës duhet të jetë jo i dyzuar, por i qartë²⁰.

Ndalimi i torturës është një shembull i mirë për të vërtetuar se edhe në kohërat e sotme, kur kërcënimi nga terrorizmi po vjen duke u rritur, ka norma që parashikojnë të drejta themelore që janë dhe duhet të mbeten të paprekshme për shtetin e së drejtës. Diskutimet, që kanë lindur sot lidhur me vendosjen e

²⁰ Që ky ndalim të jetë i frytshëm, duhet të eksiztojnë edhe institucionet përkatëse që ta garantojë respektimin e tij. Jo vetëm kaq, por të zbatohen edhe parime të njohura për garantimin e të pandehurit si: ndalimi i deportimit ose kthimit në vendet ku lejohet tortura, miratimi i akteve që të vendosin sanksione për vendet që nuk e dënojnë ushtrimin e torturës etj.

parimit të proporcionalitetit midis të drejtave dhe lirive nga njëra anë dhe masave të sigurimit publik nga ana tjetër, nuk duhet të shkojnë deri në atë gradë sa të jepet përshtypja se kjo është thjesht çështje balancash në një moment dhe kohë të caktuar. Nëse ndodh kështu, do të vijë shpejt dita kur të drejtat dhe liritë themelore do vijnë gjithmonë e më shumë duke u cunguar, derisa të kthehen në disa të drejta luksoze që mund t'i gëzojmë vetëm në kohë paqe dhe qetësie absolute.

Një nga kriteret që duhet të plotësojë një shtet i së drejtës është edhe respektimi i të drejtave dhe lirive themelore. Në një shtet të së drejtës politika e sigurisë është në shërbim të të drejtave dhe lirive dhe jo e kundërta. Kjo është arsyeja që siguria dhe liria nuk mund të vendosen në mënyrë abstrakte përballë njëra-tjetrës. Vetëm nëse shteti në luftë kundër “*armiqve të lirisë*” kujdeset që të mos shkelë të drejtat dhe liritë e njeriut, atëherë ai arrin të garantojë besueshmërinë e tij, të fitojë mbështetjen e shtetasve të vet. Është pikërisht kjo mbështetje dhe ky besim i qytetarëve që i shërben shtetit si mjeti më i frytshëm për të luftuar terrorizmin.

Nëpërmjet respektimit të vazhdueshëm të të drejtave dhe lirive të njeriut shteti nuk dobësohet, përkundrazi ai e forcon edhe më shumë autoritetin e tij. Të njëjtën gjë thekson edhe Leandro Despouy, Relator i Posaçëm i OKB-së për çështjen e pavarësisë së gjyqtarëve dhe të avokatëve. Në raportin e tij të paraqitur para Komisionit për të Drejtat e Njeriut të OKB-së në vitin 2004, ai shprehu bindjen se terrorizmi “*nuk mund të luftohet me efikasitet nëse përdoren mjete që vijnë në kundërshtim me të drejtën në përgjithësi dhe atë ndërkombëtare publike në veçanti. Masa të tilla mund të arrijnë qëllimin e kundërt, pra stimulimin e terrorizmit ose kryerjen e sulmeve të tjera më të dhunshme, ndërsa sistemi ndërkombëtar i së drejtës dhe mundësitë e parandalimit dhe të reagimit të shteteve do të fundosen*”²¹.

²¹ Report of the Special Reporter of the Commission on Human Rights on the Independence of Judges and Lawyers, Leandro Despouy, E/CN.4/2004/60.

Për ta formuluar pozitivisht: respektimi i përpiktë i të drejtave dhe lirive të njeriut nuk është vetëm detyrim moral, por edhe ligjor; jo vetëm kaq, ai është edhe i arsyeshëm nëse do ta shohim nga pikëpamja e politikës së sigurisë.

Mendime juridike mbi të drejtën publike referuar legjislacionit shqiptar

Elsa DODJANI

1. KONCEPTI I TË DREJTËS PUBLIKE

Jemi mësuar që të mendojmë se çfarë është shtet është publike. Shkenca e së drejtës publike ka dhënë përkufizimin e saj për të drejtën publike, por duke i parë në evoluim të vazhdueshëm konceptet publike si “shtetin” dhe “interesin publik” për shkak të faktorëve të ndryshëm që kanë ndikuar në këtë drejtim, kryesisht ato politike, sociale, juridike, mendojmë se kjo shkencë duhet të reflektojë në vazhdimësi elementet e këtyre ndryshimeve. Duhet të kemi parasysh se sot shoqëritë e zhvilluara, krahas shtetit, kanë dhe forma të tjera organizimi kolektiv që, gjithashtu, konsiderohen publike. Që të sqarojmë raportin mes “shtetit” dhe “publikes”, duhet të kemi të qartë nocionet që këta dy terma mbartin në vetvete. “Shteti” si koncept në aspektin historik zë fill, në përdorim të plotë të këtij termi, nga shekulli XVII. Fjala nisi të qarkullojë si term politik, duke bashkëjetuar gjithmonë e më pak me termin *res publica* (me shoqërinë e organizuar politikisht si një e vetme) dhe të njehsohet me strukturat e komandimit, si pushtetin, dhunën që i vënë kufizime shoqërisë nëpërmjet një autoriteti publik final¹. Me lindjen e shtetit lindi dhe e drejta, që shkenca juridike e pranon përgjithësisht si grumbull normash juridike të sanksionuara nga shteti. Këto norma juridike shteti jo vetëm i sanksionon, por kujdeset për zbatimin e tyre. Shteti, i konceptuar si një

¹ Filo.LL. “Historia e sistemeve te qeverisjes”, Tirane 2001.

organizatë politike njerëzish, siguron në radhë të parë zbatimin e atyre normave që shprehin interesat e grupeve shoqërore me ndikim më të madh, sepse duhet të pranojmë se normat juridike jo gjithmonë pasqyrojnë vullnetin e gjithë popullsisë së një shteti. Normat juridike normalisht duhet të pasqyrojnë vullnetin e pjesës dërrmuese dhe më të gjerë të shoqërisë, sepse pa mbështjen e një baze të fortë shoqërore, asnjë forcë politike dhe asnjë qeveri nuk mund të qeverisë. Nga kjo lloj filozofie, e ka bazën dhe mendimi se çfarë është shtet është dhe publike, duke e përforcuar me lidhjen e fortë që ekziston mes shtetit që qëndron më këmbë nga ekzistenca e vullnetit të një popullsie, si dhe të drejtës që ky shtet kërkon të zbatojë me forcë detyruese në shumicën e rasteve, që derivon nga ato norma juridike, që përgjithësisht i pëlqen shumica e popullsisë.

Që në kohët më të lashta juristë të njohur të asaj kohe si Ulpiani (jurist romak) bënë një përkufizim të tillë për të drejtën publike: *“E drejtë publike është ajo që ka të bëjë me gjendjen e shtetit romak, e drejta private ka të bëjë me interesat e personave të veçantë, sepse ekziston interes privat dhe interes publik”*. Do të vazhdoja më tej me këtë logjikë dhe të shtoja se kjo ndarje përforcohet dhe nga ekzistenca e asaj që quhet “sferë publike” dhe “sferë private”, si dhe e atyre që quhen “çështje publike” dhe “çështje private”. Sfera publike përfshin shtetin, institucionet e tij, funksionimin e aparatit qeverisës, gjykatat, policinë, ushtrinë si dhe obligimet e shtetasve si punonjës zyrtarë në qeverisje ose thjesht si shtetas. Sfera publike është e tillë, sepse është e përgjegjshme për organizimin kolektiv të jetës komunitare². Sferat e tjera të jetës, të cilat individët përpiqen t’i administrojnë vetë dhe për vetveten, janë në një masë të gjerë “jopublike”, pra private.

Nëse do i referoheshim³ autorëve nga më të parët në Shqipëri, ata kanë dhënë si përkufizim të konceptit të drejtë publike: *“tërësinë e normave*

² Po aty, fq.28

³ Shiko Omari L. "Parime dhe institucione të së drejtës publike", fq.6

juridike që kanë të bëjnë me statusin e shtetit dhe të qeveritarëve, si dhe normave që rregullojnë marrëdhëniet mes qeveritarëve dhe shtetasve". Ky koncept duhet riparë në aspektin e subjekteve që qëndrojnë në këtë marrëdhënie juridike, sepse me kohë shkenca juridike ka evoluar bashkë me konceptet e saj themelore. Sot literatura bashkëkohore juridike shqiptare, bazuar mbi legjislacionin shqiptar, i referohet shumë analizës mbi fjalën "publike", qoftë si terminologji, por dhe në aspektin se çfarë konteksti juridik mbart në vetvete si nocion. Po kështu, teori të ndryshme doktrinare ndër vite kanë pranuar se në të drejtën publike bëjnë pjesë degët e së drejtës që sanksionojnë marrëdhëniet mes organeve të shtetit dhe shtetasve, si dhe marrëdhëniet e organeve shtetërore mes tyre. E drejta kushtetuese, si dhe e drejta administrative njihen dhe pranohen nga shumica e juristëve si degë të së drejtës publike, pavarësisht nga kundërshtitë e ndryshme që mund të ekzistojnë, prandaj, në vijim do t'i referohemi këtyre dy degëve të së drejtës, për të analizuar subjektet, objektin dhe burimet e së drejtës publike.

Së pari, përsa i përket subjektit "shtet" ose "qeveritar", autori S. Sadushi⁴ shprehet se akti administrativ ka aspektin e tij të njëanshëm në kuptimin se detyrimisht në njërën anë të tij qëndron shteti, nëpërmjet organit të administratës publike. Pra, ky autor e identifikon shtetin me organin e administratës publike dhe jo me organin e administratës shtetërore. Kësaj logjike autori i qëndron jo pa qëllim, sepse si normat juridike kushtetuese dhe normat juridike administrative, që do t'i analizojmë në vazhdimësi të këtij punimi, përmendin termin "organ publik" dhe jo më "organ shtetëror"; kjo përsa i përket aspektit terminologjik. Por dhe në aspektin juridik, fjalën "shtet" nuk e përdorim në "strictu sensu" veç për organet shtetërore, por dhe për organe të tjera që janë joshtetërore, por mbulojnë interesa publikë. Duke qenë se të drejtën publike e lidhim ngushtë me të drejtën kushtetuese dhe të

⁴ Sadushi, S. "E drejta administrative 2", fq 22.

drejtën administrative, për sa i përket normave juridike, ata studjohen si norma që të paktën, nga njëra anë, derivojnë nga organet e administratës publike⁵, e cila është një shumatore e administratës shtetërore, me entet publike në marrëdhëniet juridike administrative, ose më saktësisht, po t’i referoheshim Kushtetutës, do të thonim që derivojnë nga “organet e pushtetit publik”⁶ në fushën e marrëdhënieve juridike-kushtetuese. Për sa i përket termin “qeveritar”, do të ishte me vend të përdorej termi “autoritet publik”, nisur dhe nga shpjegimi që i ka dhënë⁷ ligji për të drejtën e informimit këtij termi. Pavarësisht se ky ligj shpjegimin e termin autoritet publik e bën për qëllimet e tij, nuk ka pse mos t’i japim koncept të zgjeruar termin “autoritet publik”, i cili duhet të përfshijë jo vetëm organe të administratës shtetërore dhe ente publike, por në tërësi organe të pushtetit publik, siç referon Kushtetuta jonë.

Së dyti, për sa i përket subjektit “shtetas”, të drejtën publike me tërësinë e marrëdhënieve që ajo rregullon nuk mund ta lidhim veç me shtetasit si subjekte të saj nga njëra anë, por me individët, dhe kjo për arsyen se Kushtetuta⁸ jonë ka parashikuar se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut,

⁵ Kodi i Procedurave Administrative, neni 3, ku përcaktohet:

Në kuptimin e këtij Kodi, organe të administratës publike janë:

- organet e pushtetit qendror, të cilat kryejnë funksione administrative;
- organet e enteve publike, në masën që ato kryejnë funksione administrative;
- organet e pushtetit vendor që kryejnë funksione administrative;
- organet e Forcave të Armatosura, si dhe çdo strukturë tjetër, punonjësit e të cilës

gëzojnë statusin e ushtararakut, për aq kohë sa këto kryejnë funksione administrative.

⁶ Neni 15 i Kushtetutës përcakton:

“Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.”

⁷ Ligji nr.8503, datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit”, neni 3 përcakton:

“Me autoritet publik, kuptohet çdo organ i administratës shtetërore dhe enteve publike.”

⁸ Neni 16 i Kushtetutës përcakton:

“Të drejtat dhe liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejnë njëlloj edhe për të huajt e për personat pa shtetesi në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të

vlejnë njëllor si për shtetasit dhe për joshitetasit shqiptarë dhe organet e pushtetit publik janë të detyruara të respektojnë individët në të drejtat dhe liritë e tyre themelore.

Kështu, përkufizimi më i saktë i të drejtës publike do të ishte jo vetëm tërësia e normave juridike që rregullojnë marrëdhëniet midis qeveritarëve dhe shtetasve, por si *“tërësia e normave juridike që rregullojnë marrëdhëniet juridike midis organeve të pushtetit publik mes tyre, si dhe organeve të pushtetit publik dhe individëve”*⁹, në fushën e marrëdhënieve juridike publike.

Tërësia e këtyre normave mund të jetë e natyrës juridiko-kushtetuese, juridiko-administrative, juridiko-financiare, juridiko-penale, mbi bazën e të cilave bëjmë dhe klasifikimet e nëndegëve të së drejtës publike që janë e drejta kushtetuese, e drejta administrative, e drejta financiare, e drejta penale materiale dhe procedurale etj.

Ne vazhdojmë t’i qëndrojmë argumentit të dhënë që nga juristët e kohës së Ulpianit, se ndarja kryesore mes së drejtës publike dhe private është interesi, që në këtë rast themi se është *interesi publik* për të drejtën publike. Përgjithësisht, siç e përmendëm dhe më lart, sot interesat publike nuk i mbulon më veç shteti, por dhe organizma joshitetorë, siç janë entet publike që në legjislationin vendas është pranuar se janë subjekte të së drejtës publike¹⁰.

posaçme, me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave dhe të lirive të caktuara.

⁹ Shih Toska E. “Shtetësia, të huajt, personat pa shtetësi dhe gjendja juridike e tyre”, botuar në “Tribuna Juridike”, Dhjetor 2006, Botim i Fondacionit “Për kulturë juridike”.

¹⁰ Kodi Civil, neni 25 përcakton:

“Personat juridikë publikë janë institucionet e ndërmarrjet shtetërore që financohen vetë ose nga Buxheti i Shtetit, si dhe entet e tjera publike të njohura nga ligji si persona juridikë”.

Neni 1 i ligjit 8480, datë 27.05.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, përcakton:

“Me ent publik për qëllimet e këtij ligji do të kuptohet çdo subjekt i së drejtës publike, joshitetorë, i krijuar me ligj dhe që synon realizimin e një interesi publik.”

Kështu, interesi publik është ai që i përket, parimisht, bashkësisë kombëtare, territoriale ose jo¹¹, megjithatë doktrina analizon se dallohen tri tipe interesash legjitime:

- Në kuptim të ngushtë pozitiv, interesat publikë janë ato që legjislatori i konsideron të tilla; dhe mund të trajtohen si të tillë dhe interesat materiale të qëndrueshme në sektorë të caktuar ose jo, por që, megjithëkëtë, ligji, me një zgjedhje politike, e konsideron si interes publik.

- Interesi kolektiv rrjedh nga konkretizimi i jetës shoqërore të një grupi ose kategorie shoqërore, të një bashkësie të papërcaktuar dhe të shpërndarë, në subjekte që vetorganizojnë një qendër referimi, me qëllim mbrojtjen e interesave publikë. Në këtë rast kemi të bëjmë me interesat e një grupi dhe jo të subjekteve të veçantë dhe as të një tërësie subjektesh të papërcaktuara. Ligji italian specifikon që mbajtësit e këtyre interesave janë të organizuar në shoqata ose komitete. Në mungesë të një qendre organizative, interesat e përbashkët të një shumice subjektesh të papërcaktuara janë interesat të shpërndarë, të cilët i përkasin secilit prej subjekteve në individualitetin e tyre; këta, pra, janë mbajtës të interesave të shpërndarë. Interesi i shpërndarë konsiderohet dhe si interes privat, pasi fakti që interesi është i përbashkët nuk përjashton të qenit vetjak në të njëjtën kohë.

- Interesi privat mund t'i përkasë çdo subjekti, qoftë ky person fizik ose subjekt tjetër, përballë ushtrimit të pushtetit. Interesat private nuk mundën veçse të individualizohen konkretisht përballë ushtrimit të një pushteti. Këta mund të përcaktohen vetëm duke iu referuar çdo interesi ose të mire të jetës individuale, familjare, ekonomike dhe sociale të çdo subjekti. Ndërkohë që për identifikimin e një interesi publik është referues ligji, dhe për interesin kolektiv-interesat e qendrës përkatëse; interesi vetjak nuk mund të individualizohet *a priori*, edhe ai buron nga ligji.

¹¹ Vokopola. A. “Palët e interesuara në një procedim administrativ”, botim i fondacionit “Për kulturë juridike”, Tribuna Juridike, nr.54, viti 2005.

Mbajtësit e interesave publikë janë organet ose entet publike, të përfshira në organizimin publik, interesi publik i të cilëve derivon nga ligji. Mbajtësit e interesave kolektivë janë qendrat organizative, të tipeve të ndryshme dhe natyrave juridike të ndryshme që grupet sociale i kanë dhënë. Mbajtësit e interesave privatë (qoftë dhe të shpërndarë) janë subjektet, sfera individuale e të cilëve preket. Nuk duhet harruar këtu që një organ ose ent publik mund të jetë mbajtës i një interesi privat në ato raste ku ai shfaqet si subjekt i të drejtës private. Pozicioni i mbajtësve të interesave publikë është i tillë, që ata faktikisht nuk janë mbajtës të asnjë interesi të vetin, por të interesave të kolektivit, mbrojtja e të cilëve i është besuar këtyre të fundit dhe që duhet ta mbrojnë. Përballë këtyre interesave, *mbajtësit publikë kanë detyrimin e pushtetit për të vepruar*. Pikërisht mbajtësit e këtyre të drejtave janë palë të detyrueshme në një marrëdhënie në fushën publike.

Për të analizuar termin “interes publik” dhe kryesisht termin “publik”, i cili ka lidhje dhe me objektin e marrëdhënieve juridike dhe me subjektet e marrëdhënieve juridike në fushën e së drejtës publike, t’i kthehemi Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, e cila në normat kushtetuese e përdor fjalën “publike” në disa raste si “organe publike”, “financa publike”, “interesa publikë”, “sigurimi publik”, si dhe jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese¹², si organi kushtetues që bën interpretimin e normave kushtetuese.

Që në nenet e para kushtetuese¹³, ky term është përdorur në kuptimin e

¹² Vendimi i datës 8.03.2003 i Gjykatës Kushtetuese të RSH-së, e cila është shprehur se “Gjithsesi lista e çështjeve me interes publik nuk mund të jetë kurrsesi shteruese, pasi interesi publik duhet kuptuar në sensin relativ, në varësi të situatave të ndryshme që krijohen”.

¹³ Neni 9 i Kushtetutes përcakton se;

1.Partitë politike krijohen lirisht. Organizmi i tyre duhet të perputhet me parimet demokratike.

2.Partitë politike dhe organizatat e tjera, programet dhe veprimtaria e tyre mbështeten në metoda totalitariste që nxisin urrejtjen racore, fetare, krahinore ose etnike, që përdorin dhunën

të bërit të hapur të burimeve financave të partive politike, si dhe shpenzimet e tyre. Për këtë çështje është shprehur dhe Gjykata Kushtetuese¹⁴, e cila pohon se fondet e partive politike në asnjë rast nuk i shpëtojnë kontrollit dhe transparencës publike, pavarësisht se mund të mos kontrollohen nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (bëhet fjalë për donacione, dhurata të ndryshme që marrin partitë, jo për pjesën e financimit nga Buxheti i Shtetit).

Në vijim Kushtetuta¹⁵ jonë ka sanksionuar dy lloje të pronave: pronën publike e private dhe jo pa qëllim kushtetutëbërësi ka përdorur fjalën “publike”, sepse, nëse do i përmbaheshim fjalë për fjalë konceptit të dhënë më lart për të drejtën publike nga autori L. Omari, duhet të ishte thënë pronë private dhe pronë shtetërore, por është përdorur termi “pronë publike” në dispozitat kushtetuese, sepse në këtë kategori futen dhe prona të tjera që janë në administrim të enteve publike dhe që nuk janë tamam shtetërore, por shërbejnë për interesa publikë. Pra, dhe një argument tjetër kushtetues më shumë na është dhënë në këtë dispozitë, se termi “shtetërore” nuk është i barasvlefshëm

për marrjen e pushtetit ose për të ndikuar në politikën shtetërore, dhe ato me karakter të fshehtë janë të ndaluara me ligj.

3. Burimet financiare të partive si dhe shpenzimet e tyre bëhen kurdohere publike.”

¹⁴ Vendimi nr. 33, datë 9.5.2001 i Gjykatës Kushtetuese të RSH-së, e cila vëren: “Partitë politike, duke mos u kontrolluar nga pikëpamja financiare nga Kontrolli i Lartë i Shtetit për ndihmat apo dhuratat që ato përfitojnë nga burime të ligjshme, nuk mund t’i shmangin financat e tyre nga transparenca publike.

Neni 9, pika 3 e Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, detyron partitë politike që burimet financiare, si dhe shpenzimet e tyre t’i bëjnë kurdoherë publike. Prandaj, mosrespektimi i këtij detyrimi kushtetues, në kuptim edhe të nenit 131 shkronja “d” të Kushtetutës përbën juridiksionin kushtetues dhe njëren nga kompetencat e Gjykatës Kushtetuese, për të vendosur për kushtetutshmërinë e veprimtarisë së partive politike.”

¹⁵ Neni 11 i Kushtetutës përcakton:

“Sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike.

Kufizime të lirise së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike.”

me termin “publike”. Në një vendim të saj përsa i përket konceptit “pronë publike”, Gjykata Kushtetuese¹⁶ i referohet Dhomës së Noterëve si ent publik dhe konkludon se funksioni i noterit në thelb është një funksion publik i “deleguar”, qëllimi i të cilit është që të realizohet një shërbim i pavarur, i paanshëm, profesional e konfidencial në autentifikimin e një kategorie mjaft të rëndësishëm dokumentesh. Në këtë kuadër, parashikimi me ligj i funksionit me natyrë mbikëqyrëse të Ministrit të Drejtësisë ndaj noterisë, nuk është antikushtetues, sepse është i lidhur me kontrollin e respektimit të funksionit që u është deleguar noterëve nga shteti dhe që shprehet në vlerën që kanë dokumentet e tyre si “pronë publike.”

Më tej në Kushtetutë¹⁷, është përdorur termi “organet e pushtetit publik”. Që të kuptojmë se kush janë këto organe të pushtetit publik duhet t’i kthehemi përsëri Kushtetutës¹⁸, e cila na përcakton ekzistencën e tri pushteteve: ekzekutiv, legjislativ e gjyqësor. Logjikisht mund të themi se organet e pushtetit publik janë të gjitha organet që përfshihen në këto tri pushtete, siç është Kuvendi për pushtetin legjislativ, gjykatat për pushtetin gjyqësor dhe organet e pushtetit qendror, vendor, forcat e armatosura dhe entet publike për pushtetin ekzekutiv. Por lind pyetja: Po Presidenti i Republikës, që nuk bën pjesë në asnjë nga pushtetet, a është organ i pushtetit publik, pra organ që ushtron pushtet publik?

Mendoj se kjo pyetje ka rëndësi në aspektin doktrinal, sepse, praktikisht, nuk besoj se ka vend për dyshime, pra që Presidenti është organ i pushtetit publik¹⁹. Aq më tepër që Gjykata Kushtetuese, në një vendim të saj, është

¹⁶ Vendimi nr.3, datë 19.01.2005 i Gjykatës Kushtetuese të RSH-së.

¹⁷ Neni 15 i Kushtetutës përcakton: “Organet e pushtetit publik në përmbushje të detyrave të tyre duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut si dhe të kontribuojnë për realizimin e tyre”.

¹⁸ Neni 7 i Kushtetutës përcakton: “Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe ballancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor”.

¹⁹ Vendimi nr.38, date 23.12.2003 i Gjykatës Kushtetuese të R.SH-së.

shprehur se natyra juridike e aktit përcaktohet në radhë të parë nga marrëdhënia që rregullon dhe nga lloji i veprimtarisë që ushtron organi që e nxjerr. Nga përmbajtja dhe fryma e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë del se veprimtaria e Presidentit të Republikës si kryetar shteti, ka elemente të tri pushteteve: legjislativ, ekzekutiv e gjyqësor. Për këtë arsye Ai ka kompetencë të nxjerrë si akte që janë shprehje e drejtimit politik, ashtu edhe akte (dekrete) individuale, që për nga natyra e tyre afrojnë më shumë me veprimtarinë ekzekutive urdhërdhënëse të administratës shtetërore.

Organet e pushtetit publik janë dhe më gjerë se përcaktimi i bërë në nenin 7 të Kushtetutës për ekzistencën e tri pushteteve. Kjo për arsye se ekzistojnë dhe organet e pavarura kushtetuese që nuk futen në asnjë nga pushtetet e përcaktuara kushtetuese, por që veprojnë për interesa publikë dhe ushtrojnë realisht pushtet me mjete ligjore dhe forcën shtrënguese që u ka dhënë ligji. Kemi disa të tilla²⁰ dhe mund të përmendim Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Këshillin e Lartë të Drejtësisë e organe të tjera, të cilat janë brenda kategorisë së organeve që ushtrojnë pushtet publik, por që ruajnë fizionominë e tyre, të qenit organe kushtetuese të pavarura, që nuk bëjnë pjesë në asnjë nga pushtetet. Mund të themi se të gjitha institucionet publike që ushtrojnë pushtet publik, janë organe të pushtetit publik, sipas kuptimit që i ka dhënë Kushtetuta jonë këtij termi.

Në vazhdimësi gjejmë shprehjen “interesa publikë”²¹ dhe këtë e kuptojmë si interesa më të gjerë se sa interesat e prekur të disa personave në rreth më të ngushtë, në raport me atë që përfiton shoqëria në këtë rast. Megjithatë,

²⁰ S.Sadushi “E drejta administrative 2”, fq 25.

²¹ Neni 17 i Kushtetutes përcakton:

“Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë kushtetutë mund të vendosen veç me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjeveve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.”

Gjykata Kushtetuese²² në disa vendime të saj është shprehur lidhur me interpretimin e këtij termi kushtetues, te cilave mund t' u referohemi rast pas rasti. Këtë term e gjejmë të shpjeguar si në rastin kur sipas ligjit për deklarimin e pasurive, u pretendua para Gjykatës Kushtetuese²³ se ka cenim kushtetues të mbrojtjes së të dhënave vetjake, si kur u pretendua nga ish-pronarët se ka

²² Vendimi nr.26, datë 2.11.2005, i Gjykatës Kushtetuese të RSH-së e cila vëren se në pikën 1 të nenit 9 të ligjit nr.9235, datë 129.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” ka shkelje me karakter konceptual, të cilat cenojnë parimin e sigurisë juridike si pjesë përbërëse dhe e rëndësishme e shtetit të së drejtës, garantuar nga nenet 15, 17 e 18 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë. Doktrina e së drejtës kushtetuese ka pranuar se siguria juridike është ndër elementet thelbësore të shtetit të së drejtës. Kjo siguri presupozon veç të tjerave besueshmërinë e qytetarëve te shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me faktin se qytetari nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve normative që cenojnë dhe përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. “Nuk do të kishim të bënim me një rast të garantimit të besueshmërisë në sistemin e normave juridike nëse siguria lidhur me një situatë të caktuar juridike, nuk mund të justifikohet dhe nuk mund të mbrohet materialisht”. Duke afirmuar parimin e sigurisë juridike dhe të elementeve kryesore përbërëse të saj, Gjykata Kushtetuese vë në dukje se ky parim nuk mund të prevalojë në çdo rast. Kjo do të thotë se, nëse paraqitet rasti që një rregullim ligjor ndryshe i një marrëdhënieje ndikohet drejtpërdrejt nga një interes publik, me të gjitha elementet e tij thelbësore, ky interes natyrisht do të ketë përparësi ndaj parimit të sigurisë juridike. Nga shqyrtimi i çështjes del se në rastin e dhënë, ndryshimi i ligjit të favorshëm ndaj një grupi të caktuar të popullsisë, nuk justifikohet me ndonjë interes publik të qenësishëm. Është e vërtetë që dispozita e ndryshuar favorizon pronarët e banesave, por, nga ana tjetër, ajo diskriminon një grup tjetër (dhe pse të vogël në numër), duke iu cënuar të drejtën minimale për të jetuar, atë të pasjes së një strehe. T'u mohosh të drejtën shtresës së qiramarrësve për t' u bërë pronarë, t' u ndërpresësh kontratën e qirasë pa garantuar strehë tjetër, janë veprime që nuk mund të përligjen me interesin publik.

²³ Vendimi nr.16, datë 1.11.2004 i GJK të RSH-së. Gjykata Kushtetuese vë në dukje gjithashtu, se vetë neni 35 i Kushtetutës krijon mundësinë e bërjes publike të të dhënave vetjake edhe pa pëlqimin e personit, nëse një gjë të tillë e “kërkon ligji” (paragrafi 1) ose në rastet e “parashikuara me ligj” (paragrafi 2). Një kufizim i tillë, në kushte të caktuara, gjen mbështetje edhe nga neni 17 i Kushtetutës (kufizimi të bëhet “...vetëm me ligj, për një interes

cenim të së drejtës së pronës si e drejtë kushtetuese, nga të strehuarit në shtëpitë e tyre, që gëzonin statusin e të pastrehut, po ashtu dhe në çështjen sipas të cilës u pretendua për antikushtetutshmëri të disa neneve të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve²⁴. Në të gjitha rastet është bërë interpretimi i termit “interes publik”, dhe e rëndësishme është të theksohet se interesi publik prevalon përpara parimit të rendit dhe sigurisë juridike.

Më tej, Kushtetutasanksionon lirinë e fesë dhe ndërgjegjes dhe të drejtën e bërjes publike nga çdo individ, të bindjeve ose besimit të tij²⁵. Në të njëjtën logjikë vazhdon dhe neni 35, sipas të cilit personi ka të drejtë të mos bëjë publike të dhëna që lidhen me personin e tij, të karakterit vetjak ose sensitiv, veçse kur një gjë të tillë ia kërkon vetë ligji²⁶. Por dallimi mes këtyre dy të drejtave kushtetuese të individit qëndron në faktin se në rastin e parë ka të drejtë të bëjë publike besimin e tij, në rastin e dytë ka të drejtë të mos bëjë publike të dhënat e tij vetjake.

publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve...”). Duke pasur parasysh edhe KEDrNj, si dhe jurisprudencën e GjEDrNj, vlerësohet se rastet që do të justifikonin në tërësi kufizimin me ligj të kësaj të drejte do të ishin siguria kombëtare, mirëqenia ekonomike e vendit, mbrojtja e rendit kushtetues, parandalimi i veprave penale, mbrojtja e të drejtave dhe lirive të të tjerëve etj. Në çdo rast konkret, legjitimitimi ose jo i ndërhyrjes do të varej kryesisht nga intensiteti i saj, shkalla e cenimit të jetës private, domosdoshmëria e kësaj ndërhyrjeje në shoqërinë demokratike dhe në realitetin konkret që e ka diktuar atë, efektiviteti dhe proporcionaliteti në raportin e qëllimit që është synuar të arrihet dhe mjeteve të përdorura për arritjen e tij. Mbi të gjitha duhet patur parasysh se sa më shumë të depërtohet në sferën e jetës intime ose sensitive, aq më shumë rritet edhe detyrimi i pushtetit publik për mbrojtjen e jetës private.

²⁴ Shiko vendimin nr.30 të dat 1.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese të RSH-së.

²⁵ Neni 24 i Kushtetutes përcakton: “Askush nuk mund të detyrohet ose të ndalohe të marrë pjesë në një bashkësi fetare ose në praktikat e saj si dhe të bëjë publike bindjet ose besimin e tij.”

²⁶ Neni 35 i Kushtetutes përcakton: “Askush nuk mund të detyrohet përveç se kur e kërkon ligji të bëjë publike të dhëna që lidhen me personin e tij”.

Neni 37²⁷ i Kushtetutës flet për “sigurimin publik”, një tjetër term i përdorur nga hartuesit e Kushtetutës, që mund të njësohet me termin “interes publik”. Por, nisur nga e drejta e moskontrollimit trupor të individit, përveç rasteve kur i kanoset rrezik sigurimit publik, që ka sanksionuar kjo dispozitë, kushtetutëbërësi ka gjetur me vend termin “sigurim publik”.

Neni 41 sanksionon garancinë e të drejtës së pronës që mund të kufizohet veç për interesa publikë²⁸. Gjykata Kushtetuese shpreh në një vendim të saj se ekzistenca e elementeve të interesit publik, mund të përligjë cenimin e të drejtës së pronës, por vetëm me një ligj tjetër²⁹.

²⁷ Neni 37 i Kushtetutës përcakton: “Askujt nuk mund t’i behet kontroll vetjak jashtë procesit penal me përjashtim të rasteve të hyrjes në territorin e shtetit dhe të daljes prej tij ose për të mënjeluar një rrezik që i kanoset sigurimit publik”.

²⁸ Neni 41 i Kushtetutes përcakton: ” Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës veç për interesa publikë...”.

²⁹ Vendimi i datës 15.2.2005 i Gjykatës Kushtetuese të RSH-së, vëren se një ndër kriteret kushtetuese që gjen zbatim në këto dispozita ligjore të sipërcituara është “interesi publik”. Çdo ndërhyrje ndaj pronës mund të justifikohet vetëm nëse është në interesin publik ose të përgjithshëm. “Marrja e pronës në bazë të një politike të llogaritur për të arritur drejtësi shoqërore brenda komunitetit mund të përshkruhet saktësisht si politikë në interesin publik.” Prandaj i njihet e drejta ligjvënësit që, për arsye të ekzistencës së interesit publik, të mund të kufizojë hapësirën e disponimit të pronës private. Me qëllim që një ndërhyrje e tillë ndaj të drejtës së pronës të jetë e justifikuar, është e domosdoshme që të ekzistojë edhe një marrëdhënie përpjesëtimore midis mjeteve të përdorura dhe synimit që kërkohet të realizohet. Mbi këtë bazë, sistemi ligjor duhet të përbajë një sërë garancish procedurale për të siguruar që ndikimi i tij mbi të drejtën e pronës të mos jetë arbitrar dhe as i paparashikueshëm. Nga ky këndvështrim i problemit, përjashtimin ligjor për kufizimin e kthimit dhe të kompensimit të tokës bujqësore, që përmban neni 6 i ligjit, Gjykata Kushtetuese nuk e konsideron si të pajustifikuar. Kjo dispozitë ligjore ka parashikuar kufizimin për kthimin dhe kompensimin e tokës bujqësore deri në 60 ha, por një masë e tillë, jo vetëm që tejkalon në mënyrë të pakrahasueshme sipërfaqen minimale që vendoste ligji nr.7699, datë 21.04.1993 “Për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore”, por është e vlerësueshme nga ligjvënësi, në varësi të gjendjes që diktojnë rrethanat, në të cilat ndodhet toka bujqësore në Shqipëri.

Neni 42 i Kushtetutës³⁰ sanksionon të drejtën e një individit për një proces të rregullt ligjor. Sipas kësaj dispozite, kushdo për mbrojtjen e të drejtave të lirive dhe të interesave të tij kushtetues e ligjore ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik, brenda afateve të arsyeshme dhe nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Ky nen në abstraktin e paragrafit 2, të drejtën e një gjykimi publik.”, kërkon që çdo personi t’i jepet e drejta që çështja e tij të gjykohet nga një gjykatë në seanca publike ose e thënë ndryshe me dyer të hapura. Mbajtja e seancave me dyer të hapura është një parim themelor, i cili mbron

Për sa i përket dispozitave të tjera ligjore të kundërshtuara prej kërkuesit, ato parashikojnë, si kthimin pa kufizim të pronave të paluajtshme, ashtu edhe forma të ndryshme të kompensimit, sipas kuptimit kushtetues të shpërblimit të drejtë. Këto forma kompensimi që parashikon ligji “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” dhe posaçërisht neni 11 i tij, synojnë të vendosin një ekuilibër të drejtë ndërmjet interesave të ndryshëm. Në këto kushte, u takon organeve të autorizuara nga ligji “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” për të bërë, rast pas rasti, vlerësimin si për ekzistencën e problemit të interesit publik që përlligj kufizimin e të drejtës së pronës, ashtu edhe të masave që duhen marrë për të ndrequr situatën, nëpërmjet kompensimit të drejtë të pronës. Konsiderimet e mësipërme shpjegojnë kuptimin që kanë në të vërtetë nenet 6, 7, 8 dhe 13 të ligjit, objekt shqyrtimi, të cilët orientohen nga kriteret kushtetuese të “interesit publik” dhe të “shpërblimit të drejtë”. Prandaj, përderisa në përmbajtjen e tyre ekzistojnë kriteret që parashikon neni 41 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Gjykata Kushtetuese nuk gjen elemente antikushtetutshmërie.

³⁰ Vendimi nr.18 datë 14.5.2003 i Gjykatës Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese verën se “respektimi i parimit të paanshmërisë në veprimtarinë e komisioneve hetimore është pjesë përbërëse e kuptimit të nenit 6 paragrafi 1të Konventës Europiane, si dhe e konceptit kushtetues që lidhet me të drejtën për një proces të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutes. Pjesë e rëndësishme e respektimit të këtij parimi kushtetues është dhe kufizimi i lejueshëm që pranohet për zhvillimin e seancave jopublike. Në këtë aspekt, Gjykata Kushtetuese çmon se mundësia e publikut për të ndjekur seanca mund të kufizohet në disa rrethana të përcaktuara. Arsyet, për të cilat media dhe publiku mund të përjashtohen nga të gjitha seancat ose pjesë të tyre, janë morali, rendi publik, sigurimi kombëtar; kur e kërkojnë interesat ose jeta private e palëve ose në ato raste kur, sipas mendimit të komisionit hetimor ose për rrethana të posaçme publiciteti, dëmtohen interesat e hetimit.

palët nga një administrim sekret i drejtësisë pa një “mbikëqyrje” publike dhe që synon krijimin e besimit të publikut të pushteti gjyqësor. E drejta për një seancë publike përfshin në vetvete të drejtën për një “seancë me gojë”, përveçse kur ka rrethana të jashtëzakonshme, të cilat justifikojnë mosmbajtjen e një seance të tillë. Ndërkohë që e drejta për të patur një gjykim publik në lidhje me çështjen përkatëse është e lidhur pazgjidhshmërisht me të drejtën që vendimi të jepet publikisht, në kuadrin e paragrafit 2 të nenit 42 të Kushtetutës.

Neni 48,³¹ ku është sanksionuar e drejta e ankimit të individit përdor termin “organe publike” jo “organe shtetërore”. Pra, këtu kemi dhe një herë koncept të zgjeruar të Organeve të Administratës Publike. Po në këtë logjikë vazhdon neni 60³², i cili sanksionon ekzistencën e Institucionit të Avokatit të Popullit³³ dhe mbrojtjen që i jep individit për shkelje të të drejtave dhe lirive të tij nga organet e administratës publike. Vlen të theksojmë se nisur nga parashikimi i organeve të administratës publike nga KPA (neni 3) institucioni i Avokatit të Popullit ka ndërhyrë për mbrojtjen ligjore të individëve për shkelje të pretenduar prej tyre, jo vetëm në organet e administratës shtetërore, por dhe në entet publike, si Televizioni Publik Shqiptar.

Neni 107³⁴ sanksionon të drejtën e emërimit në detyrë të nëpunësve publikë

³¹ Neni 48 i Kushtetutës përcakton:

“Kushdo vetë ose së bashku me të tjerë mund t’u drejtojë ankesa ose vërejtje organeve publike të cilat janë të detyruara të përgjigjen në afatet dhe kushtet e caktuara me ligj.

³² Neni 60 i Kushtetutës përcakton:

“Avokati i Popullit mbron te drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike. Për më gjerë për këtë çështje shih Toska E. “Avokati i Popullit si mjet mbrojtjes efektiv sipas kërkesave të nenit 13 të KEDNJ-se”.

³³ Për më tepër shih Toska.E. “Avokati i Popullit, mjet mbrojtës efektiv sipas kërkesave të nenit 13 të KEDNJ-së”, Jeta Juridike”, mars 2006.

³⁴ Neni 107 i Kushtetutës përcakton: “Nëpunësit publikë zbatojnë veç ligjin dhe janë në shërbim të popullit. Nëpunësit në administratën publike caktohen me konkurs me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji.

dhe mbrojtjen ligjore dhe kushtetuese të tyre. Edhe këtu kemi parasysh që personat që do të konsiderohen “nëpunës publikë”, janë të gjithë ata punonjës të institucioneve publike, që gëzojnë statusin e nëpunësit civil ose trajtohen me ligje të tjera të veçanta si me Kodin e Punës e ligje të tjera. Këta nëpunës të institucioneve të administratës publike, në ushtrimin e detyrave të tyre ushtrojnë autoritet publik dhe, si të tillë, janë jo vetëm ata nëpunës që punojnë në organe shtetërore, por dhe në organet e pavaruara kushtetuese ose pranë enteve publike.

Nenet 155-161³⁵ sanksionojnë menaxhimin e financave publike, autoritetet

³⁵ Vendimi nr.33, datë 9.5.2001 i Gjykatës Kushtetuese. Në këtë vendim Gjykata Kushtetuese, veren se: Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas kuptimit që i ka dhënë Kushtetuta dhe vetë ligji i tij organik, është konceptuar si një organ që ka si objekt kryesor kontrollin e përdorimit efektiv dhe të dobishëm të fondeve publike, zhvillimin e miradministritim financiar, si dhe kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë në fushën ekonomike dhe financiare. Prandaj, ndihmat dhe dhuratat që partitë politike përfitojnë nga donatorë të ligjshëm dhe që nuk kanë të bëjnë me fondet publike, të analizuar edhe në këtë aspekt, dalin jashtë objektit të këtij kontrolli të specializuar.

Mbi bazën e argumenteve të parashtruara më lart, Gjykata Kushtetuese konkludon se ushtrimi i kontrollit ekonomiko-financiar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit mbi mënyrën sesi partitë politike i përfitojnë këto dhurata ose ndihma, që parashikohet në nenin 23 të ligjit “Për partitë politike”, nuk gjen mbështetje në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Duke marrë shkas nga mënyra e formulimit të fjalisë së dytë të nenit 23 të ligjit “Për partitë politike”, si dhe nga fakti se fusha e veprimtarisë të Kontrollit të Lartë të Shtetit, si institucion i kontrollit ekonomiko-financiar, nuk parashikohet vetëm në nenin 163 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese çmon të domosdoshme edhe parashtrimin e argumenteve të mëposhtme, pasi nuk mund të konkludojë për kërkesën e paraqitur nga kërkuesi, pa analizuar në tërësi kuptimin që në thelb përmbajnë nenet 9, 158, 162 dhe 164 të saj.

Partitë politike kanë personalitet juridik dhe, sipas ligjit, disponojnë edhe pasurinë e tyre, në të cilën përfshihen kuotat e anëtarësisë, çdo pasuri e fituar në mënyrë të ligjshme, si dhe ndihmat financiare në masën e caktuar në buxhetin e shtetit. Mospërfshirja e partive politike në rrethin e subjekteve që kontrollohen, sigurisht nuk e bën të pakontrollueshme veprimtarinë e tyre ekonomiko-financiare.

Një koncept të qartë ka sanksionuar Kushtetuta edhe lidhur me kontrollin mbi Buxhetin

kushtetuese për kontrollin e tyre, dhe jo pa arsye Kushtetuta nuk përdor termin “financa shtetërore”. Po t’i përmbahemi idesë se subjekte të së drejtës publike janë përveç shtetit dhe organizma të tjerë, si entet publike ose partitë politike, janë pikërisht financat e këtyre organeve që kontrollohen nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, si organ kushtetues i ngarkuar me detyrën e kontrollit ekonomik, financiar të financave publike. Janë disa lloje entesh publike si Urdhri i Mjekëve ose Radio Televizioni Shqiptar që sigurojnë fonde nga Buxheti i Shtetit dhe që për to ushtrohet kontroll financiar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit³⁶.

2. SUBJEKTE TË SË DREJTËS PUBLIKE

Nisur nga fakti se e drejta publike përbëhet nga tërësia e normave juridike me anë të të cilave realizohen detyrat dhe kompetencat e tri pushteteve, atëherë themi se subjekte të kësaj të drejte janë si Kuvendi i Shqipërisë, Gjykatat, Prokuroria, po ashtu dhe organet ekzekutive urdhërdhënëse të shtetit, që të gjitha më lart i kemi quajtur organe të pushtetit publik. Le të ndalemi tek organet ekzekutive urdhërdhënëse të shtetit si Kryeministri, Këshilli i Ministrave, ministrat e të tjerë, që i kemi quajtur pjesë të pushtetit ekzekutiv. E drejta administrative është degë e së drejtës publike, e cila studion këto organe të pushtetit ekzekutiv, dhe ne kemi pranuar se në të drejtën administrative, subjekte janë jo vetëm organet shtetërore, pra “shteti”,

e Shtetit. Kështu nenet 158 e 164, dispozita të cilat lidhen drejtpërdrejt me mënyrën e zbatimit të Buxhetit të Shtetit, si dhe me dëgjimin e raportit përpara se Kuvendi ta miratojë këtë buxhet, kanë ngarkuar Kontrollin e Lartë të Shtetit, si i vetmi institucion, për t’i ushtruar këto kompetenca. Pikërisht nga raportimi që Kontrolli i Lartë i Shtetit bën përpara Kuvendit lidhur me zbatimin e Buxhetit të Shtetit nga subjektet që kanë përfutur prej tij, ku përfshihen edhe partitë politike, buron edhe e drejta e këtij organi të specializuar, për të ushtruar kontrollin financiar mbi pjesën e buxhetit të partive që sigurohen nga fondet publike.

³⁶ Methasani, E. “Enti Publik, risi e legjislacionit tonë”, Jeta Juridike, Mars 2004 botim i Shkollës së Magjistraturës.

“qeveritarët”, sikundër thuhet në përkufizimin e së drejtës publike³⁷, por dhe organet e tjera joshtetërore, por që veprojnë në fushën e së drejtës publike. Kështu pjesërisht po i referohemi të drejtës administrative për një sens analizues më të thellë, lidhur me subjektet e së drejtës publike, për të pasur të qartë raportin që ekziston mes së drejtës publike dhe administrative. Nëse pranojmë se përveç organeve të administratës shtetërore janë dhe ato joshtetërore si organe të administratës publike në kuptim të gjerë që kryejnë veprimtari ekzekutive urdhërdhënëse dhe bien mbi rrezën e zbatimit të Kushtetutës, Kodit të Procedurave Administrative, atëherë themi se këto janë subjekte të së drejtës publike, fakt që e ka pranuar dhe legjislacioni ynë i mëvonshëm (ligji 8480). E kundërta, pra, ideja e mospranimit të subjekteve joshtetërore si subjekte të së drejtës publike do të na çonte në një raport *non sens* të së drejtës administrative dhe asaj publike, ku e drejta administrative do të na dilte koncept më i gjerë se sa e drejta publike, që faktikisht nuk mund të ndodhë, sepse ne kemi pranuar të kundërtën, që e drejta administrative rrjedh dhe është derivat i së drejtës publike. Mbështetësit e teorisë se e drejta administrative është degë e së drejtës publike, mes të cilëve dhe unë personalisht, lehtësisht do të vërenim se e drejta administrative si raport na del më e gjerë se e drejta publike, po t’i referohemi me fanatizëm përkufizimeve përkatëse për të dyja degët:

- E drejta publike si tërësi e normave juridike që rregullon marrëdhëniet mes shtetit dhe qeveritarëve dhe qeveritarëve dhe shtetasve;

- e drejta administrative si tërësi e normave që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën e së drejtës administrative mes organeve të administratës publike dhe individëve³⁸.

³⁷ Gjithmonë për qëllimet e kësaj analize po i referohemi përkufizimit të dhënë nga Omari.L. dhe jo përpjekjes sime për një ripërkufizim të së drejtës publike.

³⁸ Dobjani. E. “E drejta administrative 1”. fq.20

Në të vërtetë, përderisa e drejta administrative rrjedh nga e drejta publike, e pamë të nevojshme të bënim një ripërkufizim të së drejtës publike, të cilën e përcaktuam si tërësinë e normave juridike që rregullojnë marrëdhëniet juridike midis organeve të pushtetit publik mes tyre, si dhe organeve të pushtetit publik dhe individëve³⁹, në fushën e marrëdhënieve juridike-publike. Për të përcaktuar subjektet e së drejtës publike, nisemi pikërisht nga ky përkufizim dhe veçojmë si subjekte;

1. Organet e pushtetit publik ku përfshihen organet të pushtetit legjislativ, gjyqësor, ekzekutiv dhe ato organe që nuk bëjnë pjesë në asnjë nga pushtetet, por që ruajnë fizionominë e tyre si organe kushtetuese të pavarura.

2. Individët, qofshin shtetas shqiptarë, shtetas të një shteti tjetër që banojnë në Republikën e Shqipërisë, të huaj, persona pa shtetësi, por jo për të gjitha llojet e të drejtave që i përkasin të drejtës publike, sepse ka të drejta, siç është e drejta e votës që është e lidhur ngushtësisht me shtetësinë në vendin tonë, sipas legjislacionit shqiptar.

3. Personat juridikë publikë, vendas apo të huaj si organizata politike, shoqërore, kulturore e tjerë, që veprojnë në fushën e së drejtës publike për interesa publikë.

Në të vërtetë, po të vërejmë me kujdes, subjektet nuk është se ndryshojnë nga degët e tjera të së drejtës, por mendojmë se dallimi kryesor nuk qëndron te subjektet, por te marrëdhëniet juridike që ato rregullojnë në fushat përkatëse, si kushtetuese, administrative, penale e të tjera.

3. OBJEKTI I TË DREJTËS PUBLIKE

Përgjithësisht themi se e drejta publike rregullon organizimin politik të shoqërisë, krijimin dhe atributet e organeve të pushtetit publik, marrëdhëniet mes këtyre organeve ose mes tyre dhe individëve ose personave juridikë,

³⁹ Shih Toska E. “Shtetësia, të huajt, personat pa shtetësi dhe gjendja juridike e tyre”, botuar në “Tribuna Juridike”, Dhjetor 2006, Botim i Fondacionit “Për kulture juridike”.

sigurimin e të ardhurave të nevojshme për funksionimin e shtetit, shpenzimet e nevojshme nga buxheti publik, sanksionimi i shkeljeve të ligjit, krijimi dhe funksionimi i organeve që gjykojnë shkeljet e ligjit e të tjera. Kështu, konkretisht mund të themi se objekti i të drejtës publike janë ato marrëdhënie juridike që krijohen dhe lindin nga tërësia e normave juridike mes organeve të pushtetit publik dhe individëve, qofshin shtetas shqiptarë të huaj ose persona pa shtetësi që veprojnë në bazë të legjislacionit në fuqi si kushtetuta, ligjet dhe aktet nënligjore të dala nga këto organe në fushën e së drejtës publike, bazuar mbi një interes publik dhe që zbatohen nëpërmjet forcës shtrënguese të shtetit.

4. BURIMET E SË DREJTËS PUBLIKE

Si për çdo degë të së drejtës dhe në të drejtën publike, burimet e së drejtës janë të përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë⁴⁰. I vetmi burim, nëse do ta quajmë të tillë, i cili ngjall diskutime dhe debate dhe që lë vend për diskutim është precedenti gjyqësor. Doktrina e precedentit në sistemin tonë, edhe pse kontinental, duhet të mos pranohet, të diskutohet, sepse janë normat kushtetuese që të detyrojnë ta bësh këtë diskutim. Duke

⁴⁰ Neni 116 i Kushtetutës përcakton:

“Aktet që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë:

- a) Kushtetuta
- b) Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara
- c) Ligjet
- d) Aktet normative të Këshillit të Ministrave

2. Aktet që nxirren nga organet e pushtetit vendor kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit territorial që ushtrojnë këto organe”.

3. Aktet normative të ministrave dhe organeve drejtuese të institucioneve të tjera kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë brenda sferës së juridiksionit të tyre”.

iu referuar Kushtetutës,⁴¹ kemi të përcaktuar rolin që ka Gjykata e Lartë në funksionin e saj për ndryshimin dhe njesimin e praktikës gjyqësore. Kushtetuta i njeh juridiksion rishikues Gjykatës së Lartë. Po në këtë këndvështrim ajo i njeh këtij organi të drejtën e njesimit dhe ndryshimit të praktikës gjyqësore. Nëse një praktikë duhet njësuar, kjo bëhet se ajo ka qenë në luhatje kontradiktore dhe për shkak të nevojës për të disiplinuar një fushë të vështirë dhe të brishtë të zbatimit të ligjit. Nëse praktika do ndryshuar, kjo bëhet se ajo ka qenë konstante, por e gabuar. Të dy termat në fund të fundit kanë një gjë të përbashkët, vendosjen e një rregullimi ose rregulle të re. Duke pranuar se kjo rregull e re është e detyrueshme për gjykatat më të ulta në raste analoge, ne pranojmë në të vërtetë precedentin. Sipas autorit K. Traja,⁴² ka ardhur koha që të mos diskutohet më çështja nëse duhet përdorur precedenti në Shqipëri, por si të zbatohet ai me vetëdijen e avantazheve dhe disavantazheve që ka, sepse nga pikëpamja kushtetuese nuk ka më dyshim që ai vepron. Në këtë sens, ndoshta kur flasim për burimet e së drejtës publike, si dhe për burimet e çdo dege tjetër të së drejtës, krahas atyre që shprehimisht përcakton Kushtetuta, mos lëmë pa patur parasysh precedentin, jo vetëm për efekt studimi, si veçori e vendeve me sistemin e Comon-Law, por si pjesë e burimeve të së drejtës publike në Shqipëri.

PËRFUNDIME

Ky punim ka bërë një përpyekje për të riparë dhe një herë nocionet më të rëndësishme të së drejtës publike dhe mbi të gjitha të risjellë një koncept të evoluar të vetë “së drejtës publike”. Nisur nga ky ripërcaktim, duhet mbajtur

⁴¹ Neni 141 i Kushtetutës: “Për njesimin dhe ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë ka të drejtë të tërheqë për shqyrtime në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore”.

⁴² Traja.K. “Natyra juridike e vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Lartë, Koha e precedentëve”, botuar në “Jeta juridike”, botim i Shkollës së Magjistraturës, nr. 1, tetor, 2005.

parasysh se kush janë subjektet e së drejtës publike, që nëpërmjet analizës së mësipërme ne nxorëm se nuk janë vetëm “shtetasit”, por “*individët*”, nuk janë organet e administratës shtetërore, “qeveritarët”, por “*organet e pushtetit publik*”, “*autoritetet publike*”. Po kështu, interes paraqet analiza që i bëhet *precedentit gjyqësor* si burim i së drejtës publike që *de jure* Kushtetuta nuk e parashikon shprehimisht në nenin 116 të saj, por duhet të merret në konsideratë nga analiza që i bëmë nenit 141 të Kushtetutës sonë. Po në këtë prizëm duhet të ritheksojmë dhe njëherë të përbashkëtat e së drejtës publike me dy nëndegët e saj kryesore, e drejta kushtetuese dhe e drejta administrative, sepse nëse kemi pranuar se këto janë dy nëndegë, ato nuk mund të kenë koncepte më të zgjeruara se e drejta publike, pra si derivat i kësaj të drejte janë baza e analizës, për të nxjerrë përfundime mbi subjektet, objektin dhe burimet e së drejtës publike.

BIBLIOGRAFIA:

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, 1998,
2. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese vitet 1998- 2005,
3. Omari.L., “Parimet dhe institucione të së drejtës publike”, Tiranë 2004,
4. Filo. Ll., “Historia e sistemeve të qeverisjes”, Tiranë 2001,
5. Dobjani E., ‘E drejta administrative 1”, SHBLU, Tiranë 2003,
6. Sadushi .S.,”E drejta administrative 2”, Tiranë 2005,
7. Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë,
8. Methasani.E., “Enti publik; risi e legjislacionit të vendit tonë”, Jeta Juridike, Shkolla e Magjistraturës, mars, 2003,
9. Vokopola.A., “Palët e interesuara në një procedim administrativ”, botim i Fondacionit për Kulturë Juridike - Tribuna Juridike, nr.54, viti 2005,
10. Toska, E. Shtetësia, shtetasit shqiptarë, gjendja juridike e tyre, të huajt dhe personat pa shtetësi”, “Tribuna Juridike”, dhjetor 2005.
11. Traja.K., “Natyra juridike e vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Lartë,

Koha e precedentëve”, botuar në “Jeta juridike”, botim i Shkollës së Magjistraturës, nr. 1, tetor 2005.

12. Ligji nr.8480.datë.27.05.1999, “Për organizimin e organeve kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”.

13. Kodi i Procedurave Administrative,

14. Ligji nr.8503, datë 30.06.1999, “Për të drejtën e informimit për dokumente zyrtare”.

Të drejtat kushtetuese dhe statusi politik i femrave në Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë

Fatmira LUMANI
Universiteti i Tetovës

STATUSI I FEMRËS SHQIPTARE NËPËR PARTITË POLITIKE NË IRJM

Kur flasim për femrën shqiptare dhe përfshirjen e saj në politikë, nuk mund të anashkalojmë të kaluarën, pasi përmes saj mund të kuptojmë në mënyrë të drejtë pozitën dhe shkaqet që kanë ndikuar në të.

Pyetja për femrën shqiptare në politikë, është pyetje në vete. Ajo, deri para vitit 2001, mund të themi se as që mund të parashtrohej, jo më të zgjidhej. Lind pyetja: pse? Femra shqiptare ishte shumëfish e diskriminuar në të gjithë sferat e jetës, po ashtu edhe në sferën politike. Ishte e diskriminuar, ngase duke u bazuar në diskriminimin e popullit shqiptar më se gjysmë shekulli, ajo ndjeu diskriminim të shumfishtë: si atë kombëtar e me të edhe atë politik. E diskriminuar në baza kombëtare, ku shqiptarëve u mohoheshin liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe të qytetarit, ajo ngeli shumë prapa në sferën arsimore, ekonomike, sociale, politike etj. Arsimimi në gjuhën e saj amtare në të gjithë nivelet arsimore, përfshi edhe atë të lartë, që u bë i mundur me ligj, sidomos vitet e fundit, jo vetëm që filloi të bëjë hapa përpara në pozitën e shqiptarëve, por, gjithashtu, ajo filloi të çojë përpara edhe pozitën tejet të vështirë të femrës shqiptare. Pra, një nga pengesat kryesore, ajo arsimore, që e kishte barierë shekuj me radhë, tani nuk ekziston më. Tani asaj i mbetet

që me hapa të shpejtë të arrijë femrat e kombësive të tjera, që tashmë kanë fituar njëfarë përvoja në drejtimit e ndryshme, përfshi edhe atë politike dhe bashkarisht të luftojnë për barazi gjinore. I mbetet të hapërojë dhe t'i bashkëngjitet lëvizjes globale femërore për barazi mes femrave dhe meshkujve, duke përfshirë edhe sferën politike.

Edhe pse e diskriminuar shumëfish, femra shqiptare bëri hapat e parë duke u kyçur në arenën politike, përmes partive shqiptare politike. Në vijim përmes përpunimeve tabelare do të njihet pozita e femrës shqiptare në sferën politike në IRJM.

FEMRA SHQIPTARE NË ZGJEDHJET PARLAMENTARE

Zgjedhjet e fundit parlamentare 2002 në IRJM, si një ndër 10 shtetet e përfshira në implementimin e Projektit Rajonal -"Gratë mund t'ia arrijnë II". Integrimi i konceptit për barazi gjinore në partitë politike parlamentare, në periudhën prej shtatorit 2001 deri në qershor 2002 u realizuan një mori veprimtarish dhe seminare në kuadër të këtij projekti. Përfaqësues të dalluar të partive politike publikisht e përkrahën projektin dhe realizimin e seminareve. Nga partitë shqiptare të arenës së atëhershme politike ishte: PPD (Partia për Prosperitet Demokratik), PDSH (Partia Demokratike Shqiptare) dhe ADSHM (Aleanca Demokratike Shqiptare në Maqedoni).¹

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2002 u zgjodhën 120 deputetë, nga të cilët 21 femra, prej të cilave vetëm 1 femër shqiptare nga BDI-ja, e cila është edhe femra e parë e zgjedhur si deputete.

Përfaqësimi i pyetjeve për barazi gjinore, në partitë parlamentare politike, gjendja e barazisë gjinore në programet dhe veprimtaritë e partive politike -viti 2002.

¹ Gratë mund t'ia arrijnë II, Projekt nacional, Shkup 2002, (Përpunuar nga autorja)

1. Partia për Prosperitet Demokratik (PPD)

- Nuk ka statistikë për gjininë,
- Ka seksione femrash në dy organizata komunale partiake;

2. Partia Demokratike Shqiptare (PDSH)

- Nuk ka statistikë për gjininë;
- Është e formuar një organizatë e gruas në nivel vendor;
- Në vitin 1998 – një femër ministre;
- Në vitin 1998 – një femër kryetare bashkie (prefekte);

3. Aleanca Demokratike Shqiptare në Maqedoni (ADSHM)

- Ka 20 përqind femra të partisë;
- ”Forumi i Grave” model i organizimit të femrave;
- Zëdhënëse femër.

Situata në vitin 2004 është krejtësisht ndryshe: përafërsisht të gjitha partitë e dinë strukturën gjinore të votuesve të tyre, kanë të dhëna të ndara të përgjithshme për anëtarët e tyre, si dhe për anëtarët femra në pushtetin ligjëvënës dhe ekzekutiv në nivel kombëtar.

Mund të vërehen shumë ndryshime pozitive në programet partiake. Mungesa e tërësishme e paragrafeve për barazi gjinore në shumicën e programeve politike në vitin 2002 është zëvendësuar me situatën se tani vetëm një parti nuk mund të ofrojë asgjë përta i përket barazisë gjinore (PPD). Duke respektuar kuotën si diskriminim pozitiv, PPD mendon se femrat duhet të luftojnë për vendin e tyre në parti jo vetëm me kuota, por me sistemin më demokratik, sistemin e vlerave.²

Të gjitha partitë e tjera kanë së paku deklaram të përgjithshëm për përkrahje të barazisë gjinore. Partitë, të cilat kishin deklaratë të përgjithshme në vitin 2002, tani kanë qasje më të përpunuar, ndërsa disa zhvillojnë politika konkrete për barazi gjinore në sfera të ndryshme.

² Po aty.

A kishin partitë premtime zgjedhore në relacion me barazinë gjinore në zgjedhjet e fundit parlamentare?

PPD: Po – por jo vetëm premtim zgjedhor parlamentar, ka pasur femër bartëse të listës dhe një në vend të tretë (por për fat të keq fituan vetëm dy deputetë);

PDSH: premtuan më shumë vende për femrat në listat e tyre;

BDI: Ka dhënë premtim të përgjithshëm se do të kujdeset për barazi gjinore.

Programë të partive për barazinë gjinore

PPD: Në program ceken dhe përkrahen veprimtaritë për përmirësimin e statusit të femrave në parti dhe në përgjithësi në shoqëri, por nuk ka ndonjë program të veçantë për barazi gjinore;

Letër njoftim i partive shqiptare në përqindje, në vitin 2004:

Parti deputete	Deputetë në parlament	Femra
BDI	13,3	6.2
PPD	1.6	0
PDSH	5.8	0
Gjithsej	20.7	6.2

Burimi: Nacionalen projekt,2004 (përpunuar më tej nga autorja)

Fakte dhe numri në përqindje, v.2004

Femra	BDI	PPD	PDSH
-Femra votuese	50	50	37
-Femra anëtare të partive	35	panjohur	29
-Kuota për organe partiake	30	30	20
-Kuota për lista partiake në përqindje	30	30	30
-Respektim i kuotës 30 prej përqind	po	po	po
-Femra kandidate, zgjedhjet e fundit parlamentare	30	30	30
-Femra në udhëheqjen partiake, nivelin kombëtar	6.2	17.3	20
-Femra në udhëheqësin partiake nivelin vendor	25	panjohur	20

Po aty (përpunuar nga autorja)

Femrat partiake në pozitë dhe pushtet, viti 2004:

	BDI	PPD	PDSH
Kryetare e partisë	jo	jo	jo
Zëvendëskryetar	po	po	jo
Sekretar e përgjithshme	jo	jo	jo
Përqindja e femrave këshilltare	panjoh.	2	panjoh.
Përqindja e femrave prefekte	jo	jo	1
Femra kryetare parlamenti	jo	jo	jo
Femra deputete në parlament(përqindja)	6.2	jo	jo
Femra ministre	0	0	0

Po aty (përpunuar nga autorja)

Nga tabela e mësipërme vërejmë se është i nevojshëm ndryshimi strukturor në organizimet partiake dhe ndryshimi i metodave punuese që zotërojnë në korniza të partive politike, që të merren parasysh nevojat edhe të femrave edhe të meshkujve

Vërehet se femrat shqiptare janë në fazën fillestare politike, pa perceptim

të qartë politik se cilat mund të jenë pozicionet dhe rolet e tyre në partitë e veta amë dhe çka mund të bëjnë që të funksionojnë. Kjo sepse organizatave femërore partiake u mungon bashkëpunimi në relacion me drejtuesit e tyre partiak, me grupet e tyre parlamentare, si dhe lidhja mes organizatave të tyre partiake dhe lobit të femrave. Gjithashtu, mungon bashkëpunimi i tyre me OJQ, me LOGM, me grupet femërore në kuadër të sindikatave, si dhe me mediat. Në këtë rast nevojitet të formohet një Lidhje e Organizatave të Grave Shqiptare në Maqedoni LOGSHM me të gjithë të drejtat, detyrimet, përkrahjet si qeveritare, ashtu edhe ato joqeveritare që i ka edhe LOGM. Ajo duhet të luajë rolin kyç në përparimin e femrës shqiptare në politikë, ngase çështja e femrës shqiptare është një çështje më vete dhe duhet zgjidhur në veçanti. Kur bëhet fjalë për bashkëpunimin me mediat, kjo nënkupton se ato më shumë janë të koncentruara në vetvete, të mbyllura në partitë e tyre dhe se organizatat e tyre femërore partiake ende nuk kërkojnë mënyra që ta bëjnë punën e tyre transparente për publikun.

Po ashtu, në arenën politike ndihet mungesa e femrave politikane shqiptare, të cilat opinioni do t'i vështrojë si politikane të dalluara. Ky është një tregues se gati të gjitha partitë politike kanë mungesë të femrave politikane të profilizuara në nivel kombëtar dhe atë vendor.

Pasqyrë e partive politike parlamentare shqiptare: barazia gjinore, deklarativisht të barabarta dhe jo të barabarta, sipas përgjigjeve të dhëna nga pjesëmarrësit e seminareve:

Femrat shqiptare në zgjedhjet vendore 2005

Pjesëmarrja e femrës shqiptare në nivel politik vendor mund të thuhet se

Kush çka bën në parti?	PPD		PDSH		ADSHM	
	M	F	M	F	M	F
E shkruan programin e partisë	X		X		X	
Formulon premtimet zgjedhore part.	X		X		X	
Udhëheq partinë	X		X		X	
Përfaqëson partinë në publik e media?	X		X		X	
Përfaqëson partinë jashtë vendit?	X		X		X	
Trajnohet nga radhët e partisë?	X		X		X	
Ngre të holla për partinë?	X		X		X	
Vendos për ndarje fonde në parti?	X		X		X	
Vendos rreth promovimit të aktivistëve të p. në drejtues?	X		X		X	
Mban barrën kryesore të punës vullnetare ndërmjet zgjedhjeve?	Të dy		X		Të dy	
Mban barrën e punës vullnetare gjatë fushatave zgjedhore?	Të dy		X		Të dy	
Kontrollon drejtësinë në emër të partisë?	Të dy		X		Të dy	
Vendos për përbërjen dhe pozicionin e kandidatëve, në listat e partisë në kohën e zgjedhjeve?	X		X		X	
Vendos rreth nominimit të kryeministrit ministrave, sekretarëve shtetërorë, prefektëve,drejtorëve etj	X		X		X	
I qëndron besnik kur ajo humbet		X		X	Të dy	
Gjithsej:	11	1	14	1	10	4

Burimi: Po aty (përpunuar nga autorja)

është simbolike. Gjithashtu, vendi i saj në partitë politike shqiptare, sidomos në listat zgjedhore, është më se simbolik, ngase për të flasin rezultatet e arritura deri tani. Se sa e përkrahur ishte femra shqiptare në zgjedhjet vendore të vitit 2005, flasin të dhënat e poshtëshënuara:

Në këtë etapë të zhvillimit të standardeve për barazi gjinore në kornizat e

Nismat partiake drejtuar Qeverisë për përmirësimin e barazisë gjinore:

Partia politike	PO	JO	Propozimi
LSDM	X		Ligji për barazi gjinore
PLD	X		Lobim aktiv për nenin për kuotën 30 përqind për zgjedhje vendore
PPD		X	
VMRO-DPMNE	X		Përkrahje e nenit për kuotën 30 përqind në Ligjin për zgjedhje vendore
PLM	X		
PDSH		X	Përkrahje e nenit për kuotën 30 përqind në Ligjin për zgjedhje vendore
PSM	X		
PBERM		X	
AD		X	
BDI		X	Përkrahje e nenit për kuotën 30 përqind në Ligjin për zgjedhje vendore

Burimi: Vënia e konceptit gjinor në partitë politike në nivel vendor, LOGM, 2005

partive politike, kërkesa e LOGM-së për vendosjen e kuotës prej minimum 30 përqind të burrave dhe grave në ligjin për zgjedhje vendore është pranuar nga të gjithë partitë si diçka që nënkuptohet.

Në zgjedhjet vendore 2005 u zgjodh vetëm 1 femër prefekte shqiptare, në Komunën e Oslomejit, nga partia e BDI.

Premtimet partiake për zgjedhjet vendore më 2005

- BDI - Numër më i madh i grave të afta në pozita, të cilat do të ngrejnë statusin e grave në politikë.
- PPD - Zmadhimi i forcës politike të grave në nivel vendor.
- Politikë aktive për punësimin dhe përkrahje të grave afariste.
 - Përkrahje për vendosjen e komisionit komunal për barazi gjinore.
 - Zmadhimi i forcës politike të grave në nivel vendor.
- PDSH - Politikë aktive për punësim dhe përkrahje të grave afariste.
- Programi financiarisht i përkrahur nga komunat për përmirësimin e shëndetit riprodhues të grave dhe planifikim i familjes.
 - Vendosja e SOS linjave kundër dhunës në familje, sidomos ndaj grave.
 - Përmirësimi i kujdesit ndaj fëmijëve.

Numri i kandidateve shqiptare për prefekte, v.2005

Partia	Komuna	Numri i kandidateve
BDI	Osllomej, Zelenikovë	2
PDSH	Butel	1
Gjithsejt		3

Burimi: Po aty (përpuar nga autorja)

Vendi i kandidateve shqiptare femra në listat vendore zgjedhore, 2005

Partia	Vendi I	Vendi II	Vendi III
BDI	1	1	8
PDSH	3	9	7
PPD	panjohur	panjohur	panjohur
Gjithsejt	4	10	15

Burimi po aty (përpunuar nga autorja)

Partia Përqindja e grave candidate shqiptare në pjesën e parë të listës

BDI	30.47
PDSH;PPD	29.05
Gjithsej	59.52

Burimi:Po aty(përpunuar nga autorja)

Partia	Numri	Përqindja e F shqiptare këshilltare v.2005
BDI	47	15.06
PDSH/PPD	23	7.37
Gjithsej	70	22.43

Burimi:Po aty (përpunuar nga autorja)

Sfida e pushtetit gjyqësor nën fokusin e rindarjes territoriale të gjykatave

Julian HAXHIU

Sistemi gjyqësor në Republikën e Shqipërisë ka pasur organizim të ndryshëm në periudha të ndryshme kohore. Me përfundimin e Luftës II Botërore, u miratua ligji nr.59, datë 17.5.1945 “Mbi organizimin e përkohshëm gjyqësor”, me të cilin u krijuan gjykatat popullore, në krye të të cilave qëndronte Gjykata e Lartë. Gjykatat popullore u krijuan në çdo qendër nënprefekturë dhe gjykonin me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar profesionist dhe dy gjyqtarë popullore, ndërkohe që “*rekurset apelore*” shqyrtoheshin nga gjykatat e prefekturave, të cilat gjykonin të përbërë nga dy gjyqtarë profesionistë dhe një gjyqtar popullor. Gjykata e Lartë përbëhej nga 8 - 10 gjyqtarë profesionistë.

Ligji nr. 1284, datë 9.6.1951 solli ndryshime të konsiderueshme nëpërmjet përfshirjes së juridiksionit të posaçëm ushtarak në sistemin e përgjithshëm. Gjithashtu, me këtë ligj u rikrijuan gjykatat e qarqeve, të cilat lejoheshin jo vetëm të tërhiqnin e gjykonin çështjet në kompetencë të gjykatave popullore, por edhe të caktonin një ose dy gjyqtarë nga radhët e tyre për të gjykuar si gjyqtarë rrethi.

Sistemi gjyqësor shqiptar pësoi përsëri ndryshime të rëndësishme me ligjin nr. 4406, datë 24.6.1968, i cili u ndryshua më vonë me dekretin nr. 5533, datë 25.2.1977. Sipas këtij modeli, drejtësia jepej nga gjykatat popullore. Këto ishin Gjykata e Lartë, gjykatat e rretheve, gjykatat e fshatrave dhe gjykatat e lagjeve të qyteteve. Gjykatat e fshatrave, të qyteteve dhe të lagjeve

të qyteteve gjykonin me trupa gjykues të përbërë nga një ndihmësgjyqtar i gjykatës së rrethit dhe dy aktivistë shoqërorë.

Me dekretin nr.7174, datë 20.11.1987 “Për organizimin gjyqësor në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë”, sistemi i drejtësisë u organizua në gjykata të rretheve, të cilat gjykonin në shkallë të parë të gjitha çështjet gjyqësore, këshilla gjyqësore zonale, të cilët gjykonin çështjet në shkallë të dytë, dhe Gjykatën e Lartë.

Në vitet 1992-1998 ndryshimet social-ekonomike në vendin tonë sollën edhe ndryshime në sistemin gjyqësor. Me dekretin nr. 243, datë 7.7.1992 të Presidentit të Republikës, sistemi i drejtësisë përbëhej nga 36 gjykata të rretheve, një gjykatë apeli, e cila shqyrtonte ankimet dhe protestat kundër vendimeve penale dhe civile të gjykatave të rretheve dhe Gjykata e Kasacionit, e cila gjykonte në shkallë të dytë vetëm ankesat për vendimet penale që kanë caktuar dënim me vdekje, si dhe bazueshmërinë në ligj të vendimeve gjyqësore, të cilat i paraqiteshin nga palët, nëpërmjet ankimeve, ose nga kryetari i Gjykatës së Kasacionit dhe Prokurori i Përgjithshëm, nëpërmjet kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Organizimi aktual i sistemit gjyqësor bazohet në dekretin nr. 2110, datë 29.5.1998 “Për krijimin e rretheve gjyqësore, caktimin e kompetencave tokësore dhe të qendrës së ushtrimit të veprimtarisë së tyre” të Presidentit të Republikës, me të cilin u suprimuan gjykatat e rretheve Delvinë, Devoll, Has, Kuçovë, Malësi e Madhe, Mallakastër e Peqin, duke pasur tashmë 29 gjykata të shkallës së parë, që funksionojnë edhe sot. Ndërkohë, një organizim i ri ishte bërë edhe për gjykatat e apelit. Me dekretin nr. 1984, datë 7. 1.1998 të Presidentit të Republikës, u krijuan 7 gjykata apeli: në Tiranë, Durrës, Shkodër, Korçë, Vlorë, Gjirokastër dhe Gjykata e Apelit Ushtarak Tiranë.

Siç vihet re, ndarja e vendit në 29 rrethe gjyqësore, në secilin prej të cilëve ushtron juridiksionin e saj një gjykatë rrethi, ka disa vite që është kryer. Përveç nevojës për ndryshim që vjen vetvetiu nga përparimi i vendit në fusha të tjera, janë edhe një sërë faktorësh të tjerë që diktojnë ndërmarrjen

e hapave për një ndarje të re territoriale të rretheve gjyqësore dhe, në përgjithësi, një riorganizim të sistemit gjyqësor:

- Numri prej 29 i rretheve gjyqësore është relativisht i madh për hapërsirën territoriale dhe numrin e popullsisë së vendit tonë.

- Nëse do të analizohen, qoftë edhe në mënyrë sipërfaqësore, statistikat zyrtare të sistemit gjyqësor, do të vihet re një shpërpjesëtim i madh i ngarkesës së punës në gjykata të ndryshme. Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës, e cila është e përbërë nga 50 gjyqtarë (ose nga 1/5 e gjyqtarëve të vendit) ka gjykuar, për vitin 2003, 33 për qind të të gjitha çështjeve gjyqësore në shkallë vendi, kurse, për vitin 2004, rreth 38 për qind, ndërkohë që numërohen rreth 9 gjykata që, për vitin 2004, kanë shqyrtuar më pak se 1 për qind secila të çështjeve gjyqësore në shkallë vendi¹. Shifra të tilla, si edhe përqindja e rritjes së ngarkesës të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës nga viti në vit flasin qartë për prirjet e zhvillimit të sistemit gjyqësor. Nga ana tjetër, vihet re një shpërpjesëtim i madh edhe në ngarkesën e punës për gjyqtar, duke sjellë që ngarkesa e çështjeve për disa gjyqtarë të jetë shumë e lartë, ndërsa për disa të tjerë kjo ngarkesë të jetë shumë e vogël. Madje, shpërpjesëtimi bëhet më i dukshëm sepse ngarkesa më e madhe për gjyqtar nuk vihet re në gjykatat me volum më të madh pune. Për shembull, për vitin 2003, gjykata me ngarkesë më të madhe pune për gjyqtar rezulton të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Kurbit dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës renditet gjykata e tretë me ngarkesë më të madhe. Për vitin 2004, gjykata me ngarkesën më të madhe për gjyqtar është ajo e Pogradecit dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës renditet e katërta². Në lidhje me voulimin e punës për secilin gjyqtar duhet të nënvizohet edhe fakti se ndeshen gjykata që kanë ngarkesë sa dyfishi i mesatares kombëtare të volumit për gjyqtar, që është 126 çështje

¹ Vjetari Statistikor 2003 dhe Vjetari Statistikor 2004, Ministria e Drejtësisë

² Vjetari Statistikor 2003 dhe Vjetari Statistikor 2004, Ministria e Drejtësisë

në vit, ashtu edhe gjykata që kanë ngarkesë sa gjysma e kësaj mesatareje.

· Lëvizja demografike e popullsisë. Siç vërehet tashmë nga të gjithë, popullsia jonë tashmë po kalon një migracion të gjerë, duke lëvizur nga qytete ose zona të vogla e të thella në drejtim të qyteteve të mëdha, veçanërisht Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër, Fier, Elbasan etj. Duke qenë në këto kushte, në disa gjykata vihet re një shtim i dukshëm i numrit të çështjeve gjyqësore, ndërsa në të tjera gjykata vihet re efekti i kundërt, pra ai i zvogëlimit të numrit të çështjeve gjyqësore. Nga viti 2003 në vitin 2004 vihet re një pakësim i dukshëm i numrit të çështjeve civile në pjesën më të madhe të gjykatave dhe një shtim i ndjeshëm në Tiranë, kurse në gjykata të tjera, si Kavaja, Korça, Pogradeci etj. rritja e numrit të çështjeve gjyqësore është më pak e dukshme³.

· Edhe gjykatat e apelit e manifestojnë këtë deformim të ngarkesës së punës. Për vitin 2003, Gjykata e Apelit e Tiranës ka gjykuar 35 për qind të apeleve civile dhe 34 për qind të apeleve penale në shkallë vendi, kurse për vitin 2004 ajo ka gjykuar 39 për qind të apeleve civile dhe 36 për qind të apeleve penale⁴, duke manifestuar një rritje të ndjeshme dhe dallim të madh me gjykatat e tjera të apeleve.

· Në kushtet politike të vendit tonë, kur detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Europian sa vijnë e bëhen më të prekshme, nevojitet që edhe sistemi gjyqësor të ndryshojë drejt një modeli të ri, që do ta bëjë atë më eficient, më të besueshëm e më transparent në sytë e publikut. Në këtë kuptim, edhe organizimi territorial i gjykatave ka rëndësinë e vet, krahas ndryshimeve legjislative që mund të bëhen në lidhje me karrierën gjyqësore, emërimin dhe procedimin disiplinor të gjyqtarëve etj., veçanërisht nëse konsiderohet nevoja jo e largët për specializimin e gjyqtarëve dhe/ose gjykatave në çështje që marrin rëndësi të veçantë nëse shihen nga këndvështrimi i *acquis communautaire*, siç janë ato tregtare ose

³ Vjetari Statistikor 2003 dhe Vjetari Statistikor 2004, Ministria e Drejtësisë

⁴ Vjetari Statistikor 2003 dhe Vjetari Statistikor 2004, Ministria e Drejtësisë

administrative. Megjithatë, edhe në këtë drejtim, riorganizimi i gjykatave duhet të jetë rezultat i një pune të detajuar e të kujdesshme, e cila të vlerësojë drejt prirjet e zhvillimit dhe nevojat e shoqërisë në përgjithësi. Nëse do t'u referohemi përsëri statistikave gjyqësore, për vitin 2004 vetëm 38 për qind e çështjeve civile kanë qenë me palë kundërshtare dhe, nga këto, vetëm 14 për qind kanë qenë çështje administrative dhe më pak se 1 për qind tregtare, kurse 40 për qind e çështjeve pa palë kundërshtare kanë qenë tregtare.

Këta janë disa nga faktorët, për shkak të të cilëve mendojmë se riorganizimi i gjykatave është i domosdoshëm në kushtet tona. Kjo nuk do të thotë që mbi këto nevoja të mos ketë mendime të kundërta ose që në funksion të riorganizimit gjyqësor të ketë edhe faktorë të tjerë të papërmendur më lart, të cilët bëjnë që ky riorganizim të ndërmerret sa më shpejt.

Megjithatë, riorganizimi i gjykatave është një proces që jo vetëm duhet të justifikohet nga arsye të forta, por duhet edhe të realizohet në mënyrën e duhur, me qëllim që të përmbushen pikërisht synimet përkatëse. Në këtë kuptim, kriteret mbi të cilat duhet të realizohet një reformë e tillë duhet të bëhen objekt diskutimi i gjerë në rrethet e juristëve dhe të grupeve të interesit, duke u marrë veçanërisht për bazë mendimi i Konferencës Kombëtare Gjyqësore, i Shoqatës Kombëtare të Prokurorëve, i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, i organizmave ndërkombëtare dhe OJF-ve që janë treguar mjaft aktive në fushën e drejtësisë.

Kriteret për të realizuar një riorganizim të gjykatave mund të jenë të shumta, por ne do të ndalemi në vetëm disa prej tyre, duke qenë të ndërgjegjshëm se modelet janë të shumta dhe debati mund të jetë i gjerë e frytdhënës.

Një nga kriteret për këtë reformë në ndarjen e gjykatave në territorin e vendit tonë është caktimi i një numri mesatar çështjesh për një gjyqtar, të cilit t'i përafrohet numri i çështjeve që mendohet se do të gjykojë çdo gjyqtar pas riorganizimit. Ky kriter ka qenë baza mbi të cilën është mbështetur studimi i Ministrisë së Drejtësisë për riorganizimin e gjykatave të rretheve gjyqësore.

Gjithsesi, ky kriter nuk mund të jetë as i vetmi dhe as mbizotërues, sepse riorganizimi i gjykatave nuk mund të ketë në themel të tij vetëm një përlogaritje mekanike numrash, sado realiste të jetë ajo.

Kriter tjetër për këtë reformë mund të jetë edhe formimi i disa gjykatave të mëdha, duke i ndarë ato në disa seksione. Këto seksione do të ndikojnë pozitivisht në specializimin e gjyqtarëve në fusha të ndryshme të së drejtës. Është e vështirë të pretendohet për cilësi të lartë në gjykim e për gjyqtarë shumë të formuar profesionalisht, përse kohë gjyqtarët do të vazhdojnë të gjykojnë në të njëjtën kohë në të drejtën penale, administrative, civile, tregtare. Pra, riorganizimi i gjykatave mund të shihet nën vështrimin për formimin e seksioneve përkatëse në të gjitha gjykata ose krijimin e gjykatave për fusha të posaçme të së drejtës.

Tjetër kriter për rindarjen e gjykatave duhet të jetë nevoja për përcaktimin e saktë të kompetencës tokësore të gjykatave. Madje, mund të përmendim këtu përvojën e disa vendeve të ndryshme të Europës, p.sh: Norvegjia, ku ekzistojnë gjykatat e qyteteve, si dhe gjykatat e zonave rurale. Kjo mënyrë organizimi do të ndihmonte në kushtet aktuale të Shqipërisë, për shkak se ka raste kur një gjykatë, megjithëse gjykon një numër shumë të vogël çështjesh dhe nuk justifikon ekzistencën e saj, përsëri është e nevojshme të mos bashkohet me gjykata të tjera, për shkak të largësisë së qendrave të banimit nga njëra-tjetra. Pra, duke pasur vetëm gjykata të rretheve gjyqësore, është e nevojshme që disa gjykata të vazhdojnë të ekzistojnë, megjithëse ekzistenca e tyre nuk është e domosdoshme, duke pasur parasysh numrin modest të çështjeve gjyqësore. Do të ishte një mënyrë racionale të krijoheshin gjykata rurale ose zyra gjyqësore për zona të caktuara, madje mund të diskutohet edhe rikthimi i *institucionit të gjyqtarit të paqit*. Nuk mund të mbahen më këmbë disa gjykata ekzistuese vetëm me justifikimin e largësisë së qendrave qytetare të banimit, por duhen mundësuar forma të tjera të frytshme të ushtrimit të pushtetit gjyqësor në këto zona.

Një nga kriteret mbi të cilat duhet të bazohet reforma gjyqësore e

sipërpërmendur është edhe lëvizja migratore e popullsisë shqiptare drejt zonave urbane. Në vendin tonë ka përreth 15 vjet që popullsia lëviz vullshëm nga zonat e thella ose qytetet e vogla drejt qyteteve të mëdha. Por pavarësisht kësaj lëvizjeje, ndarja e gjykatave vazhdon të mbetet ashtu siç ajo është bërë në fillim të viteve '90. Kësisoj, në disa zona të caktuara, pavarësisht se popullsia është zvogëluar dukshëm, institucionet e gjykatave vazhdojnë të ekzistojnë me po atë numër gjyqtarësh që kanë pasur në krijimin e tyre. Për këto arsye, në reformën përkatëse gjyqësore duhet të merren parasysh lëvizjet migratore të popullsisë dhe kahjet e tyre për të bërë të mundur shtimin dhe përmirësimin e shërbimeve gjyqësore në këto qytete dhe, anasjelltas, zvogëlimin e këtyre shërbimeve në zonat ose qytetet e vogla.

Këto janë disa nga kriteret ku mund të mbështetet reforma e ndarjes së gjykatave në Shqipëri. Ato ndoshta nuk janë as të vetmet, por as të gjitha të domosdoshme për këtë reformë të rëndësishme. Duhet të kemi parasysh faktin se të tilla reforma nuk mund të kryhen në periudha të shpeshta kohore. Ato janë reforma që duhet të shtrihen për një kohë shumë të gjatë. Duke qenë të një natyre të tillë, këto reforma duhet t'i nënshtrohen një analize shumë të hollësishme, të detajuar dhe të plotë. E para, sepse për vetë konceptin e reformës, ajo duhet të parashikojë gjendje të caktuara sociale në mënyrë që t'i përshtatet një kohë sa më të gjatë pas daljes së saj. Së dyti, duke qenë pjesë e reformës gjyqësore në Shqipëri, një reformë përafuese me shoqërinë europiane, ajo ka nevojë për një këshillim të gjerë mendimesh, për një ekspertizë të thellë specialistësh dhe grupesh interesi. Këto mendime janë të domosdoshme për të pasur një ndarje sa më racionale dhe të frytshme, duke iu përshtatur karakteristikave të vendit tonë, larg një reforme standarde, ku mund të vihen herë pas here ngjyra populiste. Në kuadrin e një reforme të tillë të rëndësishme, këto mendime janë më se modeste, duke qenë i bindur se në formacionin tonë juridiko-profesional gjenden specialistë të denjë për t'i dhënë kësaj reforme formën dhe elementet e duhura që do t'i përshtateshin në mënyrë racionale si përvojës shqiptare, ashtu edhe praktikës së sotme europiane.

E drejta familjare dhe mbiemri pasmartesor

Genta BUNGO, MA.

A. Pas shumë vajtje-ardhjesh të mblesërve, më në fund caktohet edhe data e martesës ligjore. Gjithçka kalon nëpër etapat e një martese tradicionale. Madje, me pak mund, lind edhe pak dashuri ndërmjet tyre. Dhe në garën për ta treguar këtë dashuri, si edhe për hir të zakonit, ajo ka një shans më shumë: mund të marrë mbiemrin e tij.

B. Ai është një njeri i zakonshëm, nga një familje e zakonshme, me një zanat të zakonshëm; ajo rrjedh nga një familje me emër, nga një “derë e madhe”, siç i pëlqen ta quajë. Nga martesa pret një jetë të qetë, pa probleme ekonomike dhe, sigurisht, shumë fëmijë që duhet patjetër të trashëgojnë gjithçka nga ajo, madje edhe mbiemrin e saj, pse jo?

C. Më në fund ata vendosën të thonë “po” përpara ligjit. Ajo është një grua në karrierë, profesioniste e zonja, një grua, që me shumë mund ka krijuar një emër të saj in dhe papritur punonjësja e gjendjes civile e pyet: “Do të mbani mbiemrin e burrit apo mbiemrin tuaj?”

Nuk ka asgjë që të bëjë me kinemanë ose me ndonjë fabul romani. Janë thjesht ngjarje të përditshme të një jetsee reale, në të cilën dikush duhet të bëjë një zgjedhje, një ndryshim.

Kur një grua martohet, ndër të tjera, duhet të vendosë edhe për mbiemrin e saj pas martesës. Ligjërisht ajo nuk ka ndonjë detyrim për të ndryshuar mbiemrin pas martesës¹.

¹ Ligji nr.9062, datë 8.5.2003 “Kodi i Familjes”

Sipas Kodit të Familjes (neni 51), të dy bashkëshortët kanë këto mundësi:

- a) gruaja të marrë mbiemrin e burrit
- b) burri të marrë mbiemrin e gruas
- c) secili të mbajë mbiemrin e tij

Që gruaja të ndryshojë mbiemrin e saj të vajzërisë dhe pas martesë të marrë mbiemrin e burrit është thjesht një çështje tradite, por gjithsesi ky është varianti më i pëlqyer (Situata A).

Kur të dy bashkëshortët përdorin të njëjtin mbiemër është më pak e komplikuar për të tjerët, kur kryhen veprime financiare, ligjore ose edhe shoqërore. Dhe kjo lehtësi duket edhe më shumë me ardhjen e fëmijëve në jetë.

Në një shoqëri, ku linja patriarkale është ende mbizotëruese, pavarësisht nga tentativat për civilizim të gruas, me të drejta të barabarta me burrin, tradita është e vështirë të shkelet.

Një grua, që pas martesës ndërron mbiemrin e saj dhe merr atë të bashkëshortit, më e pakta që bën është reklamimi i dashurisë së saj për të. Dhe normalisht që burri është mjaft i kënaqur.

Por si përjetohet ky ndryshim në personalitetin e gruas?

Kur gruaja ka një karrierë të sajën, një veprimtari ekonomike të pavarur, kur ajo është një figurë e njohur në politikë, art, shkencë, pedagogji, a është i lehtë ky ndryshim? Lëkundja për të marrë një vendim të tillë është e kuptueshme. Asaj do t'i duhet të riidentifikohet me mbiemrin e ri dhe kjo mund t'i kushtojë shumë në karrierën e saj. Imagjinoni për një çast një deputete, që në mes të ushtrimit të mandatit të saj, si pasojë e martesës ligjore, do të ndërrojë mbiemrin. Sa do t'i kushtojë asaj të fitojë edhe një herë besueshmërinë në radhët e zgjedhësve, apo mos ndoshta duhet të dërgojë informacion në të gjitha shtëpitë e zonës së saj zgjedhore që deputetja e tyre nuk ka ndryshuar, ka ndryshuar vetëm mbiemri i saj, sepse meqënëse është martuar dhe, për hir të traditës, ka marrë mbiemrin e burrit ?!

Ligjërisht zgjidhja ekziston².

Neni 51 i Kodit të Familjes i jep mundësi gruas që të mbajë mbiemrin e saj (Situata C). Por edhe ky version nuk është se e lehtëson shumë jetën e gruas. Ndërkohë që nuk krijohen probleme në jetën e saj profesionale është e vështirë të pranosh idenë që fëmijët e tu kanë mbiemër të ndryshëm nga ai i joti. Në aeroport, për shembull, përveç pasaportës, gruaja duhet të ketë, gjithashtu, edhe një dokument tjetër që të vërtetojë amësinë e saj, kur udhëton së bashku me fëmijët. Në rast se përdor makinën e bashkëshortit, gruaja, gjithashtu, duhet të jetë në gjendje të vërtetojë me ndonjë dokument se është ligjërisht e martuar me pronarin e makinës. Dhe sa e sa pengesa të po kësaj natyre, në rast se ushtrojnë bashkarisht ndonjë biznes familjar.

E të gjitha këto pengesa vetëm e vetëm sepse gruaja ka “guxuar” të mbajë mbiemrin e saj pas martesës.

Ajo që bën përshtypje në shoqërinë tonë është se askush nuk e çon ndërmend se mund të jetë burri ai që të ndryshojë mbiemrin dhe të marrë atë të gruas (Situata B). Është thjesht maskilizëm shoqëror? Është thjesht traditë?

A mund të thuash se ky “civilizim” është “pronë” vetëm e shoqërisë shqiptare?

Në vitin 1994, përpara Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, paraqitet çështja “Burghartz kundër Zvicrës”³.

Burghartz-i dhe gruaja e tij ishin me kombësi zvicerane dhe ishin martuar në Gjermani. Gruaja e tij kishte, gjithashtu, shtetësi gjermane dhe ata, në përputhje me ligjin gjerman, kishin zgjedhur si mbiemër për familjen e tyre, mbiemrin e gruas. Ata vendosën, gjithashtu edhe mbiemrin e burrit përpara mbiemrit të familjes, në përputhje me të drejtën e tyre ligjore për këtë. Por, pasi zyra e gjendjes civile në Zvicër regjistroi mbiemrin e tij si mbiemër të

² Po aty, neni 51

³ Marek Antoni Nowicki, Rreth Konventës Evropiane, botim i QSHDNJ, Tiranë 2003, fq.390

përbashkët, çifti aplikoi për të zëvendësuar këtë me mbiemrin që kishin zgjedhur në Gjermani. Ky aplikim s' u pranua, ashtu si edhe një i dytë i bërë pas ndryshimeve të Kodit Civil që lejonin gruan të vendoste mbiemrin e saj përpara mbiemrit të familjes (që do të vazhdonte të ishte mbiemri i burrit).

Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut vendosi të konsiderojë si diskriminim mospranimin që i është bërë bashkëshortit për të vendosur mbiemrin e tij para mbiemrit të gruas, të cilin e kishin zgjedhur si mbiemër të familjes. Kjo gjykatë shprehet se “synimi drejt barazisë gjinore përbën sot një qëllim të rëndësishëm të shteteve anëtare të Këshillit të Europës. Nga kjo del se duhet të ekzistojnë shkaqe mjaft të rëndësishme, që trajtimi i diferencuar për shkak të seksit të quhet në pajtim të plotë me Konventën”.

Duke gjykuar nga statistikat, numri i divorceve është rritur shumë. Si ndikon divorci te ndryshimi i mbiemrit të gruas në rastin kur ajo ka marrë atë të bashkëshortit?

Neni 146 i Kodit të Familjes e ka zgjidhur, duke i rikthyer gruas mbiemrin që ka patur para martesës. Por, gjithashtu, po kjo dispozitë krijon mundësinë që në raste të veçanta, me kërkesë të bashkëshortit ose kur është në interes të fëmijëve, bashkëshorti që ka ndërruar mbiemrin pas martesës (që zakonisht është gruaja) të vazhdojë ta mbajë atë edhe pas divorcit.

Në të vërtetë nuk ka ndonjë përcaktim të qartë se kur mund të jetë në interes të fëmijëve mbajtja e mbiemrit pas divorcit dhe, për më tepër, nuk ka ndonjë afat minimal ose maksimal të parashikuar për kohëzgjatjen e këtij përdorimi.

Kur gruaja, pas divorcit, vazhdon të mbajë përsëri mbiemrin e ish-bashkëshortit, është e kuptueshme se shoqërisht do të vazhdojë të njihej si e martuar. Në rastin e një martese të dytë, procedurat do të duhej të fillonin që nga ndryshimi i mbiemrit të ish-bashkëshortit dhe pastaj me lidhjen e martesës së re.

Në rastin kur gruaja, pas divorcit, i rikthehet mbiemrit të saj të vajzërisë, siç ndodh rëndom, asaj do t'i duhet të bëjë një riidentifikim të saj in në shoqëri

dhe profesion. Por përsëri, kur lidh një martesë të dytë dhe përsëri vendos të marrë mbiemrin e bashkëshortit të dytë, historia do të përsëritet nga e para.

Qëllimi i ligjit nuk është komplikimi, por lehtësimi i jetës së bashkësisë, dhe aq më tepër kur bëhet fjalë për një pjesë të konsiderueshme të saj, siç është gjinia femërore.

Faktikisht këto nuk janë probleme vetëm të shoqërisë shqiptare, bota i ka ndeshur shumë më parë se ne dhe madje u ka dhënë edhe zgjidhje praktike e ligjore për të gjithë.

Ekziston konfuzion mbi të drejtat ligjore të një gruaje të martuar ligjërisht, por që mban mbiemrin e saj të vajzërisë. Praktika, që një grua e martuar të ndryshojë mbiemrin e saj dhe të marrë atë të bashkëshortit është thjesht një zakon dhe jo një detyrim ligjor, pothuajse në të gjitha shtetet e Amerikës. Ky zakon nuk ka ndonjë përhapje mbarëbotërore dhe nuk ka të bëjë me fillimet e civilizimit të shoqërisë. Shumë studiues besojnë se një zakon i tillë i ka fillimet e tij që në periudhën e feudalizmit, në Europën Perëndimore dhe në Amerikën Veriore. Gjatë periudhës së Mesjetës, një familje fisnikësh e identifikonte të parin e saj duke i shtuar emrit të tij edhe emrin e çifligut të tij, pasurisë së tij. Ky emër, me kalimin e kohës, përdorej edhe nga fëmijët e tij dhe konsiderohej i trashëgueshëm. Praktika e mbiemrave u zhvillua, sepse borgjezia bëri siç bëri fisnikëria dhe njerëzit e varfër imituan edhe fisnikërinë edhe borgjezinë. Ky ndryshim, që njerëzit të kishin mbiemra dhe gratë ta ndryshonin atë kur martoheshin nuk ishte i plotë në Angli edhe deri në shekullin XVI, madje në vende të caktuara në Uells, Skoci dhe Irlandë as në shekullin XVIII.

Ndryshe nga vendet e Europës Perëndimore, në vendet e Amerikës Veriore, zakoni që bashkëshortja të merrte mbiemrin e bashkëshortit dhe të gjithë pasardhësit të merrnin po këtë mbiemër, përfshinte edhe praktikën e disa familjeve të pasura britanike, që kombinonin mbiemrin e gruas me atë të burrit, duke i ndarë me një vizë, si një formë të re mbiemri për familjen e krijuar.

Një praktikë e ngjashme ekziston edhe në vendet spanjishtfolëse, ku një person mban mbiemrat e të dy prindërve. Ka edhe bashkësi me kulturë të Amerikës Qendrore, në të cilat emri i babait bëhet mbiemri i fëmijës.

Në Islandë, një variacion i emrit të babait kombinohet me emrin e fëmijës, madje edhe pas martesës, gruaja mban si mbiemër një variacion të emrit të babait të saj. Kështu që, në një familje, të gjithë, burri, gruaja, fëmijët kanë mbiemra të ndryshëm.

Kur martohet një çift në Europën Lindore, për shembull në Çeki, nuk është e pazakontë që secili të mbajë mbiemrin e tij ose që njëri të marrë mbiemrin e tjetrit.

Në Poloni, si në shumicën e vendeve të Europës, mbiemrat janë të trashëgueshëm dhe zakonisht në linjë patriarkale, domethënë kalojnë nga babai te fëmijët. Një grua e martuar, në përgjithësi, merr mbiemrin e bashkëshortit të saj.

Në Kinë, Kore, madje edhe në Japoni, gruaja mund ta ndryshojë mbiemrin e saj pas martesës ose jo.

Gruaja e parë amerikane, që ka mbajtur mbiemrin e saj pas martesës ligjore ishte Lucy Stone, martuar në vitin 1855. Pas kësaj kjo nuk ishte më një ngjarje e jashtëzakonshme.

Është një traditë e fortë që gruaja të përdorë mbiemrin e burrit të saj pas martesës, megjithëse ligjërisht ky është detyrim vetëm në disa shtete të SHBA-së.

Të gjithë fëmijët marrin mbiemrin e babait, kështu që nëna ka mbiemër të ndryshëm nga pasardhësit e saj. Megjithatë, ka vende që përdorin mbiemrin e vajzërisë së nënës si emër për njërin nga fëmijët. Kjo praktikë nënkupton që gruaja trashëgon mbiemrin nga babai i saj dhe e ndryshon atë duke marrë mbiemrin e bashkëshortit. Gjithsesi, kjo praktikë mund të kritikohet për disa arsye. Ndërrimi i mbiemrit mund të interpretohet si një vulë, që bashkëshorti i vë gruas së tij për të treguar pronësinë mbi të, tregon epërsinë e linjës mashkullore të shoqërisë, i heq gruas të drejtën për të trashëguar mbiemrin e familjes së saj prindërore.

Meqënëse ligji nuk i pengon gratë që të mbajnë mbiemrin e tyre pas martesës, ka shumë që nuk e ndryshojnë atë për disa arsye. Dëshira për të treguar barazinë me burrin është një nga motivet që mund të konsiderohet edhe si më kryesori, por ka, gjithashtu, edhe motive të tjera. Disa gra nuk e ndërrojnë mbiemrin edhe për shkak të procedurave të gjata për të bërë riidentifikimin e tyre në gjithë institucionet ose veprimtarinë e tyre. Disa të tjera, thjesht nuk e pëlqejnë mbiemrin e burrit.

Praktitikiisht, gratë që mbajnë mbiemrin e tyre, pas martesës, janë të pakta. Kjo iu shkakton atyre, gjithsesi, vështirësi në identifikimin e faktit se tashmë kanë ndryshuar statusin e gjendjes civile. Shumica e njerëzve, në çastin që vihen në dijeni të një lidhjeje martesore, bëjnë menjëherë identifikimin e gruas me mbiemrin e burrit si një fakt që nuk mund të jetë ndryshe.

Disa gra vendosin të mbajnë mbiemrin e vajzërisë edhe për shkaqe të tjera të veçanta. Për shembull, rasti i një akademikeje krijon probleme në karrierën e saj. Përparimi i saj në profesion është i lidhur ngushtë me emrin e saj. Një grua e tillë rrezikon shumë që të humbasë lidhjet me punën e saj profesionale të kryer para martesës. Për këtë arsye ato vazhdojnë të përdorin mbiemrin e vajzërisë në profesion dhe të mbajnë mbiemrin e burrit në jetën e tyre shoqërore.

Por praktika vërteton se kur bashkëshortët përdorin mbiemra të ndryshëm, kjo nuk ndikon pozitivisht në jetën e fëmijëve. Kjo mënyrë zgjidhjeje, gjithashtu, kritikohet edhe për faktin se nuk demonstroi vullnet pozitiv në krijimin një familjeje të mirëfilltë, ku të gjithë kanë një mbiemër dhe krijon konfuzion te fëmijët në lidhje me statusin martesor të prindërve.

Ligjet që rregullojnë marrëdhëniet martesore janë të ndryshëm në vende të ndryshme. Në vende si SHBA-ja, Kanadaja, Anglia ndryshimi i emrit nuk kërkon ndonjë procedurë ligjore, sepse një person mund të zgjedhë vetë se me cilin emër dëshiron të njihet (përveç atyre me karakter fyes). Kjo është arsyeja që aktorët, autorët, thjeshtrit, si edhe gratë e martuara, mund të ndryshojnë emrin e tyre pa qenë të detyruar të ndërmarrin veprime ligjore.

Në shumë juridiksione, legjislacioni i të cilave derivon nga ligji civil, siç është Franca, Spanja, provinca kanadeze e Kebekut ose edhe shteti amerikan i Luizianës, e konsiderojnë si të metë përdorimin e të njëjtit emër ligjor të gruas gjatë gjithë jetës. Në këto vende kush dëshiron të ndryshojë emrin duhet të zbatojë një procedurë të rregullt ligjore.

Termi “mbiemër i vajzërisë” është kritikuar shumë nga lëvizja feministe në Amerikë që në vitet 1970. Kjo lëvizje e konsideron këtë si një term tradicional të papranueshëm, madje sulmues, sepse e lidh gjendjen e femrës me statusin seksual të saj. Vajzë është një sinonim për virgjërinë dhe “mbiemri i vajzërisë” duket si etiketë për një grua, që është pronë seksuale e një burri.

Në duelin midis traditës maskiliste dhe përpjekjeve për barazi tërësore midis gruas dhe burrit, duket sikur ligji ka gjetur një zgjidhje, duke i dhënë secilit mundësi zgjidhjeje. Por shumica e vendeve të botës e kanë zgjidhur në mënyrë akoma më praktike se Shqipëria.

Ashtu si burri, edhe gruaja ka dy prindër, një mbiemër, dhe nuk ka pse të jetë e detyruar, që për hir të një tradite, të jetë e detyruar të bëjë një zgjedhje. Kur zgjedh mbiemrin e burrit, duhet që të shuajë nga të gjitha rekordet e saj mbiemrin e mëparshëm, por në qoftë se do të vazhdojë të mbajë mbiemrin e saj, në pamje të parë, në paraqitje, do të krijonte përshtypjen e një beqareje dhe do të dukej sikur mohon martesën e saj, dhe, për më tepër, do të ndryshonte nga fëmijët e saj, që janë fryt i kësaj martese.

Një nga zgjidhjet, që sigurisht kërkon reflektim në ligj, është aplikimi i bashkimit të mbiemrave ose përdorimi i të dy mbiemrave të ndarë me vizë. Kështu, në qoftë se gruaja quhet A.B. dhe burri quhet C.D., pas martesës gruaja mund të quhet A.D-B. Në këtë mënyrë është e lehtë të identifikosh profesionalisht të njëjtin person dhe në të njëjtën kohë t’i japësh asaj të drejtën të njihet si bashkëshorte dhe nënë e fëmijëve.

Ligji nr.8950, datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile”, në nenin 36, pika 6, përcakton, në rastin e lindjes së fëmijëve: “Mbiemri është ai i prindërve. Kur secili nga prindërit ka mbiemër të veçantë, vendoset mbiemri i babait dhe,

kur e kërkon nëna, të dy mbiemrat”. Kjo do të thotë që, një fëmijë, ligjërisht, mund të mbajë dy mbiemra dhe kjo ndodh kur prindërit kanë mbajtur të dy mbiemrin e vet, pas martesës.

Ndërsa në nenin 52 të Kodit të Familjes thuhet: “Fëmija merr mbiemrin e përbashkët të prindërve. Kur prindërit kanë mbiemra të ndryshëm, të gjithë fëmijët mbajnë një mbiemër, atë që do të vendosin prindërit me marrëveshje. Kur marrëveshja nuk arrihet, fëmijët mbajnë mbiemrin e të atit.”

Fakti, që këto dy dispozita bien ndesh me njëra – tjetrën, është më se i qartë, por ajo që më bën përshtypje është fakti se mbi ç’praktikë botërore janë mbështetur hartuesit e ligjit kur kanë përcaktuar se në rast mosmarrëveshjeje fëmijët marrin mbiemrin e babait.

A është diskriminues ky qëndrim që mban ligji?

Është më se e zakonshme për gratë, veçanërisht në SHBA dhe Kanada, të marrin mbiemrin e bashkëshortit, por ta vendosin atë para ose pas mbiemrit të tyre të vajzërisë. Ndonjëherë, mbiemrin e bashkuar e marrin të dy, edhe gruaja edhe burri, se cili nga mbiemrat vendoset i pari është çështje vetjake. Në këto vende ndodh që vajzat ta përdorin mbiemrin e tyre të vajzërisë si emër mesazhi, çka në Shqipëri nuk njihet dhe nuk zbatohet, ndërsa si mbiemër mbajnë atë të bashkëshortit. Gjithsesi, kjo praktikë nuk përdoret në Mbretërinë e Bashkuar.

Çifte të tilla përballen me problemin e mbiemrit të fëmijëve dhe për këtë përdoren alternativa të ndryshme:

- shumica i japin fëmijëve mbiemrin e njërit prej prindërve, zakonisht babait;
- fëmijëve femra iu jepet mbiemri i nënës dhe fëmijëve meshkuj ai i babait;
- fëmijëve iu jepet mbiemri i bashkuar me vizë ndarëse, që përbëhet nga mbiemrat e babait dhe nënës.

Mënyra e fundit është kritikuar për shkak të vështirësive që krijon me brezin e ardhshëm, i cili duhet të kombinojë mbiemrat e katër gjyshërve në një mbiemër të vetëm.

Megjithëse në raste të rralla, por gjithsesi në shtim, disa çifte krijojnë një mbiemër të ri pas martesës për të dy së bashku. Ky mbiemër mund të jetë kombinim shkronjash nga të dy mbiemrat ose edhe një mbiemër krejtësisht i ri. Kjo mënyrë krijon mundësinë që fëmijët dhe prindërit të kenë të gjithë së bashku të njëjtin mbiemër dhe ky të jetë origjinal. Por edhe kjo praktikë kritikohet për faktin se krijon vështirësi në krijimin e pemës gjenealogjike të familjes.

Në vendet që flasin spanjisht, portugalisht ose edhe gjuhën katalanase, nëpër botë, njerëzit kanë të paktën dy mbiemra. Njëri trashëgohet nga nëna dhe tjetri nga babai. Prindërit, zakonisht, u kalojnë fëmijëve emrin që kanë trashëguar nga prindërit.

Në shumicën e vendeve spanjishtfolëse mbiemri i babait shkruhet përpara mbiemrit të nënës.

Në vendet që flasin portugalisht, mbiemri i babait, në shumicën e rasteve është pas mbiemrit të nënës. Në këto vende, zakonisht, fëmijët marrin dy mbiemra nga të dy prindërit, në përgjithësi mbiemrin e fundit të secilit prej gjyshërve.

Në Portugali një grua mund të marrë mbiemrin e bashkëshortit, por e mban edhe mbiemrin e saj të vajzërisë. Në kohët e vjetra kjo ishte e pazakontë. Megjithatë, në shekullin XX kjo praktikë është bërë pothuajse detyrim. Ditët e sotme pak gra marrin qoftë edhe vetëm zyrtarisht mbiemrin e burrit. Që nga viti 1977, në Portugali, burrat, gjithashtu, mund të marrin mbiemrin e gruas, por kjo është një gjë shumë e rrallë. Sot është mëse e zakonshme që gratë të marrin mbiemrin e bashkëshortit, por të mos e përdorin atë as në jetën e tyre profesionale e as në atë joformale.

Në Brazil, deri në reformën e fundit të ligjit civil, gratë duhet të merrnin mbiemrin e burrit, në rast të kundërt shikoheshin me syrin e konkubinativit. Por marrja e detyrueshme e mbiemrit të ri të bashkëshortit solli kombinacione të papëlqyeshme, sepse ndodhte që të kishte më shumë se një njeri me një emër. Ky zakon ndryshoi që në vitet '70 dhe sot haset rrallë për shkak të

vështirësive që krijon me ndryshimet që duhen bërë në regjistra e dokumentacione pas ndryshimit të mbiemrit, si edhe rikorrigjimin e tyre në rast divorci. Nuk është shumë e rrallë që, një grua e martuar të ketë dy emra dhe gjashtë mbiemra, dy të fundit prej të cilëve të jenë të bashkëshortit.

Në Poloni, një grua e martuar, zakonisht, mban mbiemrin e bashkëshortit. Gjithsesi, kombinacionet janë ligjërisht të mundshme. Gruaja mund të mbajë mbiemrin e saj të vajzërisë ose t'i shtojë atij edhe mbiemrin e bashkëshortit.

Ekziston, gjithashtu, edhe mundësia që bashkëshorti të marrë mbiemrin e gruas, ose t'ia shtojë atë mbiemrit të familjes së tij, por kjo, edhe në Poloni, është një gjë shumë e rrallë.

Në Kinë, gruaja mund ta bashkojë mbiemrin e bashkëshortit të saj me atë të vajzërisë ose ta zëvendësojë këtë të fundit me atë të burrit. Varianti i parë është më i përhapur në Hong Kong ose tek ata që jetojnë jashtë Kinës dhe zakonisht përdoren shkronjat e alfabetit kinez.

Ligjërisht, kinezët që jetojnë jashtë territorit të Kinës, ndjekin zakonet europian dhe përdorin mbiemrin e bashkëshortit kur shkruajnë emrin e tyre në anglisht. Duke përdorur mbiemrin e burrit ato tregojnë gjendjen e tyre martesore.

Bashkimi i mbiemrave (me vizë ndarëse ose jo), sipas modelit perëndimor, është shumë i përhapur në Taivan.

Në Mbretërinë e Bashkuar nuk ka ndonjë kërkesë ligjore që gruaja të ndryshojë mbiemrin pas martesës së saj. Pavarësisht nga tradita, zgjedhja është vetjake.

Pas martesës, për një grua, shtrohen këto alternativa që nuk kërkojnë një “Deed Poll” (është një dokument ligjor që vërteton ndryshimin e emrit dhe që njihet nga të gjithë organizmat qeveritarë, kompanitë dhe organizatat në të gjithë UK):

- të vazhdojë të mbajë mbiemrin e saj të vajzërisë;
- ta ndryshojë atë me mbiemrin e bashkëshortit.

Në qoftë se një grua vendos të mbajë mbiemrin e bashkëshortit, çertifikata

e martesës është dokument i mjaftueshëm për ta vërtetuar këtë fakt. Kjo çertifikatë mund t'u dërgohet të gjithë atyre që iu intereson, për të bërë ndryshimet përkatëse në dokumentacion.

Por sot vihet re se gratë tentojnë të mos i humbin lidhjet e tyre me emrin e familjes së tyre prindërore, duke e përfshirë këtë në mbiemrin e saj pasmartesor. Kështu që shumë çifte përdorin mbiemër të bashkuar, me vizë ndarëse ose jo. Në përgjithësi, mbiemri i bashkëshortit, si më zotërues, vendoset në fund. Por ka edhe çifte që renditjen e bëjnë duke pasur parasysh se si tingëllon më bukur.

Shumë gra janë të kënaqura të marrin mbiemrin e bashkëshortit, por shumë të tjera nuk mund të pajtohen me idenë se e braktisin tërësisht mbiemrin e vajzërisë ose të përdorin mbiemër të bashkuar. Një zgjidhje për këto të fundit është përdorimi i mbiemrit të vajzërisë si emër i mesit.

Siç mund të vihet re, në pothuajse të gjitha vendet e botës, është gjetur një zgjidhje për të mos e detyruar gruan të zgjedhë midis mbiemrit të saj dhe atij të bashkëshortit. Ndërkohë që në vendin tonë ky kufizim është i shprehur shumë qartë. Ka shumë gra në karrierë që e kanë gjetur zgjidhjen duke marrë ligjërisht mbiemrin e bashkëshortit dhe gjithë dokumentacioni pas martesës figuron me këtë mbiemër dhe, në profesionin e tyre parapëlqejnë që, përveç këtij, në kllapa, të vendosin mbiemrin e tyre të vajzërisë. Por është e kuptueshme që kjo është një zgjidhje informale dhe aspak ligjore.

A nuk është më e drejtë, që në një formë a në një tjetër, gruaja shqiptare të mos privohet nga e drejta e të njohurit me të dy mbiemrat e ligjshëm, me atë të bashkëshortit, që tregon gjendjen e saj martesore, por, së bashku me të edhe të vajzërisë, që tregon identitetin e saj, qoftë edhe familjar, në mos qoftë profesional?

Ajo që shpresoj të arrij nëpërmjet këtyre rreshtave është ndërgjegjësimi i ndokujt për të nxitur një nismë të tillë ligjore.

Emancipimi i gruas nuk do të thotë vetëm t'i japësh të drejtën të punojë njëlloj si burri (në të vërtetë punon më shumë, duke pasur parasysh edhe

punën e e papaguar në shtëpi), të ngrihet në detyrë dhe t’i besosh poste drejtuese. Jo, shumica e grave nuk i kanë këto “privilegje” dhe një nga gjërat që ndoshta do t’ju pëlqente të mos iu mohohet është e drejta për të gërrshetur identitetin e tyre vajzëror me atë bashkëshortor. Por ligji është kokëfortë, o njërin, o tjetrin, rrugë të mesme s’ka. E ndërkohë nuk na mbetet vetëm të shpresojmë në ndonjë “zgjim” të ndërgjegjes së legjislatoreve (femra).

Literatura:

1. Ligji nr.9062, datë 8.5.2003 “Kodi i Familjes”
2. Ligji nr. 8950, datë 10.10.2002 “ Për gjendjen civile”
3. Marek Antoni Nowicki, Rreth Konventës Europiane, botim i QSHDNJ, Tiranë 2003, fq.390
4. UK Deed Poll Service – A woman rights upon marriage in the UK (web site)
5. Wikipedia, the free encyclopedia (web site)
6. Legal issues of married women who keep their own names, Alice Marie Beard, 1974.

Të njohim Parlamentin italian

Aida SHLLAKU
Juriste

Sipas kushtetutës italiane, hyrë në fuqi më 1 janar të vitit 1948, parlamenti italian përbëhet nga dy organe: Dhoma e Deputetëve dhe Senati i Republikës. Parlamentarët zgjidhen çdo pesë vjet nga të gjithë qytetarët që kanë mbushur respektivisht, 18 vjeç për zgjedhjen e Dhomës së deputetëve dhe 25 vjeç për zgjedhjen e Senatit të Republikës. Duke filluar nga zgjedhjet e fundit 12 deputetë e 6 senatorë zgjidhen nga qytetarë italianë jashtë vendit.

Dispozitat kushtetuese italiane parashikojnë këtë sistem dydhomësh perfekt, që prej momentit që të dyja dhomat të zgjedhura prej një votimi të përgjithshëm e të drejtëpërdrejtë, duke patur të njëjtat funksione e të njëjtin pushtet, janë vendosur në Kushtetutë me një barazi perfekte por në të njëjtën kohë që edhe dallohen nga njëra tjetra. Dallimi ndërmjet dy dhomave qëndron në përbërjen (dhoma e deputetëve përbëhet nga 630 deputetë, ndërsa senati nga 315), elektoratin (moshë e ndryshme si për elektoratin pasiv ashtu edhe për atë aktiv), raportin përfaqësues (numri i zgjedhësve të një zone zgjedhore që i korrespondon një vendi në senat është më i lartë) dhe anëtarët (dhoma përbëhet vetëm nga deputetë të zgjedhur, ndërsa senati dhe nga senatorë të zgjedhur nga Presidenti i Republikës për merita të mëdha në fusha të ndryshme të jetës). Dispozitat kushtetuese parashikojnë gjithashtu fitimin e mandatit në detyrën e senatorit të ish Presidentëve të Republikës. Këta fitojnë titullin e senatorit të përjetshëm.

DEPUTETËT

Deputetët përfaqësojnë zgjedhësit: fjala “deputet” do të thotë “përfaqësues”. Sipas dispozitave kushtetuese italiane, çdo deputet, edhe pse i zgjedhur në një zonë të caktuar zgjedhore, dhe nga një parti politike e caktuar, përfaqëson të gjithë kombin dhe ushtron funksionet e tij pa detyrim mandati. Parlamenti është përfaqësues i orientimeve të ndryshme politike në vend. Funksionimi i plotë i tij ka si kusht paraprak domosdoshmërinë e ekzistencës së grupeve parlamentare. Këto të fundit pasqyrojnë drejtimit e shprehura nga zgjedhësit sipas grupimeve të ndryshme. Në secilën dhomë deputetët bashkohen në grupe parlamentare, kufiri minimal i të cilit si rregull është 20 deputetë në Dhomën e deputetëve dhe 10 në Senatin e Republikës.

Parlamenti italian është shprehje e sovranitetit të popullit dhe përfaqëson të gjithë kombin. Parlamentit i takojnë detyra kryesore në drejtimin politik të shtetit: drejtimi dhe kontrolli i qeverisë si dhe miratimi i ligjeve. Që të mund të qeverisë, qeveria italiane duhet të ketë besimin e parlamentit. Anëtarët e secilës dhomë votojnë për besimin e qeverisë në fillim të aktivitetit të saj.

KRYETARI

Përgjegjësia kryesore për një organizim të pavarur dhe një funksionim të mirë të parlamentit, i është besuar kryetarëve të secilës dhomë të cilët përfaqësojnë dhomën në kompleksitetin e saj. Kryetari i secilës dhomë kryeson dhomën si dhe organe parlamentare të cilat zhvillojnë detyra kryesore të organizimit të vetë dhomës: Konferencën e Kryetarëve të Grupeve Parlamentare, Byronë Parlamentare si dhe Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin.

PARLAMENTI NË SEANCË TË PËRBASHKËT

Dhoma dhe senati si një organ kolegjal zgjedhin çdo 7 vjet Presidentin e Republikës. Në zgjedhjen e këtij të fundit marrin pjesë edhe 3 delegatë për çdo rajon. Parlamenti si organ kolegjal, mblihet edhe për zgjedhjen e

organeve të tjera si Gjykata Kushtetuese, Këshilli i Lartë i Drejtësisë etj. Presidenti i Republikës mund të zgjedhë para kohe dhomat dhe të caktojë datën e zgjedhjeve të reja, nëse nuk përcaktohet dot një mazhorancë e aftë për të mbajtur në mënyrë të qëndrueshme qeverinë.

FUNKSIONI LEGJISLATIV

Funksioni legjislativ ushtrohet nga të dyja dhomat dhe konsiston në miratimin e akteve më të rëndësishme normative që rregullojnë jetën politike, ekonomike dhe sociale të vendit. Në aktivitetin legjislativ parlamenti operon në raport me qeverinë e cila propozon projektligjet dhe është gjithnjë e pranishme në të gjithë fazat e punimeve parlamentare. Iniciativa legjislative, i takon çdo parlamentari, qeverisë, 50.000 zgjedhësve si dhe këshillave rajonalë. Një pushtet iniciative me karakter sektorial (referuar vetëm për disa fusha) i atribuohet këshillit kombëtar të ekonomisë së punës për sektorin ekonomik dhe social, si dhe Bashkive në mënyrë shumë të kufizuar për sa i përket krijimit të krahinave të reja ose ndryshimit të ekzistueseve.

ORGANIZIMI

Rregullat kryesore që lidhen me organizimin, funksionimin dhe autonominë e dhomave përcaktohen drejtpërdrejtë nga kushtetuta italiane. Të gjitha dispozitat e tjera i rezervohen po nga dispozitat kushtetuese, rregullores parlamentare, që secila dhomë miraton me shumicën e të gjithë anëtarëve të saj.

SEANCA PLENARE

Seanca plenare është vendi qendror i aktivitetit të dhomës, apo i vendit ku merren vendime, miratohen ligjet dhe ku zhvillohen debate në të cilat ftohen të bashkëpunojnë të gjithë deputetët dhe nëpërmjet tyre i gjithë vendi. Vendimi me një reliev politik të gjerë, ai që i jep besimin qeverisë, merret duke ftuar të gjithë deputetët për t'u shprehur personalisht, përballë kryetarit

të dhomës, nëse janë dakort apo jo me qeverinë. Vendimet merren me shumicën e anëtarëve.

KOMISIONET PARLAMENTARE

Vendimet e marra nga seanca plenare vijnë si rezultat i një pune përgatitore shpesh të gjatë e të ndërlikuar të zhvilluar në komisionet parlamentare, të specializuara në sektorë të ndryshëm. Komisionet parlamentare parashikohen edhe në dispozitat kushtetuese. Ato përbëhen nga deputetë në mënyrë që të respektojnë raportet numerike të forcave politike të pranishme në parlament. Në Dhomën e deputetëve veprojnë 14 komisione të përhershme, ndërsa në Senatin e Republikës 13, të cilat dallohen në bazë kompetencash të fushave që mbulojnë. Komisionet parlamentare përkufizohen nga dispozitat e rregulloreve parlamentare si kolegje parlamentare të lidhura ngushtë me kompetenca të veçanta dhe që pasqyrojnë përbërjen politike të Dhomës apo Senatit. Përbërja dhe kompetencat e tyre si dhe karakteri i vazhdueshëm janë objekt i dispozitave të këtyre rregulloreve. Kompetencat e komisioneve parlamentare përfshijnë veprimtarinë e një apo disa ministrive, dhe janë thelbësisht legjislativë e të kontrollit politik.

Pranë komisioneve parlamentare të përhershme vepron Këshilli për Legjislacionin, i cili ka për qëllim përmirësimin e nivelit cilësor të legjislacionit. Në brendësi të komisioneve të përhershme vlen të përmenden edhe nënkomisionet, përbërja e të cilave pasqyron përbërjen politike të dhomës. Qëllimi i ngritjes së tyre është shqyrtimi i çështjeve të veçanta.

Komisionet parlamentare përcaktohen si një seancë plenare në miniaturë. Komisionet janë zemra e aktivitetit parlamentar pasi pikërisht prej këtu parlamentarët, të bashkuar në një rreth më të ngushtë, sipas fushave të kompetencave, shqyrtojnë projektligjet, i diskutojnë ato e pas një periudhe 1 apo 2 mujore ballafaqimi e diskutimi përgatisin tekstin e projektligjit që i paraqitet seancës plenare. Kjo e fundit, pas diskutimit, modifikimit merr vendimin për miratim ose jo. Për një funksionim sa më të mirë të një sistemi

dydhomësh të barabartë parashikohet një koordinim për të evituar që të dyja dhomat të jenë njëkohësisht të angazhuara në shqyrtimin e projektligjeve mbi të njëjtin argument.

Komisionet zhvillojnë edhe detyra të drejtimit e kontrollit të aktivitetit të qeverisë me referim ministrive që hyjnë në sektorë të kompetencës së tyre. Në zhvillimin e të gjitha funksioneve të tyre, komisionet shpesh marrin të gjithë informacionet e dobishme për të vlerësuar në mënyrë të pavarur çështjet që u janë vënë për zgjidhje. Në disa raste komisionit i duhet të zhvillojë një hetim njohës, duke dëgjuar të gjithë personat të cilët janë në gjendje të japin informacione të dobishme ose opinione të vlefshme.

Kushtetuta parashikon që parlamenti mund të zhvillojë edhe hetime mbi çështje me interes publik. Për zhvillimin e hetimeve të tilla ngrihen komisionet hetimore duke i dhënë të njëjtin pushtet e të njëjtat kufizime të një autoriteti gjyqësor. Në disa raste komisionet formohen nga numër i barabartë senatorësh e deputetësh (komisione dy dhomëshe). Ndërsa mundësia e krijimit të komisioneve të posaçme hyn në fushën e pushtetit të vetëorganizimit të dhomave për trajtimin e çështjeve specifike.

Dhomat mund të ngrënë edhe komisione të përbashkëta: disa prej tyre parashikohen me kushtetutë, ndërsa disa të tjera me ligj. Qëllimi i ngritjes së tyre është për t'ju përgjigjur nevojave të veçanta. Tipologjia e komisioneve parlamentare dydhomëshe është e ndryshme dhe bazohet në funksione: përmendim komisionin e kontrollit, këshillimit, hetimor etj.

SHQYRTIMI I AKTEVE

Dispozitat kushtetuese si dhe ato të Rregulloreve Parlamentare parashikojnë mënyra të ndryshme shqyrtimi të projektligjeve: shqyrtim në “rrugë referuese” me shqyrtimin fillimisht në komisione e më pas në seancë plenare; shqyrtim në rrugë legjislative apo vendimmarrëse, sipas së cilës komisioni përgjegjës ka atributet për ta shqyrtuar e miratuar projektligjin pa e kaluar në seancë plenare dhe shqyrtim në rrugë formuluese, sipas së cilit

komisioni përgjegjës formulon tekstin e projektligjit, duke ia paraqitur atë seancës plenare për të cilën ekzistojnë dy mënyra: ose të miratohet siç është formular ose të hidhet poshtë pa patur mundësinë e modifikimit. Lidhur me mënyrat e shqyrtimit, dhomat janë të lira të zgjedhin atë që preferojnë, madje mund të ndjekin edhe një shqyrtim ndryshe nga ajo e dhomës tjetër në leximin e parë. Kufizimi bëhet nga kushtetuta për ligjet konstitucionale dhe elektorale, të delegimit legjislativ, të autorizimit e të ratifikimit të marrveshjeve ndërkombëtare e të miratimit të buxhetit për të cilat duhet ndjekur detyrimisht shqyrtim në rrugë referuese.

Shqyrtimi në komision fillon me shqyrtimin paraprak, i cili ka të bëjë me mbledhjen e elementëve të informimit nga relatori duke i kushtuar vëmendje të veçantë hetimit. Këtu bëhet fjalë për një organizim punësh me detyrimin për ta përfunduar 48 orë para datës së përcaktuar për shqyrtim në seancë plenare. Relatori i caktuar nga kryetari komisionit ka funksionin e shqyrtimit të projektligjit dhe paraqitjen e tij komisionit në diskutimin në parim të tij, në të cilin merr pjesë një përfaqësues nga qeveria. Nëse ka disa variante të projektligjit në shqyrtim, komisioni në përfundim të diskutimit në parim, vendos nëse do të paraqesë një tekst bazë nga variantet e paraqitura (në përgjithësi, teksti i qeverisë) apo të vazhdojë me redaktimin e një teksti që në përgjithësi i kalohet një komiteti më të ngushtë. Në këtë fazë fillon hetimi dhe komisioni procedon me seanca dëgjimore formale ose joformale, si dhe me mbledhjen e elementeve informues nga ana e qeverisë në seancë plenare ose komitetin më të ngushtë. Komisioni mund të emërojë një komitet më të ngushtë, i cili kryen aktivitetet hetimor në një mënyrë më të ngushtë në krahasim me komisionin në përbërje. Edhe në komitetin më të ngushtë procedohet me fazën hetimore, por pa publicitet të jashtëm. Komiteti hyn në kontakte me shoqërinë civile (shoqata, grupe presioni, etj) me ekspertë të asaj fushe, duke mbledhur informacione shpesh të kundërta pa qenë i mundur ndonjë kontroll politik. Punët e komitetit përfundojnë me zgjedhjen e një teksti projektligji unifikues. Ky shqyrtim paraprak përfundon me caktimin e tekstit

dhe të një afati kohor për paraqitjen e amendamenteve. Amendamentet mund të paraqiten nga çdo parlamentar, edhe pse jo anëtar komisioni. Votimi bëhet i hapur dhe është e nevojshme shumica e të pranishmëve + 1. Shqyrtimi përfundon me miratimin e projektligjit dhe caktimin e relatorit për në seancë plenare. Nëse gjatë shqyrtimit kanë dalë në dukje interesa që puqen (konvergjente) komisioni mund të kërkojë transferimin e projektligjit nga rruga referuese në rrugë legjislative/vendimmarrëse. Me miratimin e projektligjit komisioni harton dhe relacionin përkatës për në seancë. Nëse në komision ka patur divergjenca, opozita del me relacion më vehte. Në këtë rast caktohet edhe një relator nga opozita. Komisioni emëron komitetin e të nëntëve që në senat merr emrin nënkomision dhe përbëhet nga 7 anëtarë, duke respektuar përbërjen politike të dhomës e me qëllim mbrojtjen e diskutimeve në seancë. Komiteti i të nëntëve apo nënkomisioni ka detyrën e shqyrtimit të amendamenteve të propozuara në seancë dhe shprehjen e mendimit për secilën prej tyre. Që prej këtij momenti, p/ligji përcaktohet në gjendje relacioni në pritje për t'u futur në rendin e ditës për në seancë.

Komisionet shprehin edhe mendim mbi projektligje të destinuar komisionit përgjegjës. Në përfundim të formulimit të tekstit janë shumë të rëndësishme mendimet e komisionit të buxhetit, të çështjeve kushtetuese dhe ligjore, dhe të atij kompetent për raportet me Bashkimin Europian si dhe mendimi i Këshillit për Legjislacionin. Në rast konsensusi shumë të shtrirë i barabartë me 9/10 e deputetëve, komisioni përgjegjës mund të ngarkohet nga seanca plenare të miratojë projektligjin duke ushtruar të njëjta pushtet si seanca. Në këtë rast bëhet fjalë për një shqyrtim të projektligjit në rrugë legjislative apo vendimmarrëse.

Dispozitat kushtetuese parashikojnë, gjithashtu, edhe mundësinë e miratimit të një projektligji vetëm nga komisioni përgjegjës pa kalimin në seancë plenare. Bëhet fjalë për një procedim të veçantë, në të cilën shqyrtimi dhe miratimi final i projektligjit bëhen nga komisioni përgjegjës. Një procedim i tillë garanton një miratim të shpejtë të aktit, gjatë të cilit, jo vetëm kursehet koha e kalimit

në seancë plenare, por edhe arrihet një konsensus më i lehtë. Qëllimi i kushtetutës në lënien në fuqi të procedurës së sipërpërmendur e futur në rregulloren e vitit 1939, ishte rritja e produktivitetit të parlamentit. Në qëllimin e kostituentit është procedimi i shpejtë për projektligje jo të një rëndësie të veçantë për të cilën është e mundur t'i lihej një organi kompetent shqyrtimi dhe miratimi përfundimtar i tekstit. Por në të njëjtën kohë dispozitat kushtetuese e ato të rregullores parashikojnë edhe një rezervë ndaj seancës plenare: projektligje që kanë të bëjnë me çështje kushtetuese dhe zgjedhjet; delegim legjislativ i qeverisë; ratifikim traktatesh; miratim buxheti i shtetit, ratifikim i akteve normative me fuqinë e ligjit që nxjerr qeveria; projektligje të cilat kthehen për shqyrtim nga Presidenti i Republikës, për të cilat kërkohet detyrimisht vendimi i seancës plenare.

Komisioni mund të operojë edhe në rrugë formuluese. Këtu bëhet fjalë për një shqyrtim i cili parashikohet edhe nga dispozitat kushtetuese. Nuk është gjë tjetër veçse një mënyrë shqyrtimi midis atij të zakonshëm dhe atij të veçantë. Kur shqyrtimi vendoset të bëhet në rrugë formuluese do të thotë që komisioni ka për detyrë të formulojë nenet e projektligjit dhe të paraqesë një tekst në séance plenare për të cilin ekzistojnë dy mënyra: ose të miratohet siç është formuluar, ose të hidhet poshtë pa patur mundësinë e modifikimit.

Për të arritur në një miratim përfundimtar të ligjit është e domosdoshme që ai të miratohet prej të dyja dhomave: projektligji miratohet në leximin e parë nga njëra prej dhomave e më pas në leximin e dytë nga dhoma tjetër. Në rastin kur njëra dhomë duhet të ndryshojë projektligjin e miratuar nga dhoma tjetër është i nevojshëm procedimi i ashtuquajtur “navette”, duke proceduar me një shqyrtim të ndryshimeve të propozuara deri në miratimin përfundimtar nga ana e të dyja dhomave.

TRANSPARENCA E VEPRIMTARISË SË PARLAMENTIT

Sipas dispozitave kushtetuese, seancat plenare zhvillohen me dyer të hapura, megjithatë po sipas Kushtetutës, dhomat mund të zhvillojnë punimet

parlamentare edhe me dyer të mbyllura. Parimi i publicitetit të punimeve parlamentare është i lidhur ngushtë me parimin demokratik, i cili kërkon një manifestim të votës dhe si i tillë ka për qëllim ti bëjë të ditur zgjedhësve një kontroll mbi aktivitetin e parlamentit nga vetë të zgjedhurit e tyre.

Dhoma e deputetëve që prej vitit 1870 e ka selinë e saj në Pallatin “Montecitorio”, ndërkohë që Senati në pallatin “Madama”, ndërtesa këto plot me histori dhe të pasura me vepra arti. Megjithatë qyteti parlamentar përfshin edhe ndërtesa të tjera rreth tij, në të cilën janë vendosur të gjitha shërbimet që realizojnë një zhvillim të mirë të punimeve parlamentare. Të njohësh aktivitetin e Parlamentit italian do të thotë të njohësh punën që zhvillohet në seancë plenare e komisione në secilën dhomë. Të dyja dhomat nuk janë vetëm një “fabrikë” ligjesh apo vend ku ushtrohen funksionet e drejtimit e të kontrollit të qeverisë: ato janë vend ku zhvillohen edhe koncerte, konferenca mbi tema kulturore e artistike, si dhe motori i nismave të formimit qytetar dhe, në veçanti, të të rinjve me institucionet parlamentare.

Për të dhënë një ide të kompleksitetit të punimeve e të iniciativave, mjafton të përmendet fakti se çdo ditë në ambjentet parlamentare hyjnë rreth 5000 persona (deputetë, gazetarë, punonjës, vizitorë e studentë). Qytetarët mund të marrin pjesë në punimet e seancës plenare, të komisioneve parlamentare, madje mund të njihen me to edhe nëpërmjet faqes së internetit. Të rinjtë mund të organizojnë vizita shkollore apo të marrin pjesë në ditët e formimit. Faqja e internetit jep mundësinë e hyrjes dhe të njohjes me të gjithë dokumentacionin parlamentar, si dhe me aktivitetin e zhvilluar nga çdo deputet në një kohë më të shkurtër dhe në mënyrë më të gjerë.

ADMINISTRATA

Në krye të administratës së secilës dhomë qëndron Sekretari i Përgjithshëm i cili nëpërmjet punonjësve, të marrë me konkurs publik e të organizuar në shërbime e zyra të lidhura drejtpërdrejtë me të, garanton një zhvillim të mirë të punimeve parlamentare, duke u vënë në dispozicion

deputetëve instrumentet e nevojshme në punën e tyre.

HISTORIK I SHKURTËR

Parlamenti italian origjinën e tij e gjen në parlamentin e Mbretërisë së Italisë të vitit 1848. Karta Kushtetuese dhënë qytetarëve nga Karlo Alberto më 4 mars 1848, dhe destinuar për t'u bërë Karta Kushtetuese e Mbretërisë parashikonte një parlament të përbërë nga dy dhoma: Senati i Mbretërisë dhe Dhoma e Deputetëve. Sipas statutit ligjet duhej të miratoheshin nga të dyja dhomat. Dhoma e deputetëve formohej nga qytetarë të zgjedhur, ndërkohë që Senati nga njerëz të emëruar nga mbreti. Gjatë periudhës fashiste më 1939 Dhoma u zëvendësua nga një Dhomë fashiste e përbërë nga këshilltarë kombëtarë jo më të zgjedhur nga qytetarë por përkundrazi të emëruar nga kryetari i qeverisë së asaj kohe. Pas rënies së fashizmit, më 2 qershor 1946, populli italian nëpërmjet referendumit zgjodhi formën republikane dhe një asamble kostitutive për të përgatitur Kartën e re Kushtetuese në zëvendësim të statutit të vjetër Albertin. Për herë të parë, gratë fitojnë të drejtën e votës. Kushtetuta italiane e hyrë në fuqi më 1 janar 1948, parashikonte një parlament të përbërë prej dy dhomash, të dyja të zgjedhura prej një votimi të përgjithshëm e të drejtpërdrejtë, me të njëjtat funksione e të njëjtin pushtet. Po në këtë vit qytetarët italianë iu drejtuan kutive të votimit për të zgjedhur anëtarët e parlamentit të parë të Republikës italiane.

Nga punimet e Kuvendit për periudhën 20 shkurt- 10 mars 2006

Përgatiti: Alma Kondakçiu

RAPORTIME TË INSTITUCIONEVE TË PAVARURA

1. Raporti i veprimtarisë së Këshillit Kombëtar të Radiotelevizionit për vitin 2005 dhe miratimi i projektrezolutës (shqyrtuar në seancë plenare më datë 27.2.2006)

Raporti i prezantuar në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik dhe në seancë plenare nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Radiotelevizionit (KKRT), Halil Lalaj, pasqyron veprimtarinë e këtij institucioni për vitin 2005, e cila është zhvilluar në përputhje me ligjin nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” dhe me rekomandimet e Këshillit të Europës. Në raport theksohet se veprimtaria e KKRT-së në fushën e rregullimit të mediave elektronike ka shënuar progres. Gjatë këtij viti është evidentuar rritja e efektivitetit të administratës së institucionit, rritje e qëndrueshmërisë dhe e cilësisë së mjeteve të transmetimit, përmirësim i programacionit dhe nxitje e diversitetit të tij, krijim i hapësirave mediatike për minoritetet, zbatim i rregullave të konkurrencës së ndershme për trajtimin e operatorëve, në bazë të parimeve të barazisë, të proporcionalitetit dhe të mosdiskriminimit.

Gjatë diskutimit rreth raportit, shumica e deputetëve shprehën mendimin se veprimtaria e KKRT-së për rregullimin e veprimtarisë radio e televizive nuk ka qenë në nivelin që përcakton ligji, operatorët radio e televizivë ende nuk e njohin rolin dhe autoritetin e KKRT-së dhe kanë mangësi në respektimin

e të drejtave të transmetimit dhe të të drejtave në zonat e licensuara të mbulimit, KKRT-ja është nënshtruar ndaj presioneve të grupeve të ndryshme të interesit dhe ndaj grupeve të caktuara politike, si dhe nuk ka respektuar të drejtat e transmetimit dhe rregullat e konkurrencës.

Për të vënë në zbatim legjislationin në fushën e veprimtarive radio e televizive dhe për të rritur rolin e KKRT-së, Kuvendi miratoi një rezolutë, në të cilën kërkon shkarkimin e anëtarëve të KKRT-së, vendosjen e autoritetit të ligjit në mënyrë të plotë dhe reformimin institucional të KKRT-së drejt një institucioni më funksional.

2. Raporti për veprimtarinë e Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave gjatë vitit 2005 dhe miratimi i Projektrezolutës (shqyrtuar në seancë plenare në datat 27 shkurt dhe 1 mars 2006).

Raporti për veprimtarinë e Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave (KSHKKP) u paraqit në Komisionin për Ekonominë dhe Financat, në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë e Mjedisin dhe në seancë plenare nga kryetari i këtij Komisioni, Sokrat Sinaj. Në raport pasqyrohet puna e këtij institucioni për hartimin e bazës ligjore, puna e bërë nga komisionet vendore për njohjen dhe kthimin fizik të pronës në të gjitha qarqet, në përputhje me procedurat e përcaktuara nga ligji dhe aktet nënligjore, faktorët që kanë ndikuar negativisht në ecurinë e procesit të kthimit e kompensimit të pronave, realizimi i kompensimit financiar në zonën urbane të Tiranës dhe problemet e vërejtura gjatë këtij procesi, shqyrtimi i ankesave të subjekteve të shpronësuara, veprimtaria ekonomike e financiare e institucionit, marrëdhëniet e tij me Kuvendin, Këshillin e Ministrave dhe objektivat për vitin 2006.

Njeri prej anëtarëve të KSHKKP-së, Njazi Kosovrasti, spjegoi votën kundër Reportit të paraqitur nga Kryetari i Komitetit.

Pasi dëgjuan raportin e KSHKKP-së dhe spjegimin e votës kundër tij, deputetët mbajtën dy qëndrime për vlerësimin e punës së këtij institucioni.

Mendimi i shumicës ishte se procesi i kthimit dhe kompensimit të pronave nga komisionet vendore dhe nga KSHKKP-ja ka filluar me vonesë, kompensimi fizik ende nuk ka filluar, nuk ka një projekt të qartë për përpilimin e hartës së vlerës së pronës dhe nuk është kërkuar zyrtarisht prej KSHKKP-së fondi i nevojshëm për të. Ka ngadalësi në shqyrtimin e ankesave të subjekteve të shpronësuara, vonesat e deritanishme në procedurat për kryerjen e kompensimit fizik dhe financiar rrezikojnë kryerjen brenda afateve ligjore të këtij procesi. Vihen re shkelje ligjore nga disa institucione për tjetërsimin e pronës shtetërore, duke krijuar diferencime në dhënien e përfitimeve ligjore etj.

Duke gjykuar se rezultatet joefektive të punës së KSHKKP-së janë rrjedhojë e mangësive në organizimin e punës dhe e nënvlerësimit të zbatimit të detyrimeve ligjore nga ky institucion, deputetët e shumicës kërkuan rritjen e angazhimit të këtij institucioni për përmbushjen e detyrimeve ligjore, rritjen e rendimentit, të cilësisë së punës dhe të përgjegjësisë nga komisionet vendore, forcimin e rolit mbikëqyrës të KSHKKP-së ndaj komisioneve vendore, zbatimin e ligjit nga institucionet shtetërore për të mënjeluar favorët ndaj disa personave, forcimin e bashkëpunimit të KSHKKP-së me institucionet shtetërore për zbatimin e detyrimeve ligjore, rritjen e bashkëpunimit të këtij institucioni me Kuvendin për të vënë para përgjegjësisë institucionet që nuk përmbushin detyrimet ligjore.

Ata i kërkuan KSHKKP-së të rrisë efektivitetin e punës së tij, të hartojë sa më parë projektin dhe preventivin e hartës së vlerës së pronës, të fillojë pranimin e kërkesave të subjekteve të shpronësuara për kompensimin e pronës dhe të përshpejtojë procesin e vendimmarrjes në përgjigje të ankesave të qytetarëve.

Pakica e deputetëve vlerësuan përpjekjet e KSHKKP-së për zbatimin e detyrimeve të tij ligjore dhe tërhoqën vëmendjen e këtij institucioni për moskryerjen brenda afatit të disa detyrimeve, veçanërisht të hartimit të hartës së vlerës së pronës, kërkuan përgatitjen e projektit për përpilimin e hartës së

vlerës së pronës, rritjen e bashkëpunimit të KSHKKP-së me institucionet e tjera dhe realizimin brenda afatit e me cilësi të procesit të njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronës.

Në përfundim të diskutimit, Kuvendi miratoi një rezolutë për vlerësimin e veprimtarisë së KSHKKP-së, e cila mbështetet në mendimin e shumicës së deputetëve.

Informacion mbi legjislacionin e miratuar në Kuvend

Filip Lako

Jurist

Qendra e Studimeve Parlamentare

Ligj nr. 9150, datë 30.10.2003 “Për Urdhrin e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë”. Urdhri i Farmacistëve është krijuar për ruajtjen e cilësisë së lartë të shërbimit dhe për zbatimin e rregullave të moralit e të etikës profesionale farmaceutike. Ky Urdhër është ent publik, i cili përbëhet nga individët që ushtrojnë profesionin e farmacistit në Republikën e Shqipërisë dhe përfaqëson interesat e tyre profesionale në nivel partneriteti institucional. Urdhri i Farmacistëve ka për mision ruajtjen dhe garantimin e nivelit të lartë të formimit dhe edukimit shkencor e profesional të farmacistëve, si dhe mbrojtjen e tyre nga veprimet arbitrare të administratës publike ose private për ushtrimin e profesionit. Po ashtu, ky Urdhër ka për qëllim edhe mbrojtjen e pacientëve dhe të konsumatorëve nga kequshtrimet profesionale dhe shkeljet e normave të detyrueshme. Anëtarë të këtij Urdhri bëhen shtetasit shqiptarë të diplomuar farmacistë, që pranojnë Kodin Deontologjik Farmaceutik Shqiptar dhe që e ushtrojnë këtë profesion. Anëtarë të këtij Urdhri bëhen shtetasit e huaj që pranojnë kushtet e përmendura më lart, si dhe që njohin e zbatojnë të gjitha aktet ligjore e nënligjore, që rregullojnë shërbimin farmaceutik. Anëtarësimi i të huajve në këtë Urdhër është kusht për ushtrimin e profesionit nga ana e tyre. Organet kryesore të Urdhrit të Farmacistëve janë: asamblëtë, këshillat, komisionet disiplinore dhe Komisioni

i Regjistrimit dhe i Dhënies së të Drejtës së Ushtrimit të Profesionit. Tek asamblatë hyjnë Asambleja e Përgjithshme dhe Asambleja Rajonale. Asambleja e Përgjithshme zgjedh Këshillin Kombëtar, Presidentin e zëvendësin e tij, kurse Asambleja Rajonale zgjedh këshillin rajonal. Pra, siç shihet te këshillat hyjnë Këshilli Kombëtar dhe Këshilli Rajonal. Ligji ka përcaktuar në mënyrë taksative përgjegjësitë dhe detyrat e Këshillit Kombëtar e të Këshillave Rajonale. Pranë Këshillit Kombëtar dhe Këshillave Rajonale funksionojnë komisionet disiplinore, të cilat hetojnë dhe gjykojnë, në mbështetje të fakteve dhe provave të administruara në seanca dëgjimore dhe japin masat përkatëse. Ligji ka 22 nene dhe ka hyrë në fuqi më 18.12.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 97, të vitit 2003, në faqen 4213.

Ligji nr. 9151, datë 6.11.2003 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së kredisë të zhvillimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për projektin e punëve të Komunitetit – II””. Marrëveshja e lartpërmendur është lidhur më 24 korrik 2003 ndërmjet Shqipërisë (Huamarrësve) dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (Shoqata). Nga Marrëveshja del se Huamarrësi ka kërkuar nga Shoqata që kjo e fundit të ndihmojë në financimin e projektit, i cili do të realizohet nga Fondi i Zhvillimit Shqiptar (FZSH), me ndihmën e Huamarrësit. Për këtë qëllim, Shoqata ka pranuar t’i japë Huamarrësit, sipas kushteve dhe konditave të përcaktuara ose të përmendura në Marrëveshjen e Kredisë për Zhvillim, një shumë në valutë të ndryshme, baras me dhjetë milionë e nëntëqind mijë të drejta të posaçme tërheqëse (SDR 10 900 000). Njëkohësisht, Huamarrësi ka deklaruar angazhimin e tij ndaj objektivave të projektit, të përcaktuara në shtojcën 2 të kësaj Marrëveshjeje, dhe për këtë qëllim do të bëjë disponibël te FZSH-jë shumat e kredisë sipas marrëveshjes që do të lidhet ndërmjet Huamarrësit dhe FZSH-së, sipas kushteve dhe konditave, të cilat janë miratuar nga Shoqata. Në shtojcën 2 ndodhet përshkrimi i projektit. Nga kjo del se qëllimet e projektit janë: a) ndihma për Huamarrësin

që të nxisë zhvillimin e bashkësisë bazuar në përparësitë e zhvillimit të pushteteve dhe të bashkësive vendore dhe b) të ndërtojë kapacitetet e pushteteve vendore dhe të bashkësive vendore, për të nxitur zhvillimin e ekonomisë vendore. Më konkretisht, ky projekt konsiston ndër të tjera edhe në rehabilitimin e rrugëve, riparimin ose shtrirjen e sistemit të kanalizimeve dhe të ujësjellësve, riparimin dhe rindërtimin e shkollave dhe qendrave shëndetësore dhe ndërtesave të tjera publike, ndërtimin ose rehabilitimin e tregjeve, zhvillimin e programeve të dhënies së shërbimeve sociale, sigurimin e trajnimeve dhe shërbimeve sociale, sigurimin e trajnimeve dhe shërbimeve të konsulencës teknike për stafin e pushtetit vendor etj. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 25.12.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 100 të vitit 2003, në faqen 4293. Ligjit i bashkëlidhen: Marrëveshja dhe 3 shtojca.

Ligji nr. 9152, datë 6.11.2003 “Për ratifikimin e “Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Komunitetit European, për statusin e misionit të asistencës policore të Komunitetit European në Shqipëri (PAMECA)””.

Më 17 dhjetor 2002, ndërmjet Komisionit të Komunitetit European (Komisioni) dhe Ministrisë së Brendshme të Spanjës është lidhur një kontratë me synim vendosjen e Misionit të Asistencës Policore të Komunitetit European në Shqipëri (PAMECA). Paraprakisht, më 1 shtator 2002 Qeveria e Republikës së Shqipërisë ka lidhur me Komisionin e Komunitetit European një Marrëveshje kuadër, sipas së cilës Qeveria e Republikës së Shqipërisë ka rënë dakord për vendosjen e misionit PAMECA në Shqipëri. Nga Marrëveshja rezulton se misioni PAMECA do të synojë në dhënien e mbështetjes së vazhdueshme ndaj Policisë së Shtetit Shqiptar, kryesisht nëpërmjet sigurimit të vazhdimësisë së një sërë veprimtarish që janë përgatitur ose janë zbatuar nga elemente policore këshillimore shumëkombëshe të Unionit European Perëndimor (MAPE) dhe asistencës policore të Komisionit European (ECPA). Gjithashtu, misioni PAMECA angazhohet të zbatojë veprimtaritë e

tij në përputhje me mandatin që i jep kjo Marrëveshje (neni 2), si dhe të raportoje rregullisht me shkrim pranë Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit European mbi veprimtaritë dhe konstatimet e misionit PAMECA, duke përfshirë progresin e zbatimit në të gjitha fushat e veprimtarisë së tij, si dhe përputhjen me nisma të tjera që kanë lidhje. Marrëveshja përmban edhe angazhimet e Qeverisë në lidhje me veprimtarinë e misionit PAMECA, privilegjet dhe imunitetet e këtij misioni dhe të stafit të tij, angazhimet e Qeverisë në lidhje me anëtarët e stafit, këshilltarët dhe konsulentët e misionit PAMECA, probleme të juridiksionit lidhur me imunitetin, çështje që kanë të bëjnë me pretendimet për kompensim dhe procedurat ligjore, kur prona e PAMECA-s ose e stafit të tij cenohet ose dëmtohet etj. Janë parashikuar, gjithashtu, edhe komunikimi midis palëve, mënyra e zgjidhjes të mosmarrëveshjeve, procedurat që do të ndiqen etj. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 25.12.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 100 të vitit 2003, në faqen 4301. Ligjit i bashkëlidhet Marrëveshja.

Ligji nr. 9153, datë 6.11.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8167, datë 21.11.1996 “Për shërbimin shëndetësor stomatologjik”, i ndryshuar me ligjin nr. 8414, datë 1.10.1998”. Sipas nenit 10 të ligjit në fuqi, personat juridikë dhe fizikë vendas dhe të huaj janë të detyruar të pajisen me licencë profesionale: 1) për ushtrimin e veprimtarisë private në fushën e stomatologjisë; 2) për hapjen e institucioneve stomatologjike private (në trajtën e klinikave komplekse dentare); 3) për tregtimin e materialeve dhe të aparaturave dentare. Me ligjin nr. 9153, datë 6.11.2003, në nenin 10 të ligjit në fuqi shtohet edhe një rast i katërt që kërkon pajisje me licencë. Pra, sipas shtesës pajisja me licencë kërkohet edhe për kualifikimin e specializimin e specialistëve të mesëm e të lartë dhe për hapjen e shkollave profesionale që përgatisin specialistë të fushës së stomatologjisë, sipas legjislacionit për arsimin dhe formimin profesional. Pas nenit 10 është shtuar neni 10/1. Me këtë shtesë kërkohet që personat të cilët kanë licencë

për tregtimin e materialeve dhe të aparaturave dentare, për çdo importim të bërë, duhet të pajisen nga Ministria e Shëndetësisë me leje importi për materiale dhe aparatura dentare. Sipas nenit 11 të ligjit në fuqi, shërbimi shëndetësor stomatologjik, publik dhe privat kontrollohet nga pesë lloj strukturash. Me ndryshimin që i bëhet nenit 11, shërbimi shëndetësor, publik dhe privat, kontrollohet nga Inspektorati Stomatologjik Shtetëror. Gjithashtu, në ligjin në fuqi, pas kreut III shtohet kreu III/1, i cili trajton problemin e strukturave të kontrollit të shërbimit stomatologjik. Sipas kësaj shtese, në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, krijohet Inspektorati Stomatologjik Shtetëror, si organi më i lartë i kontrollit stomatologjik. Ky Inspektorat është organi ekzekutiv i specializuar që kontrollon zbatimin e këtij ligji dhe të akteve nënligjore në shërbimin stomatologjik publik dhe privat. Inspektorati Stomatologjik, në kryerjen e detyrave të tij, bashkëpunon me Inspektoratin Sanitar Shtetëror, Inspektoratin Epidemiologjik dhe Komisionin e Mbrojtjes nga Rrezatimet. Bashkërendimi i punës së këtyre organeve bëhet me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë. Ligji ka 5 nene dhe ka hyrë në fuqi më 25.12.2003. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 100 të vitit 2003, në faqen 4310.

Ligji nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”. Ligji i lartpërmendur përcakton rregullat bazë për organizimin dhe funksionimin e shërbimit arkivor në Shqipëri, institucionet që kryejnë këtë shërbim, si dhe detyrimet e tyre ligjore për krijimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e pasurisë arkivore, si pjesë e trashëgimisë kombëtare. Ligji përcakton se cili quhet fond arkivor kombëtar dhe si do të jetë organizimi i rrjetit arkivor. Ky rrjet përbëhet nga Drejtësia e Përgjithshme Arkivore, Arkivi Qendror Shtetëror, arkivat shtetërore që ruajnë dokumente të së njëjtës tipologji (Arkivi Qendror i Filmit, Arkivi Qendror Teknik), arkivat shtetërore të sistemit që veprojnë në mënyrë të përhershme pranë institucioneve qendrore fondkrijuese, arkivat shtetërore vendore, arkivat në veprim të institucioneve shtetërore, qendrore dhe vendore, dhe arkivat private. Arkivi Qendror Shtetëror ruan, administron dhe shërben trashëgiminë

dokumentare joadministrative, të krijuar në hapësirën shqiptare gjatë shekujve, pavarësisht nga fondkrijuesi, gjuha, alfabeti, përmbajtja ose tipologjia e shkrimit. Arkivat shtetërore të sistemit administrojnë dhe ruajnë dokumentet e trashëguara, si dhe dokumentet e krijuara gjatë veprimtarisë së institucioneve që, sipas ligjit, e dorëzojnë pasurinë arkivore pranë tyre. Këto arkiva janë në varësi administrative të drejtpërdrejtë të drejtuesit të institucionit. Arkivat shtetërore vendore administrojnë dhe ruajnë dokumentet e trashëguara, si dhe ato të arkivave të institucioneve shtetërore vendore dhe të organeve të qeverisjes vendore që veprojnë brenda njësisë administrativo-territoriale përkatëse. Arkivat private e ushtrojnë veprimtarinë e tyre pasi licencohen nga Këshilli i Lartë i Arkivave, me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave. Kriteret për licencimin përcaktohen nga Këshilli i Ministrave. Pasuri të arkivave private, për arsye historike ose me interes publik, mund të shpallen dokumente me rëndësi kombëtare. Shpallja e tyre si të tilla nuk është pengesë për transferimin e së drejtës së pronësisë dhe të të drejtave të tjera mbi këto dokumente. Ligji ka përcaktuar afatet e dorëzimit të dokumenteve në arkivat shtetërore, komunikimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve të fondit arkivor kombëtar, eksportimin dhe importimin e dokumenteve, kushtet për të qenë arkivist dhe veprimet që formojnë kundravajtje administrative. Ligji ka 96 nene dhe ka hyrë në fuqi më 25.12.2003. Ky ligj ka shfuqizuar ligjin nr. 7726, datë 29.6.1993 “Për fondin arkivor kombëtar dhe për arkivat”. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 100 të vitit 2003, në faqen 4311.

Ligji nr. 9155, datë 4.12.2003 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane për programin vjetor kombëtar të veprimit “CARDS 2003”. Komuniteti European, i përfaqësuar nga Komisioni i Komuniteteve Europiane nga njëra anë, dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë nga ana tjetër kanë lidhur Marrëveshje

Financiare, sipas së cilës Komuniteti do të kontribuojë për financimin e programit “Programi vjetër i veprimit 2003 për Shqipërinë”. Kostoja totale e programit është 46.500.000 euro. Periudha e ekzekutimit të Marrëveshjes Financiare do të fillojë në momentin e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje dhe do të përfundojë, e shumta, në datën 31.12.2009. Kontratat e zbatimit të Marrëveshjes Financiare do të nënshkruhen, e shumta, brenda datës 16.7.2006. Në Shtojcën II, që është pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje, në përshkrimin e programit, thuhet se objektivi i përgjithshëm i ndihmës së BE-së përcaktohet në kuadrin e procesit të stabilizim-asociimit (PSA) dhe përfshin forcimin e shtetit të së drejtës dhe stabilizimin demokratik, si dhe zhvillimin ekonomik e social. Objektiva të veçantë të programit janë drejtësia dhe punët e brendshme, forcimi i kapaciteteve administrative, zhvillimi ekonomik e social e stabilizimi demokratik. Në vazhdim me çka u tha më lart, detajet e programit janë konkretisht: rinovimi i dy gjykatave të apelit (Korçë dhe Vlorë), trajtimi dhe pajisja për administratën e gjykatave, ndërtimi dhe krijimi i Gjykatës për Krimet e Rënda, administrimi i bazës materiale të policisë, përmirësimi i administrimit të kufirit tokësor, pikave të kalimit të kufirit dhe postave të Policisë Kufitare, supervizioni i punimeve në portin e Durrësit, kontrolli paraprak i azilkërkuesve dhe migrantëve, forcimi i kapaciteteve administrative publike, sistemi i mbikqyrjes së tregut, programi i zhvillimit të bashkësive vendore, mbështetje për arsimin profesional dhe reformën e trajnimit dhe stabilizimi demokratik. Në këtë të fundit hyn rifreskimi i regjistrit të gjendjes civile, nëpërmjet krijimit të një regjistri qendror të kompjuterizuar të gjendjes civile, në bazë të të cilit të sigurohet lista e saktë e zgjedhësve, sigurimi i pajisjeve e trajnimi i stafit. Programi do të financohet nëpërmjet një granti të Komunitetit prej 46.500.000 Euro, i ndarë sipas fushave që përmenden më lart. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 31.1.2004. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 109 të vitit 2003, në faqen 4715. Ligjit i lidhen Marrëveshja Financiare dhe dy shtojcat.

Ligji nr. 9156, datë 4.12.2003 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane, për programin vjetor rajonal të veprimit “CARDS 2003””. Programi vjetor rajonal i veprimit CARDS 2003 financohet nga Komisioni Europian, si grant me një buxhet prej 31.500.000 euro. Ky program është për Shqipërinë, Bosnje dhe Hercegovinën, Kroacinë, Serbinë e Malin e Zi (Republika e Serbisë, Kosova, Republika e Malit të Zi) dhe ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, siç është miratuar nga Komisioni Europian më 16 korrik 2003. Në programin vjetor rajonal të veprimit CARDS 2003 janë identifikuar katër fusha parësore, për të cilat ka edhe projekte përkatëse. Këto fusha janë:

1. nxitja e administrimit të integruar të kufijve;
2. forcimi i kapaciteteve të institucioneve shtetërore;
3. mbështetje për stabilizimin demokratik; dhe
4. forcimi i infrastrukturës rajonale dhe zhvillimit mjedisor.

Marrëveshjes i bashkëngjiten Shtojca I – kushtet e përgjithshme dhe Shtojca II – kushtet teknike dhe administrative. Këto shtojca do të jenë pjesë përbërëse e Marrëveshjes.

Në Shtojcën I – kushtet e përgjithshme, trajtohen probleme lidhur me funksionimin e programit, me zbatimin e tij, me lidhjen e kontratave dhe dhënien e granteve, me rregullat e zbatueshme për përmbushjen e kontratave dhe me disa aspekte për transparencën, parandalimin e parregullsisë, rregullat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve etj.

Në Shtojcën II – kushtet teknike dhe administrative, jepet përmbledhja e programit dhe detajohet zbatimi i këtij programi në katër fushat e përmendura më sipër.

Kështu:

1) Në fushën e nxitjes dhe të administrimit të integruar të kufijve, projektet kanë për qëllim mbështetjen e vendeve të Ballkanit Perëndimor për t'u siguruar që strategjitë e tyre të administrimit të integruar të kufijve janë

zhvilluar në mënyrë koherente, duke ndjekur një metodologji rajonale të pranuar.

2) Në fushën e forcimit të kapaciteteve të institucioneve shtetërore, qëllimi është forcimi i kapaciteteve të administratave publike kombëtare, për të qenë në gjendje të marrin përsipër detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit dhe marrëveshjet që janë pjesë përbërëse e saj.

3) Në fushën e mbështetjes për stabilizimin demokratik, programi synon zhvillimin e mëtejshëm të sektorit të mediave, duke pasur parasysh dy komponentë, të përqendruar në produktet rajonale televizive dhe në shkëmbimin e lajmeve rajonale.

4) Në fushën e forcimit të infrastrukturës rajonale, qëllimi i projektit është të inkurajojë dhe të nxisë investimet transkufitare në fushën e mjedisit, të lehtësojë kushtet e jetesës dhe të pakësojë ndotjen e mjedisit në vendet e Ballkanit Perëndimor. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 31.1.2004. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 109 të vitit 2003, në faqen 4730. Ligjit i bashkëngjiten Marrëveshja dhe dy Shtojcat.

Ligji nr. 9157, datë 4.12.2003 “Për përgjimin e telekomunikimeve”.

Ky ligj përcakton procedurat që duhet të ndiqen për përgjimin e telekomunikimeve nga institucione shtetërore informative, të krijuara me ligj për realizimin e detyrave të tyre, si dhe procedurat që duhet të ndiqen nga personat e ngarkuar për përgjim. Gjithashtu, ligji synon të rrisë efektivitetin e punës së institucioneve shtetërore informative për zbulimin e veprimtarisë antikushtetuese, kriminale dhe keqbërëse, si dhe të parandalojë pasojat që mund të vijnë nga kjo veprimtari. Lidhur sa më sipër, theksohet se rezultatet e përgjimit, të marra në bazë të këtij ligji, nuk kanë vlerën e provës në një proces penal, me përjashtim të atyre të marra sipas Kodit të Procedurës Penale. Ligji parashikon procedurat për kryerjen e përgjimit dhe në detaje flitet për organet që mund të kërkojnë kryerjen e përgjimit, për kërkesat për përgjim, dhënien e të drejtës për përgjim etj. Përveç këtyre ka edhe probleme

teknike që trajtohen, siç janë ato që kanë të bëjnë me sektorin e përgjimeve, me bërthamën komanduese elektronike, kohëzgjatjen e vendimit të përgjimit, kufizimet në përgjim, situatat emergjente etj. Në kreun III të ligjit trajtohen kërkesat e veçanta për përgjim, që ka të bëjë me përgjimin me kërkesë të shërbimeve të huaja. Pra, me kërkesë të shërbimeve të huaja sekrete dhe me miratim të Prokurorit të Përgjithshëm, Sektori i Përgjimeve në SHISH mund të realizojë përgjimin, sipas këtij ligji, për llogari të shërbimit sekret të huaj. Materiali i përgjimit ruhet në rast se, sipas vlerësimit të Prokurorit të Përgjithshëm, ka premisa të bëhet i rëndësishëm për ruajtjen e jetës, sigurisë kombëtare, rendit publik ose parandalimin e krimeve të rënda. Ligji detyron operatorët e telekomunikacioneve të realizojnë, me shpenzimet e tyre, infrastrukturën e nevojshme në rrjetin e tyre të telekomunikacioneve, për të siguruar aftësinë përgjuese të rrjeteve të telekomunikacioneve. Ligji ka 26 nene dhe ka hyrë në fuqi më 22.1.2004. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 107 të vitit 2003, në faqen 4593.

Ligji nr. 9158, datë 18.12.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8977, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë””. Në ligjin në fuqi, në nenin 4 përcaktohen llojet e taksave kombëtare. Ky nen ka 23 pika dhe në pikën 21 shënohej si taksë kombëtare edhe taksa e rrugës Durrës-Kukës. Me ligjin nr. 9158, datë 18.12.2003, pika 21 ndryshon, duke quajtur si taksë kombëtare taksën e qarkullimit rrugor. Po në nenin 4, pas pikës 23 shtohet pika 24 që konsideron si taksë kombëtare edhe taksën për regjistrimin e lojërave të fatit, për kazinotë dhe për garat sportive që zhvillohen në hipodrom. Neni 5 i ligjit në fuqi tregon nivelin e taksave kombëtare. Ky nen ka 23 pika dhe në pikën 21 jepet masa e taksës së rrugës Durrës-Kukës për disa lloje veprimitarish, siç janë mbitaksa e importimit të mallrave, e taksës për konsumin e karburanteve, të cilat janë importuar ose prodhuar në vend. Me ndryshimet që bëhen, në pikën 21 tanimë flitet për taksën e qarkullimit rrugor për autoveturat (4+1) vende, për

autoveturat me më shumë se (4+1) vende, për mikrobuzët, autobuzët e çdo lloji tipi dhe kamionët e çdo tonazhi. Po në këtë nen, pas pikës 23, shtohet pika 24, sipas të cilës taksa për regjistrimin e lojërave të fatit, kazinotë, për garat sportive që zhvillohen në hipodrom, caktohet për lojërat e fatit si lojëra aritmetike, lojëra fati sportive, llotari dhe lojëra elektronike. Në pikën 21 të nenit 6 (Agjentët e taksave), ku flitet për agjentët e taksave për taksën e rrugës Durrës-Kukës, me ndryshimet që bëhen në këtë pike, thuhet se për taksën e qarkullimit rrugor ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Kjo taksë arkëtohet në çastin e kontrollit, sipas të cilës për taksat për regjistrimin e lojërave të fatit, për kazinotë dhe për garat sportive që zhvillohen në hipodrom, ngarkohet Komiteti i Lojërave të Fatit në Ministrinë e Financave. Neni 9 i ligjit në fuqi cakton komisionet që përfitojnë agjentët e taksave. Në këtë nen ndryshojnë përqindjet që përfitojnë agjentët për rastet e parashikuara në pikën 3 dhe pikën 21. Ligjit në fuqi i janë bashkëngjitur lidhja nr. 4 “Taksa e qarkullimit të automjeteve të huaja” dhe lidhja nr. 6 “Taksat për shërbimet private të radiokomunikacionit”. Lidhja nr. 4 është zëvendësuar me një tjetër, kurse në lidhjen nr. 6 janë bërë disa ndryshime në masën e taksës. Ligji ka 6 nene dhe ka hyrë në fuqi më 15.1.2004. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 105 të vitit 2003, në faqen 4483.

Ligji nr. 9159, datë 18.12.2003 “Për një ndryshim në ligjin nr. 8981, datë 12.12.2002 “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore””. Ligji nr. 8981, datë 12.12.2002 “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore” ka disa lidhje (Aneks), të cilat janë pjesë e përbërësve të ligjit. Me ligjin nr. 9159, datë 18.12.2003 ndryshimi bëhet në disa tarifa të lidhjes nr.1. Në këtë lidhje gjenden rreth 1200 artikuj, të cilëve u ndryshohen nivelet e tarifave doganore në artikuj, si: peshqit e të gjitha llojeve, molusqet, midhjet, prodhimet e qumështit, të gjitha llojet e vajrave ushqimorë, ëmbëlsirave, frutave tropikalë, lëndëve ngjyrosëse me origjinë shtazore, pigmenteve, prodhimeve të qelqit, bojrat e vajit, fibrat e tekstileve sintetike, lëndës drusore

dhe prodhimeve të ndryshme prej tyre etj., për afro 1200 artikuj. Në Aneksin 1 gjendet Kodi NK me numrat përkatës për çdo artikull. Gjendet përshkrimi i artikujve, tarifa e vjetër dhe tarifa e re. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 15.1.2004. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 105 të vitit 2003, në faqen 4486. Ligji i bashkëlidhet Aneksi 1.

Ligji nr. 9160, datë 18.12.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjet nr. 8710, datë 15.12.2000, nr. 8846, datë 11.12.2001 dhe nr. 8968, datë 7.11.2002”. Ligji në fuqi, në nenin 6, pika 1 parashikon që legjislacioni tatimor në Republikën e Shqipërisë përbëhet nga ligjet mbi tatimet e taksat kombëtare dhe ato vendore. Në fund të pikës 1 të nenit 6 shtohen fjalët: “... dhe kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”. Ndryshimet në nenet 16, 17 dhe 19 janë të pjesshme dhe kanë të bëjnë me kompetencat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me detyrat e kësaj Drejtorie dhe me fondet për administrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe të degëve të saj në rrethe. Neni 20 ndryshon krejtësisht dhe ky ndryshim ka të bëjë me organikën dhe strukturën e administratës tatimore. Pas këtij neni janë shtuar nenet 20/1, 20/2, 20/3 dhe 20/4 që kanë të bëjnë me personelin, shpërblimet e personelit, me strukturën e policisë tatimore, uniformën e saj, me rastet se kur ajo mund të pajiset me armë, si dhe me komisionin e disiplinës tatimore. Pasi trajtohen procedurat e administrimit të tatimeve, në ligj në nenin 30 jepen me hollësi se si bëhet pajisja me certifikatë tatimore. Pas këtij neni është shtuar neni 30/1 që ka të bëjë me regjistrimin e organizatave jofitimprurëse. Ky nen urdhëron që detyrimin, për t’u regjistruar në organet tatimore dhe për t’u pajisur me certifikatë tatimore, u nënshtrohen edhe organizatat jofitimprurëse, fondacionet, njësitë e zbatimit të projekteve etj. që ushtrojnë veprimtari të karakterit fetar, pavarësisht nga fakti se veprimtaria e tyre mund të mos jetë ekonomike e fitimprurëse. Ndryshime

në vazhdimësi (katër herë) po i bëhen nenit 36, që trajton metodat alternative të përcaktimit të detyrimeve tatimore. Ndryshimet e fundit në këtë nen janë për rastet kur tatimpaguesit deformojnë çmimet e shitjes dhe kur ata kryejnë me lekë në dorë transaksione shitblerjeje që kalojnë shumën 500 mijë lekë për vitin 2004 dhe 300 mijë lekë për vitet në vijim. Gjithashtu, ndryshime i janë bërë ligjit në fuqi në dispozitat për procedurat e jashtëzakonshme të mbledhjes me forcë të detyrimeve, për shkeljet dhe dënimet për mosregjistrim, për mosdokumentim, për kryerjen e arkëtimeve dhe të pagesave me lekë në dorë (cash) etj. Ligji ka 24 nene dhe ka hyrë në fuqi më 15.1.2004. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 105 të vitit 2003, në faqen 4519.

Ligji nr. 9161, datë 18.12.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin në të ardhurat”, i ndryshuar. Me ligjin e lartpërmendur, në ligjin në fuqi bëhen 8 shtesa, 5 ndryshime dhe një shfuqizim. Ndër këto vlen të vihet në dukje shtesa e nenit 8/1 që trajton problemin e përjashtimit nga tatimi mbi disa nga të ardhurat vetjake. Kështu përjashtohen nga tatimi të ardhurat e përfituara si rezultat i sigurimit në skemën e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe ndihmat ekonomike për individët pa të ardhura ose me të ardhura të ulëta, sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës në fuqi. Përjashtohen nga tatimi bursa e nxënësve dhe të studentëve, në përputhje me dispozitat e legjislacionit përkatës, të ardhurat e përfituara nga pronarët si shpërblim për shpronësimet që i bëhen nga shteti e të ardhurat që përjashtohen në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Ndryshim tërësor ka pësuar neni 29 që trajton probleme të deklarimit tatimor dhe llogaritja përfundimtare e detyrimit. Sipas këtij ndryshimi, çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore

në organet brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël së bashku me anekset e tij. Gjithashtu, ndryshim tërësor ka pësuar edhe neni 33, lidhur me mbajtjen e tatimit në burim. Kështu, të gjithë personat juridikë, ortakëritë, personat fizikë, tregtarë, që janë rezidentë shqiptarë, për qëllime tatimore, organet e qeverisjes qendrore dhe vendore, organizatat jofitimprurëse, mbajnë në burim tatimin në masën 10 për qind për 10 raste të pagesave që përcaktohen në këtë nen. Ndryshimet ose shtesat e tjera bëhen në pjesë të veçanta të disa neneve, të cilat marrim kuptim, duke i parë e interpretuar në kontekstin e të gjithë nenit në ligjin në fuqi. I vetmi shfuqizim është ai i nenit 34, që flet për mbajtjen përfundimtare të tatimit. Ligji ka 15 nene dhe ka hyrë në fuqi më 15.1.2004. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 105 të vitit 2003, në faqen 4526.

Ligji nr. 9162, datë 18.12.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar. Në ligjin në fuqi, neni 3 përmban detyrimin për t’u regjistruar. Sipas pikës 1 të këtij neni, personi që nuk është i regjistruar, detyrohet të kërkojë të regjistrohet brenda 15 ditëve nga data e fillimit të veprimtarisë së tij ekonomike, kur qarkullimi i tij që kryhet ose do të kryhet është më i madh se kufiri minimal i regjistrimit, i parashikuar në pikën 4 të këtij neni. (Kufiri minimal i regjistrimit është 2 milionë lekë për vit kalendarik). Me ligjin nr. 9162, datë 18.12.2003, pas pikës 1 të nenit 3, shtohet pika 1/1, sipas së cilës, personi i tatueshëm, shitës mallrash me shumicë, detyrohet të kërkojë të regjistrohet edhe në rastet kur qarkullimi i tij vjetor nuk kalon kufirin minimal të parashikuar në pikën 4 të këtij neni (të cituar më lart). Në nenin 24 të ligjit në fuqi fliet për furnizimin e përjashtuar të organizatave jofitimprurëse, duke quajtur të tilla rastet kur kemi të bëjmë me furnizim mallrash e shërbimesh për trajtim mjekësor ose dentar, për furnizim shërbimesh për mbrojtjen e kujdesin ndaj fëmijëve ose të moshuarve, furnizim shërbimesh arsimore, kulturore e sportive dhe furnizim shërbimesh nga organizata fetare e filozofike

me qëllim mirëqënien shpirtërore. Në shtesën që bëhet në nenin 24/1 thuhet se furnizimi i shërbimeve arsimore nga institucionet arsimore publike dhe private, në përputhje me ligjin nr. 7952, datë 21.6.1995 “Për arsimin parauniversitar” dhe ligjin nr. 8461, datë 25.2.1999 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” është furnizim i përjashtuar. Me interes është të vihet në dukje se sipas shtesës së pikës 4 në nenin 28 për mallrat, të cilat pësojnë humbje gjatë tranzitimit, magazinimit dhe prodhimit, siç përcaktohet në akte të veçanta ligjore dhe nënligjore, nuk llogaritet dhe nuk paguhet TVSH-ja. Neni 42 parashikon rishqyrtimet e vlerësimeve tatimore, mbi ankesën e personit të interesuar dhe, sipas pikës 7 të këtij neni, Ministria e Financave njofton me shkrim personin që kërkon rishqyrtimin për rezultatet e rishqyrtimit. Shtesa, që është bërë në këtë pikë, thotë se mosdërgimi i njoftimit për rezultatet e rishqyrtimit nga organet tatimore, brenda 30 ditëve, vlerësohet si përgjigje në favor të personit të tatueshëm. Ligji ka 10 nene dhe ka hyrë në fuqi më 15.1.2004. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 105 të vitit 2003 në faqen 4530.

Ligji nr. 9163, datë 18.12.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar me ligjin nr. 9041, datë 27.3.2003. Në nenin 4 të ligjit në fuqi përmbahet detyrimi për pajisjen me autorizim akcize dhe përmenden 7 raste të tilla. Me ligjin nr. 9163, datë 18.12.2003, në këtë nen pas pikës 3 shtohet pika 3/1 sipas së cilës, detyrimin për pajisje me autorizim akcize e ka edhe çdo person që importon malto dhe nuk është i autorizuar si prodhues birre. Ai është i detyruar të pajiset me autorizim nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Neni 10 parashikon rastet se kur nuk paguhet akcizë. Sipas pikës 1 të këtij neni janë dy raste dhe konkretisht kur malli del nga magazina për eksport dhe kur malli del nga magazina për t’u dërguar në një magazinë tjetër tatimore të miratuar. Rasti i dytë është i përcaktuar me ligjin nr. 9163, datë 18.12.2003, duke ndryshuar atë të ligjit në fuqi. Përjashtimet nga akcizat gjenden në

nenin 19 të ligjit në fuqi. Rasteve të parashikuara në këtë nen u shtohen edhe dy të tjera. Kështu përjashtohen nga akcizat importimi i nënprodukteve të naftës, për nevojat e veta, nga subjektet e kërkimit të naftës dhe të vënies në shfrytëzim të zonave naftëmbajtëse. Përcaktimi dhe dokumentimi i sasive që këto subjekte përdorin, do të përcaktohen në udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Industrisë dhe Energjitikës. Rasti i dytë i përjashtimit të karburantit nga akciza është kur ai përdoret për projektin pilot për mekanikën bujqësore dhe serat me ngrohje. Ndryshime ka pësuar edhe neni 47 lidhur me problemin e shkeljes së afatit kohor për pagesën e akcizës. Përveç gjobës, do të paguhet edhe interesi, i cili sipas ligjit në fuqi ishte në masën 5 për qind për muajin e parë dhe 2 për qind për çdo muaj tjetër pasardhës. Me ndryshimin e bërë, interesi do të llogaritet në përputhje me ligjin nr.8980, datë 12.12.2002 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”. Ligji ka 7 nene dhe ka hyrë në fuqi më 15.1.2004. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 105 të vitit 2003, në faqen 4532. Ligjit i bashkëlidhete Shtojca 1/1 “Mallrat e tatueshme me akcizë në Republikën e Shqipërisë”, e cila ka zëvendësuar Shtojcën 1 që i bashkëlidhej ligjit nr. 8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”.

Ligji nr. 9164, datë 18.12.2003 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë””. Në nenin 9 të ligjit në fuqi trajtohet llogaritja e kontributeve për personin e vetëpunësuar dhe punonjës in e papaguar të familjes. Në pikën 2 të këtij neni thuhet se kontributi për punëdhënësin e vetëpunësuar dhe punonjës in e papaguar të familjes llogariten sipas nivelit të parashikuar si për qindje ndaj të ardhurave vjetore fikse, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave. Me ligjin nr. 9164, datë 18.12.2003 pika 2 e nenit 9, siç u përmend më lart, është shfuqizuar. Neni 10 i ligjit në fuqi është ndryshuar tërësisht, duke i dhënë një zgjidhje më të saktë e më të plotë detyrimit për të deklaruar.

Tërësisht është ndryshuar edhe neni 11, i cili trajton afatet e deklarimit dhe të pagesës. Sipas ndryshimit, personi i detyruar, për të paguar kontribute, duhet të dorëzojë në organet tatimore një deklaratë për çdo periudhë për të cilën është i detyruar t'i paguajë këto kontribute. Deklarata, sipas ndryshimit që i bëhet ligjit (neni 11), bëhet në afatet e mëposhtme:

a) nga punëdhënësi, çdo muaj, jo më vonë se data 25 e muajit pasardhës;

b) nga personi i vetëpunësuar, jo më vonë se data 25 e muajit të fundit të çdo tremujori të vitit kalendarik. Deklarata e përmendur më sipër bëhet në përputhje me formularët e deklarimit, të cilët përcaktohen në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë të Financave dhe Ministrisë të Punës dhe Çështjeve Sociale. Ligji ka 5 nene dhe ka hyrë në fuqi më 15.1.2004. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 105 të vitit 2003, në faqen 4535.

Ligji nr. 9165, datë 23.12.2003 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2004”. Sipas këtij ligji, fondi i konsoliduar për vitin 2004 është: të ardhurat e Buxhetit të Shtetit janë 164.364 lekë dhe shpenzimet e Buxhetit të Shtetit janë 206 672 milionë lekë, pra, defiçiti mbetet të jetë 42 308 milionë lekë. Fondi i konsoliduar përbëhet nga Buxheti Qendror, me 153 020 milionë lekë të ardhura dhe 195 328 milionë lekë shpenzime, dhe nga buxheti i pavarur i pushtetit vendor me 17 621 milionë të ardhura, nga të cilat granti nga Buxheti Qendror 6 277 lekë dhe shpenzimet 17 621 milionë lekë. Buxheti parashikon 41 733 milion lekë të ardhura për sigurimet e detyrueshme shoqërore, nga të cilat 30 839 lekë nga kontributet dhe 10 894 milionë lekë transferimet nga Buxheti i Shtetit. Për sigurimet suplementare janë parashikuar 2 620 milionë lekë të ardhura, nga të cilat 49 milionë nga kontributet dhe 2 571 milionë lekë nga Buxheti i Shtetit, kurse për sigurimet shëndetësore të ardhura gjithsej janë 5 150 milionë lekë, nga të cilat 2 800 milionë lekë nga kontributet dhe 2 350 milionë lekë transferime nga Buxheti i Shtetit. Ligji parashikon edhe burimet e shpenzimeve buxhetore. Sipas grupeve kryesore, këto burime janë 6 622 milionë lekë nga grantet, 125 592 milionë lekë nga të ardhurat tatimore,

20 806 milionë lekë nga të ardhurat jotatimore dhe 11.344 milionë lekë të ardhura nga buxheti vendor. Shpenzimet e Buxhetit të Shtetit janë në këto drejtime kryesore: Shpenzime korente 152 056 milionë lekë, 48 516 milionë lekë shpenzime kapitale, 2 500 milionë lekë rezerva e Këshillit të Ministrave dhe 3 600 milionë lekë Kontigjenca, e cila do të përdoret për ruajtjen e deficitit (2 000 milionë lekë) dhe për shlyerjen e detyrimeve të vjetra të ndërmarrjeve jopublike (1 600 milionë lekë). Gjithashtu, është parashikuar që kufiri maksimal i punonjësve buxhetorë në 1 janar 2004, mbi të cilin është përgatitur Buxheti i Shtetit i vitit 2004, është 110 000 punonjës. Janë përcaktuar edhe fondi i Buxhetit Gjyqësor, transfertat e pakushtëzuara dhe kufiri i shpenzimeve për çdo ministri. Ligjit i bashkëlidhen edhe shumë pasqyra e tabela të detajuara me hollësi që shërbejnë për zbatimin e tij me rigorozitet. Ligji ka 17 nene dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, duke shtrirë efektet financiare nga data 1 janar 2004. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 108 të vitit 2003, në faqen 4631.

Ligji nr. 9166, datë 22.1.2004 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën “Për rregullat ndërkombëtare për parandalimin e përplasjeve në det, 1972”, dhe në anekset e saj”. Konventa, në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar në ligjin e lartpërmendur, do të shërbejë për të patur një nivel të lartë sigurie në det për të parandaluar përplasjet e anijeve. Rregullat e përcaktuara në Konventë do të zbatohen nga të gjitha anijet në oqeanë dhe në të gjitha ujërat, që lidhen me to, të lundrueshme nga anijet detare. Asgjë nga këto rregulla nuk do të përjashtojë çdo anije ose pronarin e saj, kapitenin ose ekuipazhin nga pasojat e çdo neglizhence për të qenë në përputhje me këto rregulla. Rregullat ndërkombëtare për parandalimin e përplasjeve në det janë hartuar e miratuar në vitin 1972. Në këto parashikohen rregullat e lundrimit dhe të drejtimit të anijeve në çdo konditë shikimi, drejtimin e anijeve me shikim ndaj njëra-tjetrës, e drejtimin në kushte me shikim të kufizuar. Në një kre të veçantë,

vendosen rregullat që lidhen me dritat, të cilat do të zbatohen brenda periudhës nga perëndimi i diellit e deri në lindjen e tij, kurse rregullat lidhur me shenjat do të zbatohen gjatë ditës. Vend i veçantë i jepet edhe rregullave për sinjalet zanore, të cilat mund të jepen me sirenë, e me fërshëllimë, si dhe sinjaleve të manovrimit dhe të paralajmërimit. Në Aneksin I të rregullave të përgjithshme jepen detajet teknike dhe të pozicionimit për datat dhe shënjat. Në Aneksin II përshkruhen sinjalet plotësuese për anijet e peshkimit që peshkojnë në zona të afërta, kurse detaje teknike të pajisjeve të sinjaleve zanore përshkruhen në Aneksin III. Këtu gjenden distancat dhe frekuencat e dëgjimit të zërit, frekuencat bazë dhe kufijtë e tyre, intensiteti i sinjaleve zanore dhe hapësira e dëgjimit etj. Në Aneksin IV përshkruhen sinjalet e avarisë. Sinjalet që tregohen në këtë aneks, të përdorura ose të ekspozuara, si veç e veç, ashtu dhe së bashku, do të tregojnë avari dhe nevojë për ndihmë. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 10.3.2004. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 6 të vitit 2004, në faqen 151. Ligjit i bashkëlidhen Konventa, Rregullat ndërkombëtare për parandalimin e përplasjeve në det me 5 pjesë, 2 seksione, si dhe 4 anekset.

Ligji nr. 9167, datë 22.1.2004 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare “Për lehtësimin e kalimeve kufitare për mallrat e transportuara me hekurudhë” (Gjenevë, 10 janar 1952). Shtetet që kanë nënshkruar këtë Konventë më 10.1.1952 në Gjenevë, kanë patur për qëllim lehtësimin e kalimit të kufijve për mallrat e transportuara me hekurudhë. Në këtë kuadër, në çdo linjë hekurudhore, ku transportohet një volum i konsiderueshëm i trafikut ndërkombëtar të mallrave, e cila kalon kufirin midis dy vendeve kufitare, autoritetet kompetente të këtyre vendeve do të shqyrtojnë bashkërisht mundësinë e caktimit me marrëveshje të një stacioni, të mbyllur në kufi, në të cilin mund të realizohen efektivisht kontrollet e kërkuara nga legjislationet e të dy vendeve në hyrje dhe në dalje të të gjithë trafikut të mallrave ose të

një pjese të tij. Në çdo rast që caktohet një stacion i tillë, ngrihet një zonë brenda stacionit, në territorin e të cilit nëpunësit dhe punonjësit e administrave kompetente të vendit fqinj, kanë të drejtën të kontrollojnë kalimin e mallrave në kufirin e drejtimit tjetër. Kreu II i Konventës përmban sistemin e transitit ndërkombëtar. Me qëllim zbatimin e kushteve të këtij kreu, palët kontraktuese në parim do të njohin vulat doganore të palëve të tjera kontraktuese, që është subjekti i të drejtës të çdo administrate doganore për të shtuar vulën e vet dhe që e quajnë esenciale. Gjithashtu, palët kontraktuese do të miratojnë formën standard të deklaratës ndërkombëtare doganore, që është në ankes të kësaj Konvente. Në kreun III ka klauzola të ndryshme që kanë rregulluar probleme teknike, siç janë orët e shërbimit të stafit hekurudhor, doganor, si dhe të administratave të tjera, për t'u përshtatur me kujdes me orarin e trenave dhe nevojat e trafikut. Në këtë funksion në të gjitha linjat kryesore palët Kontraktuese do të vendosin shërbimin e drejtpërdrejtë hekurudhor të linjave telefonike ndërmjet stacioneve kufitare. Në kreun e klauzoleve përfundimtare jepet procedura për instrumentet e ratifikimit, hyrjen në fuqi, bërjen e modifikimeve, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve etj. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 10.3.2004. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 6 të vitit 2004, në faqen 176. Ligjit i bashkëlidhet Konventa e bërë në Londër më 1972. Rregullat ndërkombëtare për parandalimin e përplasjeve të vitit 1972 dhe 4 anekse.

Ligji nr. 9168, datë 22.1.2004 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare “Për lehtësimin e kalimeve kufitare për udhëtarët dhe bagazhet e transportuara me hekurudhë” (Gjenevë, 10 janar 1952). Qëllimi i Konventës është lehtësimi i kalimit të kufijve për udhëtarët e transportuar me hekurudhë. Për këtë arsye është parashikuar që në çdo linjë hekurudhore, ku transportohet një volum i konsiderueshëm i trafikut ndërkombëtar, e cila kalon kufirin midis dy vendeve kufitare, autoritetet kompetente të tyre duhet që bashkarisht të

shqyrtojnë mundësinë e caktimit me marrëveshje të një stacioni të mbyllur pranë kufirit, tek i cili mund të realizohet kontrolli i nevojshëm, në përputhje me legjislacionin e të dy vendeve, përsa i përket hyrjes dhe daljes së udhëtarëve dhe bagazheve të tyre. Në çdo rast që caktohet stacioni që u tha më sipër, do të krijohet një zonë brenda satacionit, në territorin e të cilit nëpunësit dhe punonjësit e administratës kompetente të vendit fqinj kanë të drejtën të kontrollojnë udhëtarët që kalojnë kufirin në të dy drejtimet, bagazhet e tyre dhe pakot e transportuara me trenat ndërkombëtarë të udhëtarëve. Përveç krijimit dhe funksionimit të stacioneve kufitare, në Konventë janë parashikuar edhe zgjidhja e problemeve lidhur me kontrollin policor dhe doganor gjatë kohës kur treni është në lëvizje. Kjo bëhet me qëllimin që kontrolli i parashikuar gjatë lëvizjes së trenit të mundësojë zvogëlimin e pritjeve, qoftë në stacionet kufitare ose në stacionet ku kontrollet janë kryer nga të dy vendet fqinjë. Kreu III përmban detyrime dhe procedura lidhur me kontrollin doganor të bagazheve dhe të pakove të transportuara nga trenat ndërkombëtar të udhëtarëve, kurse kreu IV vë detyrime për lehtësimet e kontrollit, si dhe faktin që udhëtarët që përdorin hekurudhën, të gëzojnë të gjitha privilegjet doganore që u jepen udhëtarëve që kalojnë kufirin me mjete të tjera transporti. Kreu i fundit ka të bëjë me procedurat e nënshkrimit së Konventës, hyrjes në fuqi, denoncimit, zgjidhjes së mosmarrëveshjeve etj. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 11.3.2004. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 6 të vitit 2004, në faqen 184. Ligjit i bashkëlidhet Konventa dhe aSnekset me modelet e deklaratave doganore.

Ligji nr. 9169, datë 22.1.2004 “Për ratifikimin e Marrëveshjes shtesë të Konventës Europiane të 21 marsit 1983 “Për transferimin e personave të dënuar”, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë””. Të dy shtetet e lartpërmendura, kanë rënë dakord për ratifikimin e kësaj Marrëveshjeje, duke dashur të intensifikojnë dhe të lehtësojnë bashkëpunimin në marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve në zbatimin

e Konventës Europiane mbi transferimin e personave të dënuar. Konventa Europiane mban datën 21 mars 1983, kurse Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë është nënshkruar në Romë më 24.4.2002. Me hartimin e Marrëveshjes, palët e kanë konsideruar të përshtatshëm plotësimin e Konventës në disa pika, me qëllim shtrirjen e zbatimit edhe me forma të tjera të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore penale. Në Marrëveshje parashikohet që kur në njërin prej shteteve është shpallur një vendim dënimi i formës së prerë ndaj një shtetasi tjetër, ky i fundit, me kërkesën e shtetit dënues, mund të procedojë me ekzekutimin përkatës, në rast se personi i dënuar ndodhet në territorin e tij, në përputhje me normativat e brendshme lidhur me njohjen e vendimit gjyqësor. Gjithashtu, është parashikuar që me kërkesën e shtetit dënues, shteti ekzekutues, mund të lejojë transferimin e një personi të dënuar pa pëlqimin e tij, kur vendimi i shpallur ndaj tij, sipas rregullit të brendshëm të shtetit dënues, shpie në një masë dëbimi ose shoqërimi deri në kufi. Ndër procedurat e parashikuara për plotësimin e këtyre detyrimeve, shteti dënues duhet t'i përcjellë shtetit ekzekutues një deklaratë që përmban mendimin e personit të dënuar lidhur me transferimin, një kopje të vendimit të dënimit, që sjell si pasojë një masë, sipas së cilës personi i dënuar, pas daljes nga burgu, nuk mund të qëndrojë më në territorin e shtetit dënues. I rëndësishëm është fakti që Marrëveshja parashikon se çdo person i transferuar, në zbatim të sa u tha më sipër, nuk do të ndiqet, të gjykohet, t'i hiqet liria me qëllim ekzekutimin e një vendimi ose mase sigurie, ose të kufizimit të një tjetër lirie vetjake, për çfarëdolloj vepre të kryer më parë, që nuk ka të bëjë me transferimin, të ndryshme nga ai që ka motivuar dënimin e zbatueshëm, me përjashtim të rasteve kur shteti i dënimit e autorizon një gjë të tillë, si dhe për disa arsye të tjera që i parashikon Marrëveshja. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 5.3.2004. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 5, të vitit 2004 në faqen 135. Ligjit i bashkëlidhet Marrëveshja.

Information on laws passed by Assembly

Filip Lako

Lawyer

Center for Parliamentary Studies

